232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm								
230	Kapitale të patrupëzuara								
231	Kapitale të trupëzuara								
232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj								
Totali	Shpenzime kapitale								
	Totali (korrente+ kapitale)	38.999	49.907	49.907	53.444	23.109	14.667	-8.442	
Drejtuesi I Ekipit	Emri	Kryetari I Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri					
Menaxhues t									
Programit									
	Firma			Firma					
	Data			Data					

Bashkia	Vlore						Kodi I grupit/Njesise vendore	146001
Programi	Arsimi I mesem/Konviktet						Kodi I program	9230
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2025	2 .PBA Plan Viti 2026	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2026	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2026	5.Buxheti vjetor Plan I peroidhes/progresiv	6. Fakti I periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	9.578	15.290	15.290	27.018	17.728	3.456	-14.272
601	Sigurime shoqërore	2.020	2.432	2.432	3.205	1.873	737	-1.136
602	Mallra dhe shërbime të tjera		11.589	11.589	28.713	21.617		-21.617
603	Subvencione							
604	Transferta korrente të brendshme							
605	Transferta korrente të huaja							
606	Trans për buxh. fam & individ							0
609								
651								
166								
Nëntotali	Shpenzime korrente							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara				27.338	27.338		-27.338
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							
Totali	Shpenzime kapitale							
	Totali (korrente+ kapitale)	11.598	29.311	29.311	86.274	68.556	4.193	-64.363
Drejtuesi I Ekipit	Emri	Kryetari I Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri				
Finanxhuesi i Programit	Firma			Firma				
	Data			Data				

Bashkia	Vlore						Kodi I grupit/Njesise vendore	146001
Programi	Qendra PAK						Kodi I program	10430
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2025	2 .PBA Plan Viti 2026	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2026	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2026	5.Buxheti vjetor Plan I peroidhes/progresiv	6. Fakti I periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	16.241	18.996	18.996	21.481	6.150	5.293	-857
601	Sigurime shoqërore	2.704	3.173	3.173	3.568	1.050	885	-165
602	Mallra dhe shërbime të tjera	3.896	5.000	5.000	5.000	1.200	870	-330
603	Subvencione							
604	Transferta korrente të brendshme							
605	Transferta korrente të huaja							
606	Trans për buxh. fam & individ							0
609								
651								
166								
Nëntotali	Shpenzime korrente							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara	695	2.000	2.000	5.800			0
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							
Totali	Shpenzime kapitale							
	Totali (korrente+ kapitale)	23.536	29.169	29.169	35.849	8.400	7.048	-1.352
Drejtuesi I Ekipit	Emri	Kryetari I Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri				
Finanxhuesi i Programit	Firma			Firma				
	Data			Data				

Bashkia	Vlore						Kodi I grupit/Njesise vendore	146001
Programi	Shtepia e Femijes						Kodi I program	10430
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2025	2 .PBA Plan Viti 2026	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2026	4. Buxheti vjetor Plan I ris hikuar Viti 2026	5.Buxheti vjetor Plan I peroidhes/p rogresiv	6. Fakti I periudhës/pro gresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga							0
601	Sigurime shoqërore							0
602	Mallra dhe shërbime të tjera	793	1.920	1.920	1.920	600	328	-272
603	Subvencione							
604	Transferta korrente të brendshme							
605	Transferta korrente të huaja							
606	Trans për buxh. fam & individ							0
609								
651								
166								
Nëntotali	Shpenzime korrente							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							0
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							
Totali	Shpenzime kapitale							
	Totali (korrente+ kapitale)	793	1.920	1.920	1.920	600	328	-272
Drejtuasi I Ekipit	Emri	Kryetari I Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri				
Enxhues i Programit								
	Firma			Firma				
	Data			Data				

Treguesit e realizimit të Buxhetit të Shtetit (Fonde të Kushtëzuara)

kap.	EMERTIMI	TOTALI			600			601			602			604		606		231		
		Plan	Limit	Fakt	Plan	Limit	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Limit	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Limit	Fakt	
1170	Gjendja Civile	15.654.000	7.858.000	6.715.779	13.420.000	7.858.000	5.754.051	2.234.000	961.728	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
1170	Shpërbim lindje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
10430	Invalidet	205.863.000	230.883.929	203.656.205	0	0	0	0	0	0	230.883.929	0	0	0	205.863.000	203.656.205	0	0	0	
10430		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
10430	Ndihma ekonomike	17.220.000	0	12.048.760	0	0	0	0	0	0	0	0	0	17.220.000	12.048.760	0	0	0	0	
10430	Qendra e shëndetit	7.800.929	0	2.129.103	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7.800.929	2.129.103	0	0	0	0	
9240	Arsimi profesional	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
4130	Q.K.R	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
9240	Bursat	0	0	1.795.625	0	0	0	0	0	0	1.795.625	0	0	0	0	0	0	0	0	
9120	Arsimi 9 vjeçar	6.667.005	0	3.982.446	0	0	0	0	6.667.005	0	3.982.446	0	0	0	0	0	0	0	0	
9230	Arsimi i mesëm	2.762.500	0	0	0	0	0	0	2.762.500	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
6180	Shpronësimet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
6370	Investime	20.000.000	0	10.000.000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	20.000.000	10.000.000	0	0	0	0	
6260	Zhvillimi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
6220	Fzhr	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
6220	Fzhr	658.661.787	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	658.661.787	0	0	0	0	0	
910		17.870.000	0	2.016.483	0	0	0	0	0	0	8.935.000	2.016.483	8.935.000	0	0	0	0	0	0	
6190	Min financave	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
4240	Ujitja dhe kullimi	184.604.779	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	184.604.779	0	0	0	0	0	
1620	Zgjedhjet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
4520	Shpronësimet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
6180	Shpronësimet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	TOTALI	1.137.104.000	238.741.929	242.344.401	13.420.000	7.858.000	5.754.051	2.234.000	961.728	9.429.505	230.883.929	5.778.071	8.935.000	2.016.483	1.103.085.495	227.834.068	0	0	0	

kap.	EMERTIMI	TOTALI			600			601		602			604		606		231		
		Plan	LIMIT	Fakt	Plan	LIMIT	Fakt	Plan	Fakt	Plan	LIMIT	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	LIMIT	Fakt
10430	Shtepia e famijes	8.430.000		6.946.159	6.960.000		5.920.323	1.160.000	981.980	310.000		43.856							
10430	Qendra e Zhvillim	12.590.000		9.740.476	8.330.000		6.962.992	1.410.000	1.162.820	2.850.000		1.614.664							
	SHUMA	21.020.000	0	16.686.635	15.290.000	0	12.883.315	2.570.000	2.144.800	3.160.000	0	1.658.520	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	1.158.124.000	238.741.929	259.031.036	28.710.000	7.858.000	18.637.366	4.804.000	3.106.528	12.589.505	230.883.929	7.436.591	8.935.000	2.016.483	1.103.085.495	227.834.068	0	0	0

Realizimi total i buxhetit të shtetit gjatë periudhës janar-prill 2026 siç paraqitet dhe në pasqyrën e mësipërme është 22.3%.nga të cilat:

- Fondi i pagave rezulton: Plan **28,710** mijë lekë janë përdorur në fakt **18,637** mijë lekë ose **64.9%**
- Fondi i sigurimeve shoqërore rezulton: Plan **4,804** mijë lekë janë përdorur në fakt **3,106** mijë lekë ose **64.6%**
- Fondi i shpenzimeve operative rezulton: Plan **12,589** mijë lekë janë përdorur në fakt **7,436** mijë lekë ose **59%**
- Fondi i emergjencave civile rezulton: Plan **8,935** mijë lekë janë përdorur në fakt **2,016** lekë ose **22.5%**
- Fondi i invalideve dhe ndihmës ekonomike rezulton: Plan **1,103,085** mijë lekë janë përdorur në fakt **227,834** mijë lekë ose **20.6%**

A. Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Vlorë, prej periudhës Janar-Prill 2026 ka kryer detyrat si më poshtë vijon:

1. Të ardhura nga Taksa e Infrastrukturës per periudhen Janar – Prill 2026

Gjatë punës në sektorin e kontrollit të lejeve të ndërtimit, është bërë i mundur arkëtimi i vlerës totale 960 221 734,90 lekë si taksë e ndikimit në infrastrukturë dhe të ardhura te tjera për cdo leje ndërtimi të miratuar, ku përfshihen llojet e lejeve si më poshtë:

Në sistemin e-Leje për periudhën Janar-Prill 2026 kanë përfunduar procedurën ligjore 309 aplikime e llojit:

- Çertifikatë Përdorimi
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m²
- Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²
- Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m²
- Leje për ndryshim aktiviteti/funksioni
- Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit
- Deklaratë Paraprake Punimesh
- Njoftim Fillim Punimesh

2. Projektet Publike Infrastrukturore

Janë përfunduar këto projekte per investimet e parashikuara per Buxhetin 2026:

1-Rikonstruksion me prishje dhe shtesë anësore 2-kat në Çerdhen Nr.15,Vlorë

2-Rikualifikim i bllokut të banesave midis rrugëve Hasan Kushta-Misto Mele-Fatos
Arapi-Blv.Ismail Qemali,Vlorë(Tregu i Orizit)

3.Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Mekat,Njesia Administrative Shushicë

4.Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Babice e Vogël,Njesia Administrative Qëndër

5.Rikualifikim i bllokut të banesave ne Lagjen “Isa Boletini”,Vlorë

6.Rikonstruksion i rruges së varrezave të dëshmorëve,Vlorë

7.Rikualifikim i stacioneve të autobuzave, Bashkia Vlorë

8.Trotuarë dhe hapësirë rekreative në rrugën “Fejzo Gjomema” Vlorë

9.Rikonstruksion i Kopshtit Nr.1,Rajoni Nr.5,Vlorë

10.Rikonstruksion pjesor i palestrës multifunksionale të ekipit Flamurtari Vlorë

11.Riparime në Pallatin e Sportit “Flamurtari”,Vlorë

3.Korrespondenca shkresore

Gjatë periudhës Janar-Prill 2026 pranë Drejtorisë së Urbanistikës janë administruar dhe trajtuar **90** qytetar/javë, përfaqësues qytetarë **360** të informuar në muaj shkresa në javë nga institucione, qytetarë dhe subjekte fizike apo juridike.

4.Sistemi i adresave(Adresari)

Gjatë muajve Janar-Prill 2026 janë paraqitur mesatarisht **25 - 30** qytetarë në ditë, duke përfshirë edhe disa qytetarë me kombësi të huaj. U është ofruar shërbimi për saktësim adrese apo konfirmim adrese për ndryshim vendbanimi. Gjithashtu në bashkëpunim të vazhdueshëm me Gjendjen Civile ndërhyjmë në rregullimin e pasaktësive në Sistemin e Adresave.

NJËSIA E PROKURIMIT

Veprimtaria në Njësinë e prokurimit bazohet në: Ligjin Nr. 139/2015 datë 27.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika1/1.1/a,b, neni 64, në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar, Ligjin Nr. 9131, datë 8.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar,

Për periudhën 01.01.2026 – 30.04.2026 ju raportojmë:Në zbatim të detyrimeve funksionale të Sektorit të Prokurimit, po ju përcjellim analizën 4-mujore mbi aktivitetin e procedurave të prokurimit të zhvilluara nga Bashkia Vlorë, për periudhën 4 mujore janar–prill.

Analiza përmbledh ecurinë e procedurave të realizuara, statusin e tyre, si dhe masat e marra për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe administrative në fushën e prokurimit publik.

Për periudhën janar-prill 2026 janë zhvilluar 38 procedura prokurimi nga të cilat 19 procedura jane perfunduar dhe nënshkruar kontratat dhe 19 procedura janë në faza të ndryshme të zhvillimit të prokurimit publik.

Njësia e prokurimit gjithashtu për periudhën janar-prill 2026 ka finalizuar me nënshkrimin e kontratave edhe 14 procedura të parashikuara dhe të zhvilluara në vitin 2025.

Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë edhe tabelën e regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit për periudhën objekt analize.

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi i përlllogaritur	Data e lidhjes se kontrates	Vlera kontratës me tvsh
1	Rikonstruksion pjesor per palester multisportive te Ekipit Flamurtari	10000000.00	4/23/2026 12:00:00 AM	9467859.6
2	Blerje materiale pastrimi, detergjent	5083333.00	4/24/2026 12:00:00 AM	3720450

3	Lyerje godine	7416667.00	4/16/2026 12:00:00 AM	6657246
4	Sistem i Parkimit per "Vlora Parking"	14299000.00	Procedure ne zhvillim	
5	"Blerje material i butë (jastëk, carcafe, peshqir, batanije, këllëfë), për Sektorin e Arsimit"	2601667.00	5/13/2026 12:00:00 AM	1916448
6	Rikonstruksion i Rrugeve te brendshme ne lagjen 24 Maji (Rruga Remzi Ramo, Minella Anastasjadhi,Prenjo Petoshati)	78677500.00	Procedure ne zhvillim	
7	Rikonstruksion me prishje dhe shtese anesore ne cerdhen "Nr. 15"	40803333.00	Procedure ne zhvillim	
8	Blerje kontenier metalik 1.1m3, per Ndermarrjen e Pastrimit Vlore	20833333.00	4/27/2026 12:00:00 AM	20760000
9	Mirembajtje automjetesh (dhe zjarrefikese)	7916667.00	4/18/2026 12:00:00 AM	8070000
10	FV Semafor ne qytet	35000000.00	4/29/2026 12:00:00 AM	38916000
11	Rikonstruksion i Rruges "Jul Qezari dhe ndertim mur mbajtes ne nje segment te rruges	17500000.00	Procedure ne zhvillim	
12	Sherbimi i mirembajtjes se dekorit	4166667.00	4/16/2026 12:00:00 AM	3749400
13	Blerje fshese elektrike, autobot dhe automjet lavazho per Ndermarrjen e Pastrimit	29833333.00	Procedure ne zhvillim	
14	Sherbim interneti dhe telefon, Bashkia Vlore	1333334.00	4/30/2026 12:00:00 AM	1013332.8
15	F.V. e sistemeve vaditese per lulishte per Bashkine Vlore	5000000.00	4/10/2026 12:00:00 AM	4794600
16	Blerje Krevate dhe Dysheke per Kopshte e Çerdhe	14410000.00	4/24/2026 12:00:00 AM	7638780
17	Blerje Mikroфона	1833333.00	3/31/2026 12:00:00 AM	1476060
18	Blerje mjete didaktike	2083333.00	4/7/2026 12:00:00 AM	1455161.6
19	Blerje pajisje kompjuterike	5669166.00	Procedure ne zhvillim	
20	Rikonstruksion i Varrezave te Deshmoreve	50000000.00	Procedure ne zhvillim	
21	Rikonstruksion trotuare dhe hapsira rekreative ne rrugen "Fejzo Gjomemo"	20833333.00	Procedure ne zhvillim	
22	Ndertim i Qendres Operacionale te Emergjencave Civile	288559870.00	Procedure ne zhvillim	
23	Mirembajtje pajisje elektronike	1416667.00	Procedure ne zhvillim	

24	Punime mirembajtje	2133635.00	Procedure ne zhvillim	
25	Ndertimi i shkolles 9-vjecare "Ismail Qemali"	298775474.00	Procedure ne zhvillim	
26	Rehabilitim i Stacioneve te Autobuzeve Urban	8333333.00	4/30/2026 12:00:00 AM	6839994
27	Blerje materiale/lodra per ambjente rekreative per femije	12500000.00	4/7/2026 12:00:00 AM	11247857
28	Blerje tonera	1666667.00	5/12/2026 12:00:00 AM	956400
29	Blerje shtypshkrime & kancelari, leter printeri	3937500.00	Procedure ne zhvillim	
30	F.V. Pajisje per sistemin e ngrohje-ftohje ne Shkollen "Lef Sallata"	12500000.00	Procedure ne zhvillim	
31	Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndertimore	10916667.00	Procedure ne zhvillim	
32	Siguracion automjetesh, ndertese dhe jete	3400000.00	Procedure ne zhvillim	
33	Blerje drone per Emergjencat Civile	337500.00	Procedure ne zhvillim	
34	Rikonstruksioni i rruges ne Merkat, Njesia Administrative Shushice	17520000.00	Procedure ne zhvillim	
35	Blerje Zjarrfikese e re per Bashkine Vlore	58333333.00	19/03/2026	30960000
36	Sistemi dixhital i administrimit te taksave vendore	12000000.00	Procedure ne zhvillim	
37	Riveshje me asfalt	256202500.00		
	Loti 1:	136184215	18/05/2026	68525793
	Loti 2:	119690862	18/05/2026	19109198
38	Rikonstruksion i Ures Y(Ypsilon) te Rruga "Dhimiter Konomi"	5433333.00	Procedure ne zhvillim	

Procedura të zhvilluara në vitin 2025 dhe nënshkruar kontrata në vitin 2026

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi i përlogaritur	Data e lidhjes se kontrates	Vlera kontratës me tvsh
1	"Rikonstruksioni i rrugës së Varrezave në Fshatin Kaninë"	28429067.37	1/30/2026 12:00:00 AM	23614621
2	"Blerje skrepi për Njësitë Administrative"	8333333	2/18/2026 12:00:00 AM	8198000

3	Shërbimi i pastrimit të Njësive Administrative	31462094	2/17/2026 12:00:00 AM	23590960
4	Blerje makine zjarrefikse e re	29166667	3/19/2026 12:00:00 AM	25800000
5	Rikonstruksioni i rrugëve në Panaja (me ndriçim, kënd sportiv)	20730732.28	1/16/2026 12:00:00 AM	15853863
6	Kamiocine vetshkarkuese me dopiokabine per Ndermarrjen e Gjelberimit	2500000	1/23/2026 12:00:00 AM	1875100
7	Rehabilitimi i interseksionit rrugor te aksit kryesor Dhimiter Konomi	2500000	2/23/2026 12:00:00 AM	2232673
8	Investime te Bashkise per Mbrojtjen Civile ("Pastrim i kolektoreve nga rruga Demokracia deri te rruga Vasil Puka, Bashkia Vlore")	12480003.9	2/5/2026 12:00:00 AM	10980900
9	Sherbimi i pastrimit te Njesise Orikum	27910435	4/1/2026 12:00:00 AM	22949485
10	Mobilimi i shkollës "Lef Sallata"	15879100	1/7/2026 12:00:00 AM	11996400
11	Rikonstruksioni i Hidrovorit te Qytetit te Vlores (Furnizim Vendosje)	154687373	2/16/2026 12:00:00 AM	146953013
12	"Blerje automjeti për shpërndarjen e ushqimeve në kopshte dhe çerdhe"	2083333	1/23/2026 12:00:00 AM	1562500
13	Skrep per Ndermarrjen e Gjelberimit	5000000	1/19/2026 12:00:00 AM	3755000
14	Blerje karburant	23583333.00	7/4/2026	22717341

DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 843/12 prot. Vlorë, më 12.05.2020

Lënda : Analizë për aktvitetin e Drejtorisë Juridike për periudhën 01.01.2026-30.04.2026

DREJTORISË SË FINANACËS, BUXHETITI DHE KONTABILITETIT

Bazuar në shkresën me Nr. 8943 prot, datë 07.05.2026 me lëndë: Mbi analizën e punës për periudhën 01.01.2026-30.04.2026 ju sqarojmë si më poshtë:

Drejtorja juridike përkatësisht specialistët e saj sikurse ka proceduar në vijmësi edhe në periudhën e vitit 01.01.2026-30.04.2026 është përqëndruar në realizimin e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Organizimit dhe të Funkcionimit të Administratës së Bashkisë. Gjithashtu është angazhuar edhe në zgjidhjen e problematikave që dalin gjatë praktikës së përditshme të punës qoftë të Drejtorisë por edhe në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të Bashkisë.

Gjatë kësaj periudhe 01.01.2026-30.04.2026 janë përgatitur akte administrative si Vendime për vendimarrje të Këshillit të Bashkisë si dhe Vendime ose Urdhëra sipas rastit të Kryetarit të Bashkiqë të cilat kanë qënë të lidhura vecanërisht me Drejtorinë Juridike. Gjithashtu është verifikuar

ligjshmëria e akteve administrative të përpiluara nga Drejtoritë dhe zyrat e tjera të Bashkisë ose Institucionet e tjera të varësise. Për të gjitha këto akte referuar argumentimit ligjor është konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë.

Mund të themi se pavarësisht diskutimeve për akte të ndryshme të Këshillit të Bashkisë, Kryetarit ose Administratës të konfirmuara nga Drejtoria Juridike në asnjë rast këto akte nuk janë shfuqizuar nga gjykata si akte të miratuara në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Konkretisht referuar të dhënave në mënyrë të koncentruar theksojmë se gjatë periudhës 01.01.2026-30.04.2026 Drejtorisë Juridike janë përgatitur rreth 5 Projekt- Vendime për Vendimarrje të Këshillit të Bashkisë, objekti i të cilave është i lidhur drejtëpërdrejt me Drejtorinë Juridike ose iniciuar prej saj.

Janë përgatitur gjithashtu disa urdhëra dhe vendime të Kryetarit të Bashkisë për problematika të ndryshme të cilat lidhen me Drejtori dhe sektorë të tjerë të Bashkisë si dhe rregullore të ndryshme. Në funksion të realizimit të procedurave të veprimtarisë së administratës së Bashkisë me autorizimin e Kryetarit të Bashkisë nga specialistët e Drejtorisë Juridike është përfaqësuar Bashkia Vlorë dhe institucionet e varësise së saj në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit në cilat është thirrur si palë e paditur si , dhe janë përgatitur kërkesë paditë kur vet Bashkia Vlorë ka inicuar proceset gjyqësore vecanërisht në zbatim të detyrave të lëna nga KLSH ose Institucione të tjera të Auditimit.

Gjatë vitit 2026 kanë nisur procedurat gjyqësoret për 20 çështje kryesisht të inicuar nga palët e treta kundër bashkisë Vlorë ose Institucioneve në varësi të saj të cilat janë ndjekur rregullisht nga specialistet e drejtorisë juridike.

Sikurse trajtuam veç çështjeve të filluara gjatë këtij viti janë ndjekur nga Drejtoria Juridike të viteve të kaluara shumë çështje të cilat janë duke u shqyrtuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Administrative e Apelit ose Gjykata e Lartë që presin të shqyrtohen si dhe çështje që pasi janë ankimuar janë risjellë përsëri për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Civile ose Administrative.

Mund të themi se Drejtoria Juridike i ka ndjekur me përgjegjësi gjithë seancat gjyqësore dhe shkallët e gjykimit me qëllim mbrojtjen e interesave të Bashkisë. Në asnjë rast nuk është konstatuar neglizhenca e specialistëve të Drejtorisë Juridike të Bashkisë në ndjekjen e procedurave gjyqësore.

Fakti që theksuam më lart sipas të cilit shumë çështje janë në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë si dhe shumë çështje janë ankimuar ose janë kthyer për rigjykim mbi bazën e ankimit të Bashkisë dhe vazhdojnë prej shumë vitesh për një vendim përfundimtar e konfirmon këtë konstatim.

Objekt i çështjeve gjyqësore ka qënë lidhur me problematika të ndryshme si kundërshtim vlere shpronësimi nga projektet e shumta në infrastrukturë, marrëdhënie pune, shlyerje detyrimesh për procedurat tatimore etj. Nga këto, mund të veçojmë si më të vështira për tu mbrojtur çështjet e vlerës së shpronësimit të pasurive pronë private të prekura nga projektet në Infrastrukturën Publike si dhe marrëdhëniet e punës.

Kjo pasi gjatë procedurës së shpronësimit llogaritja e vlerave përkatëse është bërë sipas çmimeve të references bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ndërkohë që nga pronarët pasuritë e të cilëve janë shpronësuar është kërkuar nëpërmjet gjykatës llogaritja e vlerës sipas çmimeve të tregut. Mund të themi se ka pasur raste që gjykatat kanë pranuar paditë pavarësisht pretendimeve tona.

Theksojmë se në procedurat e shpronësimit Bashkia ka kryer vetëm vlerësimin paraprak pasi vendimi përfundimtar është i Ministrisë përkatëse. Theksojmë se Vendimet e Gjykatës me detyrime financiare për Bashkinë janë në tërësi vendime të Gjykatës së Apelit pasi në çdo rast vendimet e Gjykatës së shkallës së Parë janë ankimuar.

Në punën e Drejtorisë Juridike vëmendje të veçantë ka pasur korrespondenca dhe komunikimi me Institucione të tjera shtetërore dhe pergjigjeve për kërkesat e qytetarëve sipas problematikës për të cilën është adresuar për zgjidhje Drejtoria Juridike. Në të gjitha rastet pergjigja ka qenë e përgjegjshme bazuar dhe në dispozitat ligjore në fuqi si dhe brenda afateve të parashikuara në ligjin "Për të drejtën e informimit".

Mund të themi se nga mbi 40 kërkesa dhe ankesa të adresuara Drejtorisë Juridike gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur çështje të pasqaruara për të cilat qytetarët t'i jenë drejtuar gjykatës ose organeve të tjera shtetërore në lidhje me Bashkinë Vlorë pasi kanë komunikuar direkt me Drejtorinë Juridike.

Gjithashtu i është dhënë pergjigje në kohë çdo çështjeje që lidhet me Drejtorinë Juridike portalit të bashkëqeverisjes si dhe është bashkëpunuar me Drejtorinë, Sektorët si dhe institucionet e tjera të varësisë për pergjigjet e ankesave drejtuar këtij portali

Në pergjigjen e dhënë qytetarëve për kërkesat e tyre është zbatuar sikurse theksuam më lartë procedura e parashikuar në ligjin "Për të drejtën e informimit".

Veç pergjigjeve për kërkesa dhe ankesa janë pajisur qytetarët mesatarisht çdo ditë rreth 20 vërtetime ose konfirmime të ndryshme sipas problematikës së paraqitur prej tyre. Në raste të tilla është synuar të pajisen në çast edhe pse afatet mund të ishin disa ditore.

Theksojmë se puna ditore e specialistëve të Drejtorisë Juridike është kryer në bashkëpunim, edhe me Drejtorin të tjera për plotësimin e dokumentacionit shkresor sipas problematikës së krijuar rast pas rasti.

Pavarësisht sa parashtruar më lart, mendojmë se bashkëveprimi i Drejtorive, sektorëve edhe Njësive Administrative në Bashki do të ndikojë që të ketë sa më pak kundërshtime të Akteve Administrative të Bashkisë Vlorë, të cilat shpesh ndodhin nga paqartësitë më shumë se nga përmbajtja e tyre.

Veçanërisht duhet të theksojmë se respektimi i afateve të përcaktuara ligjore për procedurat vendimmarrëse si dhe arsyetimi për çdo vendimarrje të organeve vendimmarrëse do të ndikojë në evitimin e rasteve për të cilat palët e interesuara i drejtohen Gjykatës.

Konkretisht kjo veçanërisht është e domosdoshme për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, procedurat e hartimit dhe zbatimit të projekteve në infrastrukturë si dhe procedurat e shpronësimit. E theksojmë këtë pasi gjykata i kushton rëndësi të veçantë ndjekjes se procedurave administrative për çdo vendimarrje të organeve kompetente shtetërore në rastin e qeverisjes vendore të Kryetarit dhe Këshillit të Bashkisë.

Nisur nga problematika e konstatuar në praktikën e meparshme si dhe gjatë periudhës 01.01.2026-30.04.2026 e vlerësojmë të nevojshme që para çdo vendimarrje të bashkëpunohet me specialistët e Drejtorisë Juridike.

NDËRMARRJA E PASTRIMIT

Raporit mbi analizën e punës për periudhën 01.01.2026 – 30.04.2026 sipas sektorëve, si më poshtë vijon:

Struktura e Sektorit Juridik, Ndërmarrja e Pastrimit-Bashkia Vlorë, përbëhet nga:

- 1- Përgjegjës Sektori 1 (një)
- 2- Specialist Jurist 2 (dy)
- 3- Protokoll/Arkiv 2 (dy)
- 4-Specialist për marrëdhëniet me publikun 2 (dy)

Gjatë periudhës Janar 2026 - Prill 2026, Sektori Juridik ka ushtruar veprimtarinë e tij në funksion të garantimit të ligjshmërisë së aktivitetit institucional, duke ofruar asistencë juridike të vazhdueshme për çdo strukturë të Ndërmarrjes së Pastrimit-Bashkia Vlorë, ndjekjen e Proçedurave të Prokurimit Publik, Trajtimin e kërkesave-ankesave nga qytetarët, kërkesave institucionale si dhe mbrojtjen e interesave të ndërmarrjes në raport me subjektet e treta.

Ky sektor, në zbatim të urdhërave të brendshëm mbi ngritjen e grupeve të punës, ka ndjekur hartimin e draft rregulloreve dhe rregulloreve për mirëfunksionimin e sektorëve sipas natyrës së punës, si më poshtë:

1. Draft Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Ndërmarrjes së Pastrimit, Bashkia Vlorë”.
2. Rregullore “Për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë të punëtorëve të Ndërmarrjes së Pastrimit, Bashkia Vlorë”.
3. Draft rregullore “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve Ndërmarrja e Pastrimit, Bashkia Vlorë”.
4. Rregullore “Mbi Kodin Etik në Ndërmarrjen e Pastrimit, Bashkia Vlorë”.

Ky sektor ka ndjekur procedurat e prokurimeve sipas objektit të prokurimit bazuar në Rregjistrin e Prokurimeve Publike për vitin 2026, Ndërmarrja e Pastrimit, Bashkia Vlorë, sipas bazës ligjore më poshtë:

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2016 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 68 /2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjit nr. 84/2022 “ Për Buxhetin e vitit 2022, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Manaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Proçedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit, Udhëzimit nr. 2 datë 19.01.2023 të Minisitrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2023”, V.K.B nr.5, datë 30.01.2026 “Për disa shtesa dhe ndryshime në V.K.B nr.100, datë 23.10.2025 për buxhetin e bashkisë

për vitin 2026”, V.K.B nr.20, datë 28.02.2026 “Për disa shtesa dhe ndryshime në V.K.B nr.100, datë 23.10.2025 për Buxhetin e Bashkisë për vitin 2026”, V.K.B nr.33, datë 31.03.2026 “Për disa shtesa dhe ndryshime në V.K.B nr.100, datë 23.10.2025 për buxhetin e bashkisë për vitin 2026”, në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe Sektorin Teknik ka përgatitur Rregjistrin e Parashikimeve të Proçedurave të Prokurimit Publik. Procedurat janë ndjekur bazuar në legjislacionin për prokurimin publik sa i përket Proçedurave të Prokurimeve me Vlerë të Vogël dhe Proçedurave të Prokurimeve me Vlerë të Madhe, ku konkretisht:

Për periudhën 4 mujore Janar 2026 - Prill 2026 proçedurat e realizuara dhe në proçes për procedurat e mëdha, janë si më poshtë:

- Procedura te planifikuara per vitin 2026:

Nr.	Objekti i Blerjes me Vlerë të Madhe	Tipi	Lloji i procedurës së prokurimit	Fondi limit (pa TVSH)	Burimi i financimit	Lloji i procedurës së prokurimit	Vlera e fituar (pa TVSH)	Data e lidhjes së kontratës	Statusi
1	Rroba Pune	Marveshje kuader	Mall	4,576,800	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur e thjeshtuar			Në proçes
2	Karburant	Marrëveshje Kuadër	Mall	60,720,186	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur mbi fondin	58,412,514.98		Në proces për lidhje kontrate
3	Mirëmbajtje Mjetesh	Marveshje kuader	Shërbim	20,833,333	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur mbi fondin	15,645,500		Në proces për lidhje kontrate
4	Lubrifikant	Marrëveshje Kuadër	Mall	2,999,450	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur e thjeshtuar	1,861,400	05.05.2026	Realizuar
5	Siguracione	Kontrat Klasike	Shërbim	1,700,000	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur e thjeshtuar	1,697,000	07.04.2026	Realizuar
6	Reklama dhe Adeziv	Marveshje kuader	Mall	1,250,000	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur e thjeshtuar			Në proçes
7	Materiale për lidhje të pemëve,për kurora,	Marveshje kuader	Mall	4,912,800	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur e thjeshtuar	3,691,900		Në proces për lidhje kontrate
8	Rrethim i pjacollave ku vendosen kontenierët	Marrëveshje Kuadër	Punë	9,124,872	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur e thjeshtuar	6,813,520	31.03.2026	Realizuar
9	Kompjutera	Kontratë klasike	Mall	1,166,667	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur e thjeshtuar			Në proçes
10	Blerje autovetura për mbikqyrësat	Kontratë klasike	Mall	2,300,000	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur e thjeshtuar	1,916,667		Në proces për lidhje kontrate
11	“Blerje Skiploader dhe Kontenier”	Kontratë klasike	Mall	21,250,000	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur mbi fondin			Në proçes
12	“F.V Dru dekorativ, pishat”	Marrëveshje Kuadër	Mall	12,000,000	Bashkia Vlorë	Proçedurë e Hapur			Në proçes

Procedura te nisura nga viti 2025

Në bazë të Vendimit Nr.5, datë 30.01.2026 " Për disa shtesa dhe ndryshime ne VKB Nr.100, datë 23.12.2025 për Buxhetin e Bashkisë për vitin 2026"									
Nr.	Objekti i Blerjes me Vlerë të Madhe/2025	Tipi	Lloji i procedurës së prokurimit	Fondi limit (pa TVSH)	Burimi i financimit	Lloji i procedurës së prokurimit	Vlera e fituar (pa TVSH)	Data e lidhjes së kontratës	Statusi
1	“Makinë Fshirëse dhe Larëse me Dy Krah”	Kontratë Klasike	Mall	17,359,000	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur mbi fondin	15,623,100		Në proces për lidhje kontrate
2	“Vegla Pune”	Kontratë Klasike	Mall	2,000,000	Bashkia Vlorë	Proçedurë e hapur e thjeshtuar	1 500 000	17.02.2026	Realizuar

A. Analiza 4 mujore Janar 2026 - Prill 2026, për Proçedurat e Prokurimit me Vlerë të Vogël:

- Procedura të planifikuara për vitin 2026

Nr.	Objekti i blerjes me vlerë të vogël	Tipi i kontratës	Lloji i procedurës së prokurimit	Fondi i përlogaritur (pa TVSH)	Burimi i financimit	Vlera e fituar (pa TVSH)	Data e lidhjes së kontratës	Statusi
1	Pajisje Kancelarike	Mall	Blerje me Vlerë të Vogël	250,000	Bashkia Vlorë			
2	Blerje farë bari	Mall	Blerje me Vlerë të Vogël	416,667	Bashkia Vlorë			Në fazën e specifikimeve teknike
3	Sinjalistike	Mall	Blerje me Vlerë të Vogël	166,667	Bashkia Vlorë			Në proces në kalimin e OE të radhës
4	Materiale per lidhje te pemeve	Mall	Blerje me Vlerë të Vogël	166,667	Bashkia Vlorë			Jan bashkuar me procedurë tjetër
5	Materiale për mirëmbajtje stolash	Mall	Blerje me Vlerë të Vogël	83,333	Bashkia Vlorë			
6	Karro dore me kosh me mekanizem	Mall	Blerje me Vlerë të Vogël	625,000	Bashkia Vlorë			
7	Vendosje dhe mirembajtje sistem GPS	Mall	Blerje me Vlerë të Vogël	1,000,000	Bashkia Vlorë			Në fazën e specifikimeve teknike
8	Vendosje dhe mirembajtje Kamerash Vezhguese	Mall	Blerje me Vlerë të Vogël	250,000	Bashkia Vlorë			
9	Tricikel	Mall	Blerje me Vlerë të Vogël	500,000	Bashkia Vlorë			Në proces për lidhje kontrate
10	Pajisje zyre (raffe, tavolina, karrige)	Mall	Blerje me Vlerë të Vogël	500,000	Bashkia Vlorë			
11	Rikonstruksion zyre	Punë	Blerje me Vlerë të Vogël	833,333	Bashkia Vlorë			
12	Makina Korrëse	Mall	Blerje me Vlerë të Vogël	416,667	Bashkia Vlorë	246,900	27.04.2026	Përfunduar

- Procedura të pa likujduara nga viti 2025

Në bazë të Vendimit Nr.5, datë 30.01.2026 " Për disa shtesa dhe ndryshime ne VKB Nr.100, datë 23.12.2025 për Buxhetin e Bashkisë për vitin 2026"

Nr.	Objekti i Blerjes me Vlerë të Vogël/2025	Tipi	Lloji i procedurës së prokurimit	Fondi limit (pa TVSH)	Burimi i financimit	Lloji i procedurës së prokurimit	Vlera e fituar (pa TVSH)	Data e lidhjes së kontratës	Statusi
1	"Pjesë Këmbimi dhe Riparimi i Mjeteve"	Kontratë Klasike	Shërbim	1,000,000	Bashkia Vlorë	Procedurë me Vlerë të Vogël	815,000	24.12.2025	Realizuar
2	"Pjesë Këmbimi dhe Riparimi i Mjeteve"	Kontratë Klasike	Shërbim	1,000,000	Bashkia Vlorë	Procedurë me Vlerë të Vogël	148,000	05.01.2026	Realizuar
3	"Blerje Pajisje Kancelarike"	Kontratë Klasike	Mall	166,629	Bashkia Vlorë	Procedurë me Vlerë të Vogël	83,333.50	23.12.2025	Realizuar
4	"Karroca Dore të Mbuluara"	Kontratë Klasike	Mall	1,000,000	Bashkia Vlorë	Procedurë me Vlerë të Vogël	820,000	12.01.2026	Realizuar

Shqyrtimi i ankesave/kërkesave të Subjekteve Fizik ose Juridik dhe Institucionet Shtetërore:

Gjatë periudhës janar 2026 - prill 2026 pranë Ndërmarrjes së Pastrimit, Bashkia Vlorë janë paraqitur ankesa ose kërkesa nga **Subjekte Fizik ose Juridik dhe Institucionet Shtetërore.**

Kërkesat kanë qenë të natyrave të ndryshme si:

- Kërkesa për zhvendosje koshash;
- Kërkesa për prerje pishash/pemësh;
- Kërkesa për vendgrumbullim mbetjesh urbane;

- Kërkesa autorizimi për përdorim të pikës ekzistuese vendgrumbullimit të mbetjeve;
- Kërkesa për vendosjen e një pike stacioni për grumbullim mbetjesh.
- Kërkesa për marrje masash nga Rajonet e Bashkisë Vlorë;
- Kërkesa bashkëpunimi nga institucione të tjera të pushtetit vendor;
- Kërkesa nga sektorë të ndryshëm të Bashkisë Vlorë;
- Kërkesë për pemë lule dekorative;
- Kërkesa informacioni;etj

Ankesat:

- Ankesa për pastrim bodrumi;
- Ankesa nga banorët për vendosje kontenierësh;
- Ankesa nëpërmjet numrit zyrtar të telefonit që është vendosur në dispozicion të qytetarëve të Vlorës (për pastrim rrugësh, mbledhje të mbetjeve në pikat e grumbullimit, prerje/krasitje pemësh, prerje bari, heqje të orendive shtëpiake etj.)

Në total janë: **65 kërkesa të protokolluara dhe të trajtuara** nga Ndërmarrja e Pastrimit, Bashkia Vlorë;

Nëpërmjet numrit zyrtar të telefonit të vendosur në dispozicion, nga data 12.02.2026-30.04.2026, kërkesat/ankesat të trajtuara janë: **mbi 25.**

Spektori i Financës në Ndërmarrjen e Pastrimit, për periudhën Janar – Prill 2026 paraqet të dhënat si më poshtë:

Shpenzimet e realizuara të buxhetit për periudhën Janar-Prill 2026 për të gjitha zërat buxhetor, rakorduar dhe me thesarin;

- a- Realizimi i zërave buxhetor për periudhën Janar-Prill 2026 përshkruar me shifra dhe në mënyrë narrative si më poshtë:

Gjatë katër mujorit të parë struktura e planifikuar e punonjësve është 333 dhe punonjësit faktik të Ndërmarrjes janë 288, duke krijuar një vakancë prej 45 pozicionesh, 13.5% më pak e planit organik. Kjo diferencë ka sjellë një kursim të përkohshëm në zërin e pagave dhe sigurimeve shoqërore, por mund të reflektojë rritje të ngarkesës në stafin ekzistues.

Spektori Teknik në Ndërmarrjen e Pastrimit, për periudhën janar – prill 2026 paraqet të dhënat si më poshtë:

Ndërmarrja e Pastrimit, veprimtarinë e saj e ka të organizuar mbi ofrimin e shërbimit për heqjen e mbetjeve urbane dhe jo urbane në flotën e mjeteve sipas tipeve të ndryshme, sikurse janë mjetet teknologjike në madhësi të ndryshme m3, kamiocina dhe mjetet e rënda. Ofrimi i shërbimit ofrohet në dy turne për periudhën janar – mars dhe në muajin prill është vendosur edhe mjeti i turnit të ndërmjetëm.

Sektori teknik ka treguar një angazhim të lartë dhe ka arritur rezultate konkrete brenda periudhës së analizuar.

- Përmirësim i mirëmbajtjes ne akset kryesore dhe zonat urbane;
- Koordinim më efikas i grupeve të punës;
- Përmirësimi i nivelit të pastertisë në zonat urbane;
- Reagim më të shpejtë ndaj problematikave të terrenit

Sektori i Terrenit, Ndërmarrja e Pastrimit-Bashkia Vlorë

Referuar monitorimit dhe vlerësimit të punës së kryer nga Sektori i Terrenit të Ndërmarrjes së Pastrimit-Bashkia Vlorë, mbi analizën e punës për realizimin e detyrave funksionale, problematikave të evidentuara në terren si dhe masat e marra për përmirësimin e shërbimit ndaj komunitetit janë zbatuar planet e punës, si më poshtë vijon:

Ndërmarrja e Pastrimit dhe Gjelbërimit gjatë Periudhës Janar-Prill 2026 ka zhvilluar aktivitetin e saj në përputhje me planet mujore të punës dhe nevojat e evidentuara në të pestë Rajonet e qytetit.

Puna është fokusuar në pastrimin e rrugëve, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta, ndërhyrjet emergjente të krijuara nga kushtet atmosferike.

Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar një sërë problematikash në zona të ndryshme të qytetit të cilat kanë sjellë dhe ankesa nga qytetarët në adresë të ndërmarrjes.

Në shumë raste është bërë dalja jashtë planeve të punës për të përballuar situata emergjente apo problematika të përsëritura.

Aktiviteti i zhvilluar nga Sektori i Terrenit

Organizimi i punës:

- Rrugët kryesore janë fshirë dhe pastruar çdo ditë;
- Rrugët dytësore janë pastruar një herë në tre ditë;
- Rrugët periferike një herë në javë;

Problematikat konsistojnë në ndotjen e hapësirave publike pranë pikave të kontenierëve, shtimi i mbetjeve inerte dhe orendive shtëpiake, mungesa e ndërgjegjësimit qytetar në disa zona të qytetit, si rezultat, ndërmarrja është e detyruar në disa raste të kryej ndërhyrje shtesë jashtë planit të punës.

Mirëmbajtja e gjelbërimit:

Lulishtet sipas rajoneve (1-5) punonjësit kryejnë aktivitetin duke realizuar korrje bari, krehje, grumbullim mbeturinash, qethje gardh i gjelbër me gërshërë etj...

Gjatë kësaj periudhe puna është fokusuar në disa drejtime kryesore duke realizuar:

Mirëmbajtjen e Bulevardit nga Xhamia deri në rrethin e Skelës (pylli orbital), me punim drurësh me bel të pemëve të llojit (rrap) si dhe mbjelljen e palmave tek parcelat në Lungomare.

Mirëmbajtjen e lulishteve, konkretisht të listuara si më poshtë:

- Lulishtja në Sheshin e Flamurit;
- Lulishtja pranë varrezave të Dëshmorëve;
- Lulishtja pranë Postës Qëndrore;
- Parcela tek Rruga e Re të dy krahët (korrje);
- Lulishtja tek Rruga e Re përball “Fjortes”;
- Lulishtja 8 Nëntori tek fagonat e Tiranës;
- Lulishtja tek Lapidari tek rruga e Spitalit;
- Lulishtja tek xhamia e kuqe pranë Rajonit 1;
- Parcela pranë Bashkisë Vlorë;
- Lulishtet nëpër blloqe banimi në çdo rajon
- Në brendësi të pallatit në formë L;
- Lulishtet anës tortuarëve tek rruga e Bibliotekës;
- Lulishtet tek shkolla 24 Maji;
- Lulishtet në formë trekëndëshi afër shkollës së Naftës, gjithashtu lulishtja e re përball karburantit Fjortes në lagjen 24 Maji;
- Lulishtja mbrapa klinikës Bakaj;
- Lulishtet në bllokun pranë Shkollës Marigo Posio;

Punimi i drurëve të pemëve në rrugët:

- Rruga Mis Durhan;
- Rruga Veledin Kollozi;
- Rruga Albano-Romina;
- Rruga Gjergj Araniti (Çipajt);
- Rruga pranë pastičeri Elezaj;

Gjithashtu janë kryer edhe detyra të tjera si mirëmbajtja e parcelave në Lungomare, korrja me zetar si dhe makina korrëse me kosh si dhe te zona e Rrapit në Ujë të Ftohtë rikonceptim i lulishtes dhe pajisja me sistem vaditës.

Larja e rrugëve me bot uji dhe lavazho kryhet në:

- Bulevardin Vlorë-Skelë nga të dy krahët;
- Rruga Transballkanike nga rrethrotullimi i Kastratit deri tek rrethi te Vola;
- Larje në zonën e Skelës dhe Lungomares;

Fshirje me autofshesë të të gjitha rrugët kryesore të qytetit.

Arritjet kryesore

Gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2026 (01.01.2026-30.04.2026) janë evidentuar këto rezultate:

- Përmirësim i nivelit të pastërtisë zë zonat urbane kryesore të qytetit të Vlorës;
- Rritja e monitorimeve në terren;
- Reagim më i shpejtë ndaj problematikave të raportuara;
- Bashkëpunim më efikas nëpërmjet Sektorit operativ/Sektorit Teknik;
- Reduktim i pikave problematike për depozitimin e mbetjeve;
- Marrja e masave për përballimin e punës gjatë sezonit veror;
- Përmirësim i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra në zonat kryesore të qytetit;
- Shtim i ndërhyrjeve për mirëmbajtjen e lulishteve dhe ambienteve publike;

- Rritja e numrit të bimëve dhe luleve dekorative të mbjella në qytet;
- Përmirësim i estetikës urbane në akset kryesore dhe zonat turistike;
- Koordinim më efikas i grupeve të punës në terren;

Për sa më sipër, Sektori i Terrenit, Ndërmarrja e Pastrimit-Bashkia Vlorë mbetet i angazhuar për rritjen e cilësisë së shërbimit, përmirësimin e estetikës urbane dhe përmbushjen me korrektësi të detyrave funksionale në shërbim të qytetit dhe komunitetit, duke kontribuar në krijimin e një qyteti më të pastër.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Me VKB-në nr. 98, datë 27.11.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara – 2026“, është miratuar niveli i pagave dhe numri i punonjësve i cili është:

Në administratën e Bashkisë Vlorë – 394 pozicione, në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike - 150 pozicione, në Qendrën Kulturore - 30 pozicione, në Teatrin Petro Marko - 31 pozicione, në Klubin Shumësportësh “Flamurtari” - 17 pozicione, në Qendrën e Zhvillimit PAK - 22 pozicione, në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane - 39 pozicione, në Qendrën e Shërbimeve me Baze Komunitare për Femijet me Aftësi të Kufizuara - 11 pozicione dhe Ndërmarrjen e Pastrimit - 333 pozicione.

Pjesë e kësaj strukture janë edhe funksionet të transferuara në Bashkinë Vlorë pas Reformës Territoriale: Arsimi parashkollor / punonjësit jomësor (sistemi 9 vjeçar) - 355 punonjës, Arsimi i mesëm punonjës jomësor - 51 punonjës, Sektori Bordit të Kullimit - 17 punonjës, Sektori e Pyjeve dhe Kullotave - 6 punonjës, Sektori e Rrugëve rurale - 5 punonjës, Sektori i MNZSH - 50 punonjës.

Situata e personelit paraqitet si më poshtë:

Numri total i punonjësve: 1607

Gjatë vitit janë realizuar:

Procedura rekrutimi për pozicione vakante: 267

Emërimet në shërbimin civil: 15

Lirime nga detyra (përfshirë dorëheqje, pension, masa disiplinore): 232

Procedurat janë zhvilluar në respektim të parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe meritokracisë.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore, gjatë periudhës Janar–Prill 2026, ka ushtruar veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, strukturën organizative të miratuar dhe objektivat institucionale të Bashkisë, me fokus në administrimin efektiv të marrëdhënieve të punës, garantimin e funksionimit normal të administratës dhe rritjen e eficiencës në menaxhimin e kapitalit njerëzor.

Veprimtaria e Drejtorisë është përqendruar në:

- administrimin e personelit;
- zbatimin e legjislacionit të punës dhe shërbimit civil;
- menaxhimin e procedurave të rekrutimit dhe lëvizjeve të personelit;
- monitorimin e disiplinës në punë;
- përmirësimin e organizimit administrativ;
- trajtimin e problematikave të evidentuara në strukturat e institucionit.

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria ka vijuar administrimin dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit për të gjithë punonjësit e institucionit, duke garantuar:

- plotësimin e dosjeve personale;
- administrimin e akteve të emërimit, transferimit, komandimit dhe lirimit nga detyra;
- evidentimin e lejeve vjetore, raporteve mjekësore dhe mungesave;
- monitorimin e afateve kontraktuale dhe procedurave administrative.

Është kryer verifikimi periodik i dokumentacionit të administratës me qëllim evidentimin e mangësive dhe marrjen e masave për përmirësimin e standardeve administrative.

Në kuadër të nevojave institucionale dhe funksionimit normal të strukturave administrative:

- janë zhvilluar procedura rekrutimi për pozicione vakante;
- janë trajtuar procedura komandimi dhe transferimi;
- janë realizuar emërimë në përputhje me nevojat operative dhe strukturën e miratuar;
- janë ndjekur procedurat për ndërprerje marrëdhëniesh pune në rastet e parashikuara nga legjislacioni.

Drejtoria ka bashkëpunuar me njësitë përgjegjëse për të garantuar respektimin e kritereve ligjore dhe transparencën në procedurat e punësimit. Një ndër prioritetet kryesore të periudhës ka qenë forcimi i disiplinës administrative dhe respektimi i etikës në shërbimin publik.

Në këtë kuadër janë monitoruar respektimi i orarit zyrtar dhe paraqitja në punë, evidentuar rastet e shkeljeve disiplinore dhe janë administruar procedura paralajmërimi dhe masa administrative sipas legjislacionit në fuqi;

Gjithashtu është punuar për rritjen e përgjegjshmërisë së punonjësve dhe përmirësimin e komunikimit institucional ndërmjet strukturave.

Drejtoria ka ofruar mbështetje të vazhdueshme për strukturat e institucionit në lidhje me:

- interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit të punës;
- ndarjen e ngarkesës së punës;
- organizimin administrativ të sektorëve;
- trajtimin e konflikteve administrative dhe problematikave të personelit.

Janë zhvilluar takime koordinuese me drejtuesit e drejtorive për evidentimin e nevojave dhe përmirësimin e eficiencës organizative.

Gjatë periudhës objekt analize janë identifikuar nevojat për trajnim të administratës me qëllim:

- rritjen e kapaciteteve profesionale
- përmirësimin e njohurive mbi legjislacionin
- forcimin e standardeve të shërbimit publik.

Punonjësit kanë marrë pjesë në aktivitete trajnuese dhe informuese sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë.

Gjatë ushtrimit të aktivitetit janë evidentuar disa problematika, ndër të cilat:

- mosrespektimi i orareve të punës nga punonjës të veçantë;
- vonesa në kthimin e përgjigjeve administrative nga disa struktura;
- nevoja për rritje të koordinimit ndërmjet sektorëve;
- mbingarkesë pune në disa njësi administrative;
- nevoja për standardizim më të plotë të procedurave të brendshme.

Për këto raste janë marrë masa administrative dhe organizative me qëllim përmirësimin gradual të situatës.

Për periudhën në vijim Drejtoria e Burimeve Njerëzore synon:

- forcimin e disiplinës administrative
- rritjen e eficiencës në menaxhimin e personelit
- përmirësimin e procedurave të vlerësimit të performancës
- standardizimin e praktikave administrative
- rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale
- përmirësimin e komunikimit ndërmjet strukturave.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore vlerëson se gjatë periudhës Janar–Prill 2026 është garantuar vijimësia normale e funksionimit administrativ dhe janë ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion. Pavarësisht problematikave të evidentuara, puna ka vijuar me fokus në respektimin e ligjshmërisë, rritjen e eficiencës administrative dhe garantimin e standardeve të shërbimit publik, duke synuar përmirësim të vazhdueshëm të performancës institucionale.

Mbi ecurinë e punës së Sektorit të IT-s

Periudha: Janar – Prill 2026

Në zbatim të detyrave funksionale dhe objektive të përcaktuara për mirëmbajtjen, administrimin dhe zhvillimin e infrastrukturës teknologjike të institucionit, Sektori i IT-së pranë Bashkisë Vlorë ka vijuar punën përgjatë periudhës Janar – Prill 2026 në drejtim të garantimit të funksionimit

normal të sistemeve informatike, rrjeteve kompjuterike, pajisjeve elektronike dhe platformave dixhitale të përdorura nga administrata.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar këto procese pune:

1. Mirëmbajtja dhe administrimi i infrastrukturës IT

- Është kryer monitorimi dhe mirëmbajtja periodike e pajisjeve kompjuterike, printerave, skanerëve dhe pajisjeve të tjera elektronike në përdorim nga administrata e Bashkisë Vlorë.
- Janë evidentuar dhe zgjidhur problematikat teknike të raportuara nga drejtoritë dhe sektorët përkatës.
- Është realizuar instalimi dhe konfigurimi i sistemeve operative, programeve bazë dhe aplikacioneve të nevojshme për funksionimin e punës administrative.
- Është garantuar funksionimi i rrjetit të brendshëm (LAN), aksesit në internet dhe lidhjeve VPN për përdoruesit përkatës.

2. Administrimi i sistemeve dhe platformave elektronike

- Është ofruar asistencë teknike për përdorimin e platformave shtetërore dhe sistemeve elektronike në funksion të administratës.
- Janë kryer konfigurime dhe përditësime të profileve të përdoruesve në sistemet elektronike sipas kërkesave të drejtorive.
- Është monitoruar funksionimi i sistemeve të aksesit dhe pajisjeve të kontrollit elektronik.

3. Siguria dhe mbrojtja e të dhënave

- Janë realizuar kontrole periodike mbi sigurinë e pajisjeve dhe aksesit në sistemet kompjuterike.
- Është kryer përditësimi i programeve antivirus dhe kontrollet për mbrojtjen e të dhënave institucionale.
- Janë ndërmarrë masa për ruajtjen dhe backup-in e të dhënave në pajisjet përkatëse.

4. Mbështetja teknike për administratën

- Sektori i IT-së ka ofruar asistencë të vazhdueshme teknike për punonjësit e institucionit në lidhje me problematikat e përditshme informatike.
- Janë realizuar ndërhyrje teknike në zyrat e administratës për zgjidhjen e problematikave hardware dhe software.
- Është ofruar suport teknik gjatë zhvillimit të aktiviteteve, mbledhjeve dhe proceseve administrative që kërkojnë pajisje audio-vizive ose lidhje elektronike.

5. Projekte dhe procese në vijim

- Gjatë kësaj periudhe është vijuar puna për përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës teknologjike të institucionit.
- Është bashkëpunuar me drejtoritë përkatëse për evidentimin e nevojave për pajisje dhe sisteme elektronike.
- Janë ndjekur procedurat për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe specifikimeve për pajisje dhe sisteme IT sipas nevojave të institucionit.

ANALIZA E PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-MAJ 2026 E SEKTORIT TË ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT.

A. FUSHA E ARSIMIT

Gjatë periudhës janar–maj 2026, Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit ka vijuar ushtrimin e funksioneve të tij në drejtim të administrimit, monitorimit dhe përmirësimit të shërbimeve arsimore dhe parashkollore në territorin e Bashkisë Vlorë.

1. Monitorimi i kopshteve dhe çerdheve

Bazuar në VKB nr.97, datë 28.12.2020 “Plani i përmirësimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”, janë realizuar kontrole dhe monitorime të paplanifikuara në kopshte dhe çerdhe për:

- zbatimin e orarit të punës;
- menaxhimin institucional;
- cilësinë e shërbimit ndaj fëmijëve;
- respektimin e kushteve higjiëno-sanitare;
- kujdesin dhe sigurinë ndaj fëmijëve.

Gjithashtu është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme procesi i regjistrimeve në kopshte dhe çerdhe, si dhe janë adresuar problematikat e evidentuara nga prindërit dhe institucionet.

2. Mbështetja për fëmijët me aftësi të kufizuara

Në zbatim të Urdhrit të Brendshëm nr.610, datë 30.10.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Edukativ Individual (PEI)”, sektori ka mbikëqyrur, koordinuar dhe drejtuar grupin përgjegjës për:

- përditësimin e planeve PEI për 46 fëmijë me aftësi të kufizuara;
- koordinimin me mësueset mbështetëse;
- monitorimin periodik të progresit të fëmijëve çdo 3 muaj.

Gjithashtu është realizuar koordinimi me Qendrën Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara për organizimin e trajnimeve orientuese për mësueset mbështetëse në lidhje me PEI.

3. Bonusi i ekselencës

Është zhvilluar procesi i mbledhjes, verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit për bonusin financiar të nxënësve ekselentë të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme.

Për vitin shkollor 2025–2026 janë trajtuar me bonus financiar:

- 275 nxënës të shkollave 9-vjeçare publike;
- 117 nxënës të shkollave të mesme publike.

Në vijim të politikave mbështetëse për arsimin është hartuar relacioni dhe projektvendimi për zgjerimin e fashës së përfituesve të bonusit të ekselencës për vitin 2026.

4. Hartimi i akteve administrative dhe projektvendimeve

Gjatë kësaj periudhe janë hartuar materiale dhe projektvendime për Këshillin Bashkiak, konkretisht:

1. “Për zgjerimin e fashës së nxënësve ekselentë të përfshirë në bonusin e ekselencës për vitin 2026”;
2. “Për kalimin e Kopshtit ‘M.Q. Atatürk’ në kopsht me ushqim dhe hapjen e shërbimit të çerdhes në të njëjtën godinë”;
3. Projektvendimi “Për disa ndryshime të përfaqësuesve të Bashkisë Vlorë në bordet e institucioneve arsimore publike dhe jo publike”.

5. Veprimtari edukative dhe aktivitete institucionale

Në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore Vlorë–Himarë u organizua dhe finalizua aktiviteti për Festën e Mësuesit, ku u vlerësuan me titullin “Mirënjohje e Qytetit” 25 mësues.

Gjithashtu janë organizuar dhe koordinuar aktivitete edukative dhe sociale, ndër të cilat:

- Aktiviteti “Dita e Tokës” në Kopshtin nr.2;
- Aktivitet teatral në bashkëpunim me Pallatin e Kulturës “Ku janë ëndrrat”, me pjesëmarrjen e të gjitha kopshteve të qytetit;
- Java e Shkencës me të rinjtë e qytetit, ku u vlerësuan tre ekipet fituese, dy ekipe nga shkolla “Ali Demi” dhe një ekip nga Shkolla Internacionale.

6. Administrimi, monitorimi dhe grupet e punës

Spektori ka qenë pjesë e:

- grupit të punës për rishikimin dhe përfundimin e rregullores së unifikuar për kopshtet dhe çerdhet e Bashkisë Vlorë;
- hartimit të dy modeleve standarde të monitorimit për:
 1. kopshtet me ushqim;
 2. kopshtet pa ushqim.

Gjithashtu janë realizuar:

- inventarizime në shkollat 9-vjeçare në zbatim të Urdhrit nr.25, datë 12.01.2026;
- pjesëmarrje në komisione të ndryshme KVO sipas urdhrave të brendshëm;
- hartim specifikimesh teknike dhe përlllogaritje fondi limit;
- pjesëmarrje në grupe pune për monitorimin dhe raportimin e kontratave;
- pjesëmarrje në trajnime dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga drejtoritë e Bashkisë Vlorë.

Gjithashtu janë zhvilluar takime institucionale me Prefektin e Qarkut Vlorë në kuadër të koordinimit ndërinstitutional për çështjet e sigurisë në shkolla, masat parandaluese dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për garantimin e sigurisë së nxënësve dhe stafit arsimor

B. FUSHA E RINISË

Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr.79/2019 “Për Rininë”, sektori ka ndërmarrë iniciativa për fuqizimin, përfshirjen dhe aktivizimin e të rinjve në jetën sociale dhe komunitare.

1. Aktivitetet rinore dhe bashkëpunimet ndërkombëtare

U organizuan dhe koordinuan aktivitete me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, ndër të cilat:

- aktiviteti me YEP (Youth European Parliament), me pjesëmarrjen e 135 të rinjve nga vende të ndryshme të botës; i zhvilluar për 3 ditë në qytetin e Vlorës;
- takime me përfaqësues të Bashkimit Evropian, UNDP dhe Zyrës së Punës në kuadër të Dokumentit të Politikave Prioritare 2027–2029;
- takime me përfaqësues të IOM për realizimin e materialeve promovuese me studentë.

2. Këshilli Vendor Rinor

Është realizuar ngritja e Këshillit Vendor Rinor të Bashkisë Vlorë, si strukturë konsultative dhe përfaqësuese e të rinjve.

Në vijim janë organizuar aktivitete dhe takime me të rinjtë anëtarë të këshillit dhe të rinjtë e qytetit, me fokus:

- pjesëmarrjen qytetare;
- edukimin demokratik;
- aktivizimin social dhe komunitar.

3. Karta e Studentit

Sektori ka vijuar procedurat administrative dhe databazën për Kartën e Studentit, në funksion të lehtësimit të shërbimeve dhe përfitimeve për studentët e Bashkisë Vlorë.

C. FUSHA E SPORTIT

Në zbatim të Ligjit nr.79/2017 “Për Sportin”,

1. Përgatitja e moduleve orientuese sportive

Gjatë periudhës janar–maj 2026 është përgatitur moduli orientues:

“Rëndësia e Sporteve dhe Ushtrimet Bazë në Kopshte”

Ky modul është hartuar me qëllim:

- ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e aktivitetit fizik në moshë të hershme;
- promovimin e ushtrimeve bazë sportive në institucionet parashkollore;
- mbështetjen e stafit edukativ me materiale orientuese për zhvillimin e aktiviteteve fizike me fëmijët.

2. Aktivitetet sportive dhe organizative

Sektori ka qenë pjesë e grupit të mbarëvajtjes së aktivitetit “Turi 83 ciklistik i Shqipërisë”.

III. PËRFUNDIME

Gjatë periudhës janar–maj 2026, Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit ka ushtruar funksionet e tij në drejtim të:

- përmirësimit të shërbimeve arsimore dhe parashkollore;
- mbështetjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- promovimit të ekselencës në arsim;
- fuqizimit të rinisë dhe pjesëmarrjes qytetare;
- promovimit të aktiviteteve sportive dhe edukimit fizik;
- monitorimit administrativ dhe institucional.

Veprimtaria e sektorit është karakterizuar nga bashkëpunimi ndërinstytucional, pjesëmarrja në iniciativa kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe angazhimi për rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve të Bashkisë Vlorë.

DREJTORIA E PROTOKOLL – ARKIVËS SEKTORI I PROTOKOLL – ARKIVËS

Veprimtaria në Sektorin e Protokoll - Arkivës, bazohet në:

- Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.
- Vendimin Nr.4 datë 19.06.2017, të Këshillit të Lartë të Arkivave “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.
- "Norma tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Vendimet e Kryetarit dhe rregullores së Sektorit.

Në protokoll:

- Në protokoll cdo ditë janë kryer veprimet për pranimin, evidencimin, shpërndarjen dhe nisjen e korrespondencës;
- Është kontrolluar zbatimi i kërkesave që duhet të përmbushë dokumenti;
- Janë hapur dosjet sipas pasqyrës emërtuese të celjes së tyre dhe vendosen e sistemohen në to dokumentat vazhdimisht;
- Është siguruar dorëzimi i plotë dhe në kohë i dokumenteve që krijohen dhe hyjnë në institucion;
- Janë plotësuar kërkesat për shfrytëzim operativ të dokumenteve nga drejtoritë e Bashkisë, duke bërë evidencimin e tyre;
- Pranimi i dokumenteve hyrës është bërë në Sektorin e Protokoll - Arkivës, cdo ditë nga punonjësit e zyrës së protokollit.
- Të gjithë dokumentet hyrës, cdo ditë pasi janë protokolluar, janë dorëzuar tek Kryetari i Bashkisë. Pasi kthehen dokumentet me nënshkrim, shënohen në kolonën përkatëse në regjistrin e korespondencës mod.1 dhe u shpërndahen drejtorive përkatëse kundrejt firmës, sipas librit të dorëzimit të dokumenteve nga sekretaria në sektorë dhe anasjelltas, Mod 4/1.

- Dokumentet e hyra në Bashkinë Vlorë, cdo ditë iu shpërndahen Drejtorëve.
- Dokumentet dalëse janë protokolluar cdo ditë dhe pas protokollimit, janë mbyllur dokumentet në zarfe, është plotësuar zarfi, dhe janë regjistruar ato në librin e dorëzimit mod.4. më pas është kryer cdo ditë shërbimi postar.
- Për periudhën Janar – Prill, numri i protokollit në regjistrin e korespondencës ka arritur afërsisht në 8500, pa përfshirë numrat e protokollit me fraksion.
- Cdo ditë janë nisur me shërbimin postar mesatarisht mbi 100 zarfe.

Në arkivën e Institucionit (ish- Arkiva e Urbanistikës):

Në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 Për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në parashikimet e “Kodit të procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, është realizuar trajtimi administrativ dhe kthimi i përgjigjeve për shkresat dhe kërkesat e paraqitura nga qytetarë dhe subjekte juridike, të gjitha duke respektuar afatet dhe procedurat ligjore në fuqi.

Në funksion të koordinimit institucional dhe mbarëvajtjes së proceseve administrative, është realizuar korrespondenca e brendshme me drejtoritë përkatëse të Bashkisë Vlorë, për përcjelljen, trajtimin dhe ndjekjen e dokumentacionit sipas kompetencave përkatëse.

Gjithashtu, është kryer trajtimi/kthimi i përgjigjeve apo përcjellja e informacionit për email-et e deleguara nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Koordinatori i Bashkëqeverisjes, në kuadër të garantimit të transparencës dhe komunikimit institucional me qytetarët dhe subjektet e interesuara.

Po ashtu, është realizuar pranë Zyrës së Informacionit të Institucionit, One Stop Shop, sipas kërkesave të paraqitura nga qytetarët dhe kërkesave për asistim nga punonjësit e kësaj zyre, konsultimi dhe informimi i qytetarëve të interesuar, lidhur me procedurat administrative për tërheqjen e dokumentacionit të depozituar pranë Drejtorisë së Protokoll-Arkivës, duke ofruar orientimin e nevojshëm për ndjekjen e procedurave përkatëse.

Gjatë periudhës 01.01.2026 - 30.04.2026, janë shërbyer kopje të njësuara të dokumentacionit teknik të dokumentuara në Zyrën e Protokoll-Arkivës në 64 kërkesa, si edhe rreth 11 korrespondenca shkresore për raportim drejtuar eprorit (vlen të theksohet fakti se procesi i punës ka vijuar dhe në mungesë të pajisjes printer/fotokopje format A4/A3, prej muajit janar 2026 është dëmtuar dhe është jashtë funksionit në përdorim të Zyrës së Arkivës, ku fotokopjimi dhe printimi i dokumentacionit është kryer në zyra të tjera, duke sjellë vështirësi dhe në kryerjen normale të punës).

Nga këto kërkesa hyrëse rreth 60% e dokumentacionit të njësuar me origjinalin i është vënë në dispozicion institucioneve shtetërore, ndërsa rreth 40% është shërbyer për persona të interesuar ose të autorizuar, përfshirë pronarë trualli, shoqëri ndërtimi dhe individë të përfshirë në marrëdhënie juridike mbi pasuritë e paluajtshme, ku është garantuar shërbimi korrekt ndaj subjekteve të

interesuara, duke vënë në dispozicion kopje dokumentesh të njehsuara me origjinalin, pa komente apo interpretime.

Gjithashtu ju informojmë se pasi ka përfunduar procesi i inventarizimit të dosjeve të mbetura të vitit 2000, i cili është kryer plotësisht vetëm nga ana ime pa asistimin e një grupi pune (ç'ka theksohet për shkak të volumit të konsiderueshëm të dokumentacionit për periudhën 1992-2000), Zyra e Arkivës së Institucionit (ish- Arkiva e Urbanistikës) i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit, nëpërmjet shkresës nr. 6585 prot, datë 03.04.2026, me lëndë “Kërkesë për sqarim mbi procedurën dhe institucionin kopetent për dorëzimin e dokumentacionit arkivor”. Kjo kërkesë është paraqitur me qëllim respektimin e detyrimeve ligjore, vijueshmërisë institucionale dhe shmangien e përgjegjësiave administrative, duke kërkuar një saktësim të qartë dhe zyrtar të institucionit kopetent ku do të kryhet dorëzimi i inventarëve dhe dokumentacionit arkivor përkatës, si dhe përcaktim i çdo procedure shtesë që vlerësohet e nevojshme për realizimin korrekt të këtij procesi.

Paralelisht, gjatë kësaj periudhe, pranë Zyrës së Arkivës së Institucionit (ish- Arkiva e Urbanistikës) ka nisur puna për procesin e përpunimit dhe inventarizimit të dokumentacionit i cili ka plotësuar afatin e ruajtjes dhe administrimit pranë institucionit fondkrijues (25 vite nga krijimi i tij), përkatësisht dokumentacioni i vitit 2001, për dorëzim sipas rregullave arkivore në fuqi.

Në kuadër të administrimit dhe ruajtjes së dokumentacionit arkivor në zyrën e arkivës të cilën administroj, gjatë kësaj periudhe është vijuar puna për përmirësimin e kushteve të sistemimit dhe administrimit të dokumentacionit në ambientet e arkivës. Është kryer evidentimi dhe sistemimi i dokumentacionit ekzistues në dosje arkivore, duke realizuar ndarjen dhe organizimin e tij, me qëllim administrimin sa më korrekt dhe lehtësimin e aksesit në dokumentacion, por edhe mirëmbajtja e dokumentacionit administrues. Ky proces synon përmirësimin e kushteve të administrimit të fondit arkivor, rritjen e efikasitetit në menaxhimin e dokumentacionit dhe garantimin e ruajtjes së tij sipas standardeve dhe praktikave arkivore dhe vijon të ndiqet në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar administrimin e rregullt të dokumentacionit dhe përmirësimin e shërbimit institucional ndaj qytetarëve dhe strukturave administrative.

Në përfundim proceset e mësipërme janë realizuar në përputhje me detyrat funksionale dhe kuadrin ligjor në fuqi, duke synuar rritjen e eficiencës në administrimin e dokumentacionit, përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve dhe garantimin e një menaxhimi sa më korrekt të fondit arkivor.

DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EVROPIAN DHE DIASPORËS

Detyrat e drejtorisë gjatë kësaj perjudhe kanë konsistuar në realizimin e aktiviteteve të projekteve në proces zbatimi, trajnimeve, aplikimeve, bashkaplikimeve dhe shprehjeve të interesit në partneritet me institucione ndërkombetare si dhe në bashkërendim dhe koordinim me strukturat e bashkisë për përfshirjen sipas nevojave dhe thirrjeve të donatoreve dhe fondeve.

Në mars 2026 Drejtoria ka marrë në administrim Projektet të cilat janë në proces zbatimi dhe në fillim sipas Urdhërit nr.95 datë 29.01.2026 nr. 1942 datë 29.01.2026 prot:

1. **Projekti SPICE-IPA Adriatiku Jugor 2021-2027** pas miratimit të marrëveshjes në këshillin bashkiak është në fazën ku ka përfunduar procedurës financiare, celjen e llogarisë bankare. Është mbyllur raportimi i fazës së parë të periudhës së raportimit në sistemin JEMS dhe do të vazhdohet me zbatimin e aktiviteteve. Pjesëmarrje në trajnimin për menaxhimin e projektit në Bari.
2. **Projekti SMART CITIES INTERREG Shqipëri –Greqi** është në fazën e procedurës financiare, celjes së llogarisë bankare dhe fillimin e procedurave të prokurimit për ekspertizë të jashtme sipas rregulave të PRAG.
3. **Projekti SACRED4TRAVELS-ERASMUS**, është në fazën e procedurës financiare, është celur llogaria bankare dhe zbatimin e aktiviteteve sipas planit të projektit.
4. **Projekti RELOAD 3-UNDP** ka kaluar për miratim në këshillin bashkiak në shkurt 2026. Aktualisht ka përfunduar vlerësimin e aplikimeve nga organizatat e shoqërisë civile dhe do të vijoj puna me zbatimin e aktiviteteve të radhës.
5. **Projekti AQVA NOSTRA** ka kaluar për miratim në këshillin bashkiak në shkurt 2026 si dhe po vijohet me pjesëmarrjen në aktivitetet e parashikuara të projektit.
6. **Projekti UNITING ROUTES-CERV** është në fazën e zbatimit të aktivitetit që do të organizohet në Bashkinë Vlorë me pjesëmarrjen e partnerëve.
7. **Projekti CIRCUS- Programi INTERREG IPA-ADRION**
Strategjitë e ekonomisë qarkulluese, planet e veprimit dhe zgjidhjet për tranzicionin e sistemeve agroushqimore në komunitetet bregdetare te zones ADRION (Circular economy Strategies, action plans, and Solutions for agrifood systems transition in ADRION coastal communities). Është mbyllur faza e tretë e raportimit dhe do të ndiqen procedurat në vazhdim si dhe zbatimi i aktiviteteve të mbetura.
8. **Projekti PREVENT- Programi INTERREG IPA.** Reduktimi i ndotjes dhe paralajmërimi i hershëm për ekosistemet vulnerabël në territoret Adriatik-Jon.
Është mbyllur faza e tretë e raportimit dhe do të ndiqen procedurat në vazhdim si dhe zbatimi i aktiviteteve të mbetura.
9. Në lidhje me sektorin e Diasporës është dërguar komunikimi me institucionet vendore për të mbledhur të dhëna në lidhje me migrimin e brendshëm dhe diasporën . Gjithashtu asistohen en sportel kërkesat për informacion dhe regjistrim për migracionin dhe diasporën.

Bashkë aplikime të bëra nga drejtoria dhe shkrim projekti

-Asistencë në bashkëaplikim dhe letër mbështetëse nr.8696/1 prot. datë 05.05.2026 për Projektin “ART4SEAU” në kuadër të Programit CREA-CULT-2026-COOP/BE.

-Është nënshkruar marrëveshja nr.7138 prot datë 14.3.2026 me SDC për Projektin Promoting Digital Rights AND Enhancing Digital Literacy” financuar nga BE. Jemi pjesë e zbatimit të aktiviteteve.

-Letër mbështetëse nr.5957 prot. Datë 26.03.2026 në kuadër të Projektit “Kujtesë në imazh”.

-Aplikim dhe përfaqëim në konkursin e Migracionit dhe Diasporës 25 prill 2026.

-Relacion mbi Samitin e IV të Diasporës Shqiptare nr.5680/1 datë 24.03.2026.

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Në zyrën e administrimit dhe mbrojtjes së tokës të Bashkisë Vlorë, pjesë e DPPMA-së, në zbatim të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së 1182, datë 24.12.2020, “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”; VKM-së 1174 të VKM –së Nr.1174, datë 24.12.2020, “Për procedurat e regjistrimit të amtp-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”; është punuar në raport me praktikën e fermerëve duke plotësuar dhe dërguar në ASHK, DV-Vlorë dosjen përkatëse të çdo fermeri.

Këto shkresa janë praktika të dërgimit të dosjeve të tokave në përdorimit të cilat dërgohen në ASHK për kalimin në pronësi si dhe praktika të regjistrimit të AMTP-ve në zbatim të VKM-së 1174/2020.

Në ndjekje të procedurave të kalimit nga përdorimi në pronësi në zbatim të VKM-së 1182/2020, në bashkëpunim me zyrën e ASHK, Dv-Vlorë janë verifikuar dhe janë mbajtur Akt –konstatime për 130 subjekte prej të cilëve janë dërguar për shpallje në bashki 18 praktika.

Vec sa më lartë në këtë zyrë janë mbajtur edhe korespondenca me institucionet e treta , si gjykat, prekurori, Qark, ATP etj.

Në vijim të punës tonë si zyrë për këtë periudhë , janë trajtuar edhe kërkesat për vërtetime të ndryshme si dhe për vjeljen e taksës së tokës bujqësore në zbatim të ligjit.

Në bashkëpunim me ASHK, Dv-Vlorë të rakordohet për akt-konstatimet e procedurave për kalimet nga përdorimi në pronësi të tokave bujqësore në përdorim

2. Në sektorin e inventarizimit dhe regjistrimit të Pronave të Paluajtshme

Kryetari i Bashkisë Vlorë me Urdhërin e Brendshëm Nr.371 datë 11.09.2024, protokolluar me Nr.14036 prot datë 11.09.2024, “Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e dokumentacionit ligjor e teknik për procedurën e inventarizimit të pronave shtetërore”, ka ngritur grupet e punës, të cilat kanë vijuar me hartimin e dokumentacionit ligjor e teknik për procedurën e inventarizimit dhe transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore, në pronësi të Bashkisë Vlorë.

Aktualisht janë aplikuar 65 praktika për institucionet arsimore në qytet. Për 51 praktika kemi marrë konfirmimet nga ASHK.

DPPMA ka hartuar materialin ligjor dhe teknik për projekt vendimin për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme), të pronave të pronave paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, të Qarkut të Vlorës” për 51 prona., miratuar nga Keshilli i Bashkisë Vlorë me Vendim nr.30 datë 29.04.2025.

Me shkresën nr.460/1 prot datë 07.05.2025, është miratuar shprehja e ligjshmërisë nga Prefektura e Qarkut Vlorë, për aktin më sipër dhe DPPMA do të vijojë korespondencën me Agjencinë e Inventarizimit të Pronave Publike (AITTP), plotësimin e formularëve sipas modelit të miratuar me udhëzimin nr.1, datë 15.02.2002 të AITTP-së për përgatitjen e kërkesës për miratimin e listës përfundimtare pranë AITTP-së.

Materialet janë dërguar konform ligjit në Agjencinë e Inventarizimit të Pronave Publike, pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë.

Aktualisht po punohet për plotësimin e materialeve për VKM përfundimtare, për regjistrimin e pronave të fushës Arsimore.

Janë aplikuar dhe pajisur me çertifikata pronësie, pasuritë në ZK 8602, Stadiumi i qytetit të Vlorës, Aneksi i Stadiumit Flamurtari dhe Pallati i Sportit Vlorë.

Ndërkohë po vijojmë me pronat që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë. Aktualisht grupet e punës janë duke përgatitur dokumentacionin edhe për 100 pasuri të tjera, për të kaluar për vendim Këshill Bashkie.

- **Për objektet që kanë VKM kalimi pronësie në favor të Bashkisë Vlorë**

Kemi aplikuar në ASHK Vlorë, për regjistrim për VKM Nr.915, datë 11.11.2015 “Për transferimin në pronësi, nga Këshillat e Qarqeve të Bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të Aseteve të Luajtshme e të Paluajtshme të Ndërmarrjeve të Mirëmbajtjes së këtyre rrugëve, për objektin me nr pasurie 23/160, Zk 8602 “**Ndërmarrja e rrugëve Rurale Vlorë**”.

Bashkia Vlorë, ka aplikuar pranë ASHK Vlorë, me Nr.44077, datë 17.12.2024 aplikimi, për regjistrimin e pasurisë 23/160, zk 8602, në zbatim të VKM Nr.915 datë 11.11.2025.

Është plotësuar i gjithë dokumentacioni ligjor dhe teknik në lidhje me këtë aplikim dhe është ngarkuar i plotë në sistemin e-albania për, ASHK Vlorë.

Kjo praktikë për regjistrim i është bërë me dije edhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë dhe Drejtorisë së Pronave Shtetërore Tiranë.

Nga ana e këtyre institucioneve me shkresat nr.524 prot datë 13.01.2025 dhe nr.14194/1 prot datë 24.12.2024, ju është kërkuar të trajtohet kërkesa më sipër.

ASHK Vlorë ka kthyer përgjigje që në lidhje me aplikimin 44077 datë 17.12.2024 ka konstatuar se aplikimi nuk është i shoqëruar me dokumentet e mëposhtëme:

1. Dokument shtesë, i domosdoshëm në bazë të ligjit 111/2018
2. Bashkia nuk legjitimohet për shërbimin e kërkuar.

Pra ASHK Vlorë, nuk ka vijuar me çertifikimin e pasurisë subjekt vkm 915/ 2015.

4.Me VKM 541 DATË 27.07.2016 “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Vlorë, të pronës me sipërfaqe 371m² truall, pjesë e pronës me nr.17, me mërtimin “Rezidenca qeveritare Vlorë, dhe për një ndryshim në Vendimin nr.1058, datë 16.07.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, të ndryshuar.

Aktualisht është aplikuar për shërbimin kartelë dhe HTR, për vijimin e procedurës.

Sapo të pajisemi me dokumentacionin lidhor do të vijojmë me aplikim për çertifikatë pronësie,

5.Me VKM 850 Datë 15.12.2006 “Për transferimin në pronësi, disa Bashkive, të pronave, që janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të shërbimit social shtetëror, dhe për disa ndryshime në vendimin nr.60 datë 01.02.2006, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi

Sherbimit Social Shtetëror” , Bashkisë Vlorë sipas pikës d) i ka kaluar ne pronësi objekti me nr rendor 23 m që përkon me “Qendrën e Shërbimeve për Persoant me aftësi të kufizuar” Vlorë

Aktualisht është aplikuar për shërbimin kartelë dhe HTR , për vijimin e procedurës.

Sapo kemi marrë përgjigje nga ASHK për kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe fragmentin e hartës kadastrale dhe jemi duke drejt procesit për aplikim për çertifikimin e pasurisë pasurinë 24/1-T dhe 24-nd.

Këtë material e kemi kaluar në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë për saktësim.

6. Me VKM 227 datë 19.04.2006 ”Për Transferimin e truallit dhe të objektit “Hidrovorit i qytetit Vlorë” nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatori , në pronësi të Bashkisë së Vlorës.

Për këtë VKM, kemi konstatuar mospërputhje të mëdha në sipërfaqe si për truallin ashtu edhe për ndërtesën.VKM -të përgjithësisht nuk janë të shoqërara me planvendosje.

Për këtë rast i jemi drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Bujqësisë, për informacion. Pas marrjes së përgjigjes zyrtare do të vijojmë me aplikimet përkatëse.

7. Me VKM 221 DATË 17.04.2019 “Për kalimin në pronësi të BASHKISË Vlorë, të pronës me emërtimin Bashkia me vendndodhje në zonën kadastrale 8605”, Bashkisë Vlorë i është dhënë e drejta për çertifikimin e godinës.

Bashkia Vlorë ka aplikuar për pasuritë 40/53 dhe 40/55. Nuk po marrim shërbim nga ASHK Vlorë.

9.Me VKM 1108 DATË 30.12.2015 ‘Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë , Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave te Bashkitë, të infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve Rajonale të Kullimit, Bashkisë Vlorë i është dhënë e drejta për regjistrim.

Nga matjet faktike shikojmë se ka problematika me sipërfaqet e matura të objekteve dhe të truallit.

Janë bërë aplikimet për tu njohur me gjendjen juridike dhe kufijtë e pronës dhe mandej pas rregullimit të sistuatës ligjore dhe faktike do te vijojmë me praktikën.

10. Me VKM nr.114 datë 13.02.2020 “Për kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Vlorë, të nje pjese të truallit funksional , brenda territorit të pronës nr.912 me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve” me vendndodhje në Vlorë dhe për një ndryshim në vkm nr.515 datë 18.07.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të palaujtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi, Ministrisë së Mbrojtjes të ndryshuar, Bashkisë Vlorë i ka kaluar 400 m2 truall , ende pa aplikuar për çertifikim.

11. Me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Vlorë , sipërfaqe truall dhe ndërtesë për Hangarët në lagjen “Kushtrimi”.

Eshtë aplikuar për pasurinë 3/103 për kartelë dhe Fragment harte kadastrale , për të vijuar me tej praktikën për çertifikim.

3.Në sektorin e shpronësimeve

Sektori i shpronësimeve funksionon në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik“, i ndryshuar. Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve harton dosjen me dokumentacionin e nevojshëm, për të paraqitur më tej kërkesën për shpronësim publik, pranë ASHSH Tiranë.

- Perfundoi VKM 379/ date 10.07.2025”për shtesa të VKM-së nr.20 datë 24.01.2024 “Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar” Vlore
- Përfundoi VKM 136 datë 06.03.2025 “Për shtesa të VKM-së nr.414, datë 27.05.2020 “Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Menaxhim i integruar i mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës”, Bashkia Vlorë.
- Është në procedure per publikim VKM projekti “Leje rikonstruksioni të ndërtesës së dëmtuar , pa shtim apo ndryshim volumi për projektin përforcimi i pallatit 1300” Vlorë, bazuar në shkresën nr. 871 prot datë 20.01.2025.
- Sektori i Shpronësimeve ka vijuar punën për hartimin e materialeve dhe përgatitjen e dosjes për shtesa të VKM 20 datë 17.01.2024 ”Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Lidhja e Portit me rrugën Transballkanike Vlorë”.
- Është vijuar me likujdimet për të gjitha subjektet e shpronësuara me VKM-në që kanë paraqitur dokumentacionin ligjor për likujdim, në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin Tiranë dhe Dretorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit pranë Bashkisë Vlorë, sipas detyrimeve ligjore të përcaktuara në VKM-të përkatëse.

Për vitin 2026, do të punohet për kryerjen e procedurave të shpronësimit për të gjitha projektet që do të hartohen për projekt zbatim, për rikualifikimin e blloqeve të banimit dhe të gjitha projektet madhore të Qeverisë, si Lungomare 3 dhe të tjera që do të vijnë me leje ndërtimi të miratuara nga AZHT Tiranë.

Për fillimin e procedurës së shpronësimit në zbatim të Ligjit Nr.8561, date.22.12.1999 “ Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik “, i ndryshuar dhe VKM-se Nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik“ i ndryshuar, bazuar në materialet e depozituara nga Drejtoria e Urbanistikës ka punuar për hartimin e dosjes se shpronësimit për projektet:

1. ” Projekti arkitektonik i rrugëve ”Myslym Gjoleka” ,”Ahmet Lepenica” dhe ”Hysni Alimerko” në lagjen ”Kushtrimi” Vlorë bazuar në lejen e infrastrukturës Nr.149 Datë 04.03.2025 për objektin ” Projekti arkitektonik i rrugëve ”Myslym Gjoleka” ,”Ahm,et Lepenica” dhe ”Hysni Alimerko” në lagjen ”Kushtrimi” Vlorë të ndodhura në ZK 8605 Vlorë.

Aktualisht është shpallur kërkesa për shpronësim dhe pritjet publikimi i VKM.

2.Projekti “Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të qytetit të Vlorës”

Pas hartimit te dosjes , është përcjellë kërkesa për shpronësim pranë ASHSH Tiranë.
Mbetemi ne pritje të shpalljes së kërkesës për shpronësim.

3. Projekti “ Tregu Vlorë -Rrugicat tregtare” , projekt i depozituar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
Është hartuar dosja e shpronësimit dhe është përcjellë kërksa për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin Tiranë.

4. Projekti “Pastrimi i kolektorit nga rruga Demokracia deri tek rruga Vasil Puka” Bashkia Vlorë.
Është hartuar dosja e shpronësimit dhe është përcjellë kërksa për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin Tiranë.

5. Projekti “Rikonstruksion i kanalit të Ujrave të larta Loti 1 Bashkia Vlorë.
Është hartuar dosja e shpronësimit dhe është përcjellë kërksa për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin Tiranë.

6. Projekti “ Rikualifikim urban i qendrës dhe sheshit të Kaninës”
Është hartuar dosja e shpronësimit dhe është përcjellë kërksa për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin Tiranë.

Sektori i shpronësimeve ka bërë të gjitha apkimet në sistemin e-albania , për të gjitha projektit në proces dhe të përfunduara nga Drejtoria e Urbanistikës për shërbimet kartela të pasurive të paluajtshme, fragmente të hartave kadastrale dhe cdo shërbim tjetër në funksion dhe mbarëvajtje të punës.

- Është përfunduar çertifikimi për pasuritë e shpronësuara për interes publik për:
Pasuria 36/182, ZK.8602 Parkim në rrugën e Unazës Vlorë
Pasuria 36/119 ZK.8602 Parkim në rrugën e Unazës Vlorë
- Është përfunduar çertifikimi për pasuritë e shpronësuara për interes publik për:
Pasuria 3/103 , zk 8605 Hangarët në lagjen Kushtrimi Vlorë.

Janë kryer procedurat për shprehje interesi për objektet Zyrtar ish ASHK Vlorë në rrugën Transballkanike dhe Godina e IsH shtepisë së Oficerave, e cila ka qenë në përgjegjësi administrimi të ASHK Vlorë

Me VKM nr.114 datë 13.02.2020 “Për kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Vlorë, të një pjese të truallit funksional , brenda territorit të pronës nr.912 me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve” me vendndodhje në Vlorë dhe për një ndryshim në vkm nr.515 datë 18.07.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi, Ministrisë së Mbrojtjes të ndryshuar, Bashkisë Vlorë i ka kaluar 400 m2 truall , ende pa aplikuar për çertifikim.

- Përfundoi VKM-së 168 datë 19.03.2026 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.20 datë 17.01.2024 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të

paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi I projektit "Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar" , Vlorë.

- Përfundoi VKM 352 datë 25.09.2025 projekti "Leje rikonstruksioni të ndërtesës së dëmtuar , pa shtim apo ndryshim volumi për projektin përforcimi i pallatit 1300" Vlorë.
- Është vijuar me likujdimet për të gjitha subjektet e shpronësuara me VKM që kanë paraqitur dokumentacionin ligjor për likujdim, në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin Tiranë dhe Dretorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit pranë Bashkisë Vlorë, sipas detyrimeve ligjore të përcaktuara në VKM-të përkatëse.

DREJTORIA E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Për periudhën 01.01.2026 – 30.04.2026 është realizuar puna dhe siguruar gatishmëria në njohjen e bazës ligjore, urdhërave dhe udhëzimeve si dhe postës elektronike ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së në Ministrinë e Brendshme, Bashkia Tiranë. Eshtë punuar dhe zbatuar plani i masave për përforcimin dhe rritjen e gatishmërisë për sezonin pranverë-verë me efektivet e ndërhyrjes operacionale.

Spektori i ndërhyrjes ka përpiluar dokumentacionin ligjor për periudhën 01.01.2026 – 30.04.2026 si dhe është përgjigjur në kohë për fikjen e zjarreve dhe problematikave të tjera.

Spektori i parandalimit ka marrë masa për programimin e punës për periudhën 01.01.2026 – 30.04.2026, më konkretisht për kontrollin dhe masat parandaluse që kanë marrë të gjitha hotelëritë në vijën bregdetare të Bashkisë Vlorë, verifikimin dhe ndarjen e objekteve sipas rrezikshmërisë në kategori bazuar në aktet ligjore në fuqi.

Spektori i parandalimit gjatë periudhës 01.01.2026 – 30.04.2026, në bazë të planeve të punës të hartuara ka ushtruar kontrole rutinë dhe të programuara në subjekte publike dhe private si hotelëri, objekte didaktike shkollë, kopshte çerdhe dhe në subjekte me aktivitet shërbimi.

Eshtë ndjekur në vazhdimësi gjatë periudhës 01.01.2026 – 30.04.2026 gatishmëria e spektorit të ndërhyrjes duke u mbështetur në organizimin e shërbimit sipas grafikut të shërbimit, librave të planëzuara dhe situatave të paparashikuara, duke ushtruar kontrole të drejtpërdrejta në stacion.

Vëmendje kryesore dhe e veçantë i është kushtuar gadishmërisë në efektivet dhe mirëmbajtjes së automjeteve zjarrfikëse, paisjeve dhe materialeve të tjera ndihmëse për zjarrfikësen.

Kemi bashkëpunuar me drejtorinë e Emergjencave Civile në Bashkinë Vlorë dhe emergjencat civile në prefekturën e Qarkut Vlorë. Tabela përmbledhëse e spektorit të ndërhyrjes operacionale si më poshtë:

	Objekte Civile(banimi)	Objekte,aktivitete shërbimi(dyqane,salla, magazina etj.)	Objekte akomoduese turistike	Objekte Didaktike (shkolla,kopshte, çerdhe)	Objekte ku tregtohen lëndë lehtësisht të djegshme	Objekte me aktivitet administrative	Objekte me rrezik të shtuar(uzina, fabrika të perpunimit të lëndëve djegëse)	Mjete transporti	Kullota,pyje,shkurre,barishte,plehra	Ndërryrje për shpëtim	Alarme falsë	Nuk ka qënë e nevojshme ndërhyrja	TOTAL
JANAR	4	-	-	-	-	-	-	1	29	21	-	-	55
SHKURT	4	1	-	-	-	-	-	2	20	15	-	-	42
MARS	2	-	-	-	-	-	-	6	21	20	-	-	49
PRILL	3	-	-	-	-	-	-	2	20	11	-	-	36

Ndërrhyrja e menjëhershme e efektivave tanë nën drejtimin e komandantëve të cilët e kanë vlerësuar cdo njoftim në kohë si dhe institucioneve mbështetëse si Policia e Shtetit për zjarrvëniet e qëllimshme ka bërë të mundur frenimin e zjarreve dhe kallëzim penal për zjarrvënësit. Të gjitha mjetet zjarrfikëse janë angazhuar sidomos në rastet e zjarreve me përmasa të mëdha, ku është kërkuar koordinim dhe mobilizim i përgjithshëm. Për ndërrhyrjet e zakonshme është përdorur personeli dhe mjetet sipas rastit. Gjatë sezonit veror janë evidentuar disa ngjarje me përmasa të mëdha, të cilat kanë kërkuar mobilizim të plotë të forcave si: zjarri në malin e Dukatit, zjarri në zonën e Shashicë-Kaninës, zjarri në zonën e Pish Poros, zjarri në vendgrumbullimin e mbetjeve të qytetit.

Nga sektori i parandalimit gjatë periudhës 01.01.2026 – 30.04.2026, janë hartuar planet e punës vjetore, tremujore dhe mujore ku janë ushtruar kontrolle dhe janë marrë masa ndëshkuese me gjobë aty ku janë konstatuar shkelje. Tabelat përmbledhëse të sektorit të inspektim-parandalimit si më poshtë :

MASAT										
	Konstatime me procesverbal (dënim me gjobë)	Gjoha me vendim	Bloki me	Kallëzim penal	Akte ekspertize (për zjarret e rëna)	Akte teknike (Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri)	Ripërtëritje akte teknike (Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri)	Vërtetime zjarri	Miratim projekti për PMNZSH	
JANAR	-	-	-	-	2	2	0	1	10	
SHKURT	-	-	-	-	2	1	0	0	13	
MARS	-	-	-	-	1	13	3	1	19	
PRILL	-	-	-	-	1	2	1	0	7	

INSPEKTIVE												
	Objekte, aktivitete Civile(banimi)	Objekte, aktivitete shërbimi(dyqane,salla,magazina,etj.)	Objekte,aktivitete akomoduese turistike	Objekte aktivitete Didaktike(shkolla,kopshte, çerdhe)	Objekte ku ushtohet aktivitet tregëtimi me lëndë lehtësisht të djegshme	Objekte,aktivitete artizanale	Objekte historike, artistike të destinuara(muze,galeri,ekspozita)	Objekte të destinuara për impjan te sportive	Depozita gazi të fiksuar me kapacitet deri në 5m³	Depozita gazi të fiksuar me kapacitet mbi 5m³	Impjante për shpërndarje e karburanteve	Objekte administrative
JANAR	1	12	1	1	-	4	-	-	2	-	3	-
SHKURT	-	19	6	-	-	-	-	-	-	-	5	-
MARS	2	18	6	-	-	1	-	-	-	-	5	-
PRILL	1	6	1	-	-	5	-	-	-	-	5	-

Vëmendje e veçantë i është treguar plotësimit të evidencave, statistikave dhe dokumentacionit ligjor. Shefi i sektorit të ndërhyrjes ka marrë masat e duhura për rritjen, forcimin e shkallës së gatishmërisë, rritjen tekniko-profesionale të efektivitetit dhe ka eliminuar çdo rast problematik.

Gatishmëria e mjeteve, paisjeve dhe mjetet zjarrfikëse kontrollohen për gatishmërinë e tyre për të gjithë kompletimin me paisje mbështetëse, kompletimet me materiale të përcaktuara në mënyrë taksative nga ligji, udhëzimet, vkm, rregulloret e miratuara, vendimet e këshillit të ministrave dhe udhëzimeve të ministrit të brendshëm dhe drejtorisë së përgjithshme të mzsh-së, urdhërat dhe vendimet e Kryetarit të Bashkisë Vlorë këtë periudhë janë zbatuar me korrektësi.

Gjatë periudhës në vazhdim kemi për detyrë si më poshtë :

- Mbajtja në gatishmëri të përhershme e automjeteve zjarrfikëse, materialeve mbështetëse dhe ato ndihmëse që përdoren nga shërbimi ynë.
- Gatishmëria e efektivitetit zjarrfikës në çdo kohë dhe rrethanë për t'ju përgjigjur situatave të paparashikuara.
- Dhënia në kohë e informacionit të situatave reale të ndodhura në territorin e Bashkisë, dhe në raste nevojë në ndihmë të bashkive fqinje.
- Shefi i sektorit të ndërhyrjes të zhvillojë analiza të veçanta për ngjarjet e rënda të ndodhura në territorin e bashkisë dhe të jetë e specifikuar situata reale me të gjitha elementet përcaktuar sipas VKM nr.520 datë.25.07.2019.
- Të ndiqet në vazhdimësi gatishmëria e efektivitetit dhe kontrolli fizik i stacioni të MZSH-së, Bashkia Vlorë.

Shefat e dy sektorëve respektivë të ushtrojnë kontrole të vazhdueshme sipas detyrës së tyre funksionale dhe të marrin masa për vartësit e tyre.

Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane

Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane, gjatë periudhës janar – prill 2026, ka pasur në fokus kryesor veprimtaritë e mëposhtme:

- operimin e venddepozitimit sanitar të mbetjeve në Sherishtë, në përputhje të plotë me kushtet e Lejes Mjedisore në fuqi dhe aktet ligjore përkatëse;
- sigurimin e kushteve të shëndetit dhe sigurisë në punë për punonjësit;
- menaxhimin e procesit të pranimit, regjistrimit, depozitimit dhe kompaktimit të mbetjeve urbane, sipas procedurave teknike të miratuara;
- zbatimin e masave për mbulimin ditor të mbetjeve, kontrollin e erërave, pluhurave dhe vektorëve biologjikë;
- monitorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kullimit të ujërave sipërfaqësore dhe trajtimit të lëngjeve rrjedhëse (leachate);
- zbatimin e planeve të emergjencës dhe masave parandaluese ndaj zjarreve dhe incidenteve teknike;
- mbajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit teknik dhe operativ të landfillit (regjistra ditorë, raporte mujore dhe vjetore);
- shlyerjen e detyrimeve financiare sipas parashikimeve ligjore dhe raportimin 3 mujor në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.
- bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse për monitorime, inspektime dhe raportime periodike;
- zbatimin e komponentëve të *Planit të Biznesit të Programit "Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve" (MIM) Vlorë*, për vënien në funksionim të impianteve dhe aktiviteteve rajonale;
- realizimin e mirëmbajtjes preventive të infrastrukturës, pajisjeve dhe mjeteve të instaluar në Landfillin e Sherishtës;
- zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit;
- rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit.

2. Ecuria e punimeve në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë

Ndërtimi i landfillit sanitar ka përfunduar 95% të punimeve ndërtimore të ndara sipas loteve si më poshtë:

LOT 1

- Qeliza 1 – Kanë përfunduar punimet e dherave në të gjithë qelizën 1. Kanë përfunduar shtrimi i shtresave të izolimit në skarpat dhe bazamet, shtresat që përbëhen nga Geo Sintetic Clay, HDPE, dhe Gjeotekstil. Ka përfunduar shtrimi i tubove të gazit në të gjithë perimetrin e qelizës. Ka përfunduar puna për mbushjen me material drenazhi (50 cm zhavorr lumi i larë). Ka përfunduar mbushja e qelizës 1.1 dhe qelizës 1.2. Ka përfunduar shtrimi i tubove HDPE PN 16 DN 355 që shërbejnë për mbledhjen e leksivateve. Rrethimi i të gjithë objektit ka përfunduar.
- Qeliza 2 – Kanë përfunduar punimet e dherave në gjithë qelizën 2. Kanë përfunduar dhe shtrimi i shtresave të izolimit në skarpat dhe bazamet, shtresat që përbëhen nga Geo Sintetic Clay, HDPE, dhe Gjeotekstil. Ka përfunduar shtrimi i tubove të gazit në të gjithë perimetrin e qelizës. Ka përfunduar puna për mbushjen me material drenazhi (50 cm zhavorr lumi i larë). Ka përfunduar shtrimi i tubove HDPE PN 16 DN 355 që shërbejnë për mbledhjen e leksivateve.
- Leachate storage pond (LTP) – Përfundimi i punimeve të mbetura, testimi dhe vënia në funksion e këtij impianti është domosdoshmëri për trajtimin e ujrave të ndotura që depozitohen në vaskat përkatëse dhe për respektimin e parametrave mjedisorë konform parashikimeve ligjore.

- Ndërtesa e Administratës – Kanë përfunduar punimet e betonit, elektrike, instalimet e mbrojtjes nga zjarri, kanalizimet dhe muratura. Kanë përfunduar linjat e brendëshme hidraulike dhe eletrike. Ka përfunduar instalimi i sistemit kapot dhe grafiato, aktualisht mungon lyerja, dyert dhe dritaret e objektit. Ka përfunduar shtrimi i trotuarëve me pllaka përreth godinës së administratës.
- Ndërtesa e Oficinës (workshop) - Kanë përfunduar punimet e betonit, elektrike, anti zjarri, kanalizimet dhe muratura. Kanë përfunduar linjat e brendëshme hidraulike dhe eletrike. Ka përfunduar instalimi i sistemit kapot, janë vendosur qepenat dhe aktualisht mungon vetëm grafiato, lyerja dhe dyert e dritaret e objektit.
- Ndërtesa e parkimit (Canopy Hangar) – Kanë përfunduar të gjitha punimet.
- Sheshi administratës dhe MRF – Kanë përfunduar të gjitha punimet e dherave. Kanë përfunduar shtrimi i linjave nëntokësore si elektrike, IT, sistemi i kamerave, ujësjellësi, sistemi kundra zjarrit, kanalizimet. Ka përfunduar testimi i linjave të ujësjellësit, sistemit kundra zjarrit dhe sistemit të vaditjes, dhe po punohet me testimin e linjave kanalizimeve. Ka përfunduar shtrimi i sheshit me asfalt.
- Rruga e aksesit – Kanë përfunduar të gjitha punimet e dherave dhe të strukturave mbajtëse (muret). Kanë përfunduar betonimet e kanaleve anësore dhe vendosja e shtyllave elektrike nga Sherishta deri në Landfill. Ka përfunduar shtrimi i rrugës me asfalt.

LOT 2

- Ndërtesa MRF – Kanë përfunduar punimet e dherave dhe të betonit. Kanë përfunduar pothuajse gjithë punimet metalike. Ka përfunduar sistemi i kanalizimeve, por nuk ka përfunduar ende shtrimi i linjave elektike, IT, kundra zjarrit, etj. në brendësi të sheshit të MRF. Ka përfunduar shtrimi i sheshit me beton të armuar dhe rifiniturat përkatëse.
- Kanë ardhur dhe montuar në kantier në masën 95% makineritë e MRF.

LOT 3

- MIM Vlorë ka përgatitur programet e mirëmbajtjes së mjeteve teknologjike dhe automjeteve dhe po i zbaton me rigorozitet ato. Gjithashtu është realizuar furnizimi me pjesë ndërrimi dhe materiale të konsumueshme për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes për këto mjete, duke respektuar rigorozisht manualët e mirëmbajtjes furnizuar nga prodhuesit.
- Në bashkëpunim me KfW dhe me Konsulentin teknik, është përgatitur projekti për pjesën e mbetur të punimeve të ndërtimit, i cili ka hapur rrugën e realizimit të procedurave të prokurimit për kryerjen e këtyre punimeve.

3. Depozitimi i mbetjeve në Landfillin e Sherishtës

Depozitimi i mbetjeve gjatë kësaj periudhe është realizuar në qelizën 1.1, duke zbatuar në mënyrë rigorozë kërkesat teknike për shfrytëzimin e impiantit, si dhe duke mbajtur evidenca të sakta mbi

sasinë e mbetjeve të depozituara, kategoritë e mjeteve dhe të dhëna të tjera përkatëse. I gjithë informacioni është pasqyruar në Regjistrin e Mbetjeve, i cili përbën një dokument kyç për menaxhimin operacional, monitorimin mjedisor dhe raportimin institucional.

Plotësimi dhe administrimi i Regjistrit të Mbetjeve është realizuar në përputhje me detyrimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, si dhe në VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfillët e mbetjeve”.

Gjatë periudhës raportuese, Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane ka realizuar operimin e Venddepozitimit Sanitar të Mbetjeve në Sherishtë në përputhje të plotë me kushtet e Lejes Mjedisore në fuqi, aktet nënligjore përkatëse dhe procedurat teknike të miratuara, me fokus garantimin e një funksionimi të qëndrueshëm dhe të kontrolluar të landfillit, minimizimin e ndikimeve mjedisore dhe sigurimin e kushteve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Në këtë kuadër, është menaxhuar në mënyrë të vazhdueshme procesi i pranimit, regjistrimit, depozitimit dhe kompaktimit të mbetjeve urbane, janë zbatuar masat për mbulimin ditor të mbetjeve, kontrollin e erërave, pluhurave si dhe është realizuar monitorimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kullimit të ujërave sipërfaqësore dhe trajtimit të lëngjeve rrjedhëse (leachate), në funksion të mbrojtjes së tokës dhe burimeve ujore.

Paralelisht, janë zbatuar planet e emergjencës dhe masat parandaluese për parandalimin e zjarreve dhe incidenteve teknike, është garantuar zbatimi i standardeve të shëndetit dhe sigurisë në punë për punonjësit e landfillit, si dhe është mbajtur dhe përditësuar rregullisht dokumentacioni teknik dhe operativ, përfshirë regjistrat ditorë, raportet mujore dhe vjetore, si dhe raportimin tremujor pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Ndërmarrja ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet përgjegjëse për monitorime, inspektime dhe raportime periodike, duke garantuar transparencë, përputhshmëri ligjore dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës mjedisore të Venddepozitimit Sanitar.

Sasia totale e mbetjeve urbane të depozituara në Landfillin e Sherishtës për periudhën 01.01.2026 – 30 prill 2026 është 17.633 ton.

4. Monitorimi i mbetjeve

MIM Vlorë ka përpiluar qasjen konceptuale të monitorimit të mbetjeve, referuar kërkesave ligjore për monitorim dhe raportim (Ligji për Mbetjet, VKM-të, Rregulloret specifike). Cikli i monitorimit vlerëson performancën dhe ndikimin mjedisor dhe është realizuar sipas periudhave të parashikuara në ligj, nga një kompani e licencuar për këtë shërbim, e kontraktuar duke ndjekur procedurat përkatëse të prokurimit.

5. Riciklimi dhe kompostimi

Ndërmarrja MIM Vlorë është përfshirë në aktivitetet e planifikimit për skemën pilot të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve me kontenierë depo në rajonin nr. 3 të qytetit të Vlorës, të drejtuar nga

ekspertët e Konsulentit Institucional. Në fazën e parë të testimit është propozuar të instalohen 10 stacione me 3 kontenierë depo për lloje të ndryshme materialesh (kanaçe, shishe, kartona, ambalazhe). MIM Vlorë ka ndërmarrë aktivitete të vazhdueshme të ndërgjegjësimit mjedisor me disa shkolla në qytetin e Vlorës.

Në funksion të studimit të tregut për materialet e riciklueshme janë vendosur kontakte me disa kompani riciklimi në Tiranë për të parë interesin dhe potencialin për bashkëpunim kur të fillojë puna në impiantin e ndarjes së materialeve.

Ka përfunduar plani mbi pikat e vendosjes së kontenierëve për mbetjet e riciklueshme në Rajonin Numër 3. Kontenierët për mbetjet e riciklueshme kanë ardhur dhe po punohet për shpërndarjen e tyre në qytet.

6. Mirëmbajtje e infrastrukturës , linjave dhe mjeteve teknologjike në landfill

Mirëmbajtja preventive e cila zhvillohet në landfillin e Sherishtës është një proces i rëndësishëm për të siguruar që pajisjet dhe sistemet të funksionojnë në mënyrë optimale dhe të shmangen defektet e papritura. Kjo përfshin inspektime të rregullta, pastrime, lubrifikime.

Proceset e mirëmbajtjes në landfillin e Sherishtës kryhen në baza ditore dhe përfshijnë një spektër të gjerë aktiviteteve teknike. Këto aktivitete përfshijnë mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanaleve të drenazhimit të ujit të shiut nga aluvionet e grumbulluara, si dhe kryerjen e ndërhyrjeve të nevojshme riparuese në zonat e dëmtuara. Gjithashtu, përfshihet pastrimi nga vegjetacioni dhe mirëmbajtja dhe kontrolli i saraçineskave dhe komponentëve të tjerë të sistemit të largimit të ujërave sipërfaqësorë për tu siguruar që janë në gjendje funksionale optimale.

Mirëmbajtja e pajisjeve dhe mjeteve përfshin kontrole të rregullta për identifikimin e dëmtimeve, testimin dhe vendosjen në punë me parametra minimale operative, për të shmangur avaritë dhe për të siguruar gatishmërinë e tyre të vazhdueshme për qenë operacionale në momentin e fillimit të aktivitetit në landfill.

9. Rritja e ndërgjegjësimit dhe marrëdhëniet me publikun

Ndërgjegjësimi dhe ndryshimi i sjelljes në raport me mbetjet urbane, është një sfidë por dhe një mision që ka marrë përsipër Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane, nëpërmjet sensibilizimit të nxënësve të arsimit parauniversitar dhe fëmijëve të kopshteve të qytetit të Vlorës.

Gjatë periudhës janar – prill 2026 janë zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjësuese si më poshtë :

Takim me të rinjtë e qendrës Vlora Youth Center

Aktiviteti u zhvillua në formë bashkëbisedimi dhe prezantimi informues, ku pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime të hapura mbi problematikat mjedisore që hasen në komunitetin e tyre. Të rinjtë shprehën mendimet dhe përvojat e tyre, duke treguar interes dhe gatishmëri për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit.

Takime në biznese, lagje, lokale, markete.

Qëllimi i këtij aktiviteti është rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi rëndësinë e menaxhimit të duhur të mbetjeve urbane, ndarjen e mbetjeve në burim, riciklimin dhe ruajtjen e mjedisit. Aktiviteti synoi informimin e komunitetit mbi praktikën e sakta të depozitimit të mbetjeve dhe ndikimin pozitiv që ka menaxhimi i mirë i tyre në përmirësimin e cilësisë së jetesës.

Aktiviteti me tematikë “Mbill një lule”

Me pjesëmarrjen e fëmijëve nga arsimi parauniversitar i qytetit të Vlorës. Fëmijët u përfshinë drejtpërdrejt në mbjelljen e luleve, duke transformuar një hapësirë të papërdorur në një kopsht të gjelbëruar dhe estetikisht të përmirësuar.

Aktiviteti me tematikë “Pastrim i hapsirave të lumit Izvor ”

Më datë 10.04.2026, në kuadër të aktiviteteve për ndërgjegjësimin mjedisor dhe Ditën e Tokës, u organizua një veprimtari edukative me nxënësit e klasës së 8-të “Balil Pelari” dhe pjesëtarë të ndërmarrjes së menaxhimit të mbetjeve Urbane Vlorë.

Gjatë aktivitetit, nxënësit u përfshinë në diskutime informuese, realizuan postera dhe piktura me mesazhe sensibilizuese, si dhe krijuan objekte të reja duke përdorur materiale të riciklueshme. Në përmblyllje, u zhvillua një aksion pastrimi përgjatë bregut të lumit, duke treguar angazhim dhe përgjegjësi qytetare.

Fushatat sensibilizuese, aktivitetet dhe informacionet që i janë përcjellë audiencës për grumbullimin e veçantë të lëndëve të riciklueshme publikohen edhe në faqet e rrjeteve sociale instagram e facebook.

Do të vazhdojnë fushatat sensibilizuese nëpërmjet shpërndarjes të fletëpalosjeve tek banorët, bizneset, me objektivin për të krijuar gradualisht bindjen që Vlora duhet të jetë jo vetëm një qytet i bukur turistik por edhe një qytet i pastër banorë e të cilit kujdesen dhe për mjedisin.

NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet sektorëve të Bordit të Ujitjes dhe Kullimit, D.D.D, Mirëmbajtjes së Varrezave dhe Rrugë Trotuare, Plazhe dhe sektorin e Ndriçimit Publik. Në fokusin e përditshëm të ndërmarrjes mbetet bashkërendimi i punëve ndërmjet sektorëve me qëllim ofrimin e shërbimit korrekt ndaj qytetarëve dhe qytetit të Vlorës.

Për periudhën Janar – Prill 2026, nëpërmjet shërbimeve që çdo sektor ofron, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, ka garantuar kryerjen e tyre me efikasitet dhe në kohë, duke përmbushur me korrektësi detyrat e përditshme dhe duke ofruar gjithashtu zgjidhje në kohë për çdo problematike të paraqitur.

Sektori I Bordit i Ujitjes dhe i Kullimit

Për sa i përket Shërbimeve të kryera:

Përshkrimi i shërbimit	Njësia matëse	Sasia realizuar e	Zona	Koment
- Kanale ujitëse të pastruara	Km	9.9	NJ.A Novosele+ NJ.A Qendër+ NJ.A Shushicë	Kanale që i luajne te dy rolet si dhe kanalet ujitëse janë llogarit se bashku
- Kanale kulluese të pastruara	Km	17.07	NJ.A Novosele+ NJ.A Qendër+ NJ.A Shushicë	
- Kanale ujitëse të mirëmbajtura	Km			
- Kanale kulluese të mirëmbajtura	Km			
- Ndërhyrje emergjente të kryera	Nr	6	NJ.A Novosele+ NJ.A Qendër+ NJ.A Shushicë	Ndërhyrje per parandalimin e permbytjeve , si dhe rehabilitimin e situases nga permbytjet

Në kuadër të realizimit të detyrave funksionale për mirëmbajtjen e rrjetit kullues dhe ujitës, sektori Bordi I ujitjes dhe Kullimit pranë Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka vijuar gjatë 4-mujorit të fundit punën për pastrimin periodik të kanaleve kulluese dhe ujitëse, me qëllim garantimin e funksionimit normal të sistemit të kullimit dhe ujitjes, parandalimin e bllokimeve, shmangien e përmbytjeve, si dhe përmirësimin e qarkullimit të ujërave.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer ndërhyrje të vazhdueshme në kanalet kryesore dhe dytësore, ku puna është përqendruar në:

- Pastrimin e mbetjeve urbane dhe inerteve të depozituara në kanale;
- Heqjen e bimësisë dhe barishteve që pengonin rrjedhjen normale të ujit;
- Gërmimin dhe sistemimin e segmenteve të amortizuara të kanaleve;
- Hapjen e seksioneve të bllokuara nga prurjet e dherave dhe mbetjeve;
- Pastrimin e tobinove, veprave të artit dhe shkarkuesve;

Punimet janë realizuar duke përdorur eskavatorë, automjete transporti në terren.

Ndërhyrjet janë organizuar sipas situatave emergjente të krijuara nga reshjet intensive, si dhe nevojës për parandalimin e rasteve të përmbytjeve.

Gjatë muajve të fundit janë evidentuar disa raste të grumbullimit të ujërave dhe përmbytjeve lokale në zona të ndryshme administrative, kryesisht si pasojë e reshjeve me intensitet të lartë, bllokimit të kanaleve nga mbetjet urbane, si dhe ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin kullues. Në këto raste, strukturat e ndërmarrjes kanë ndërhyrë në kohë reale për:

- Hapjen dhe pastrimin emergjent të kanaleve të bllokuara;
- Evakuimin e ujërave nga sipërfaqet e përmbytura;
- Përforcimin e pikave të dëmtuara;
- Rivendosjen në funksion të veprave kulluese.

Ndërhyrje emergjente janë kryer veçanërisht në segmentet me problematika të përsëritura, ku prurjet e ujërave kanë sjellë dalje nga shtrati të kanaleve dhe rrezik për përmytje të tokave bujqësore, rrugëve rurale dhe zonave të banuara, kryesisht në NJ.A Novosele dhe Qendër.

Gjithashtu, është siguruar funksionaliteti i pjesshëm i rrjetit ujitës për sezonin bujqësor dhe shmangia e problematikave që cenojnë aktivitetin e fermerëve dhe komunitetit.

Sektori përgjegjës do të vijojë punën për mirëmbajtjen periodike të kanaleve, evidentimin e problematikave në terren dhe ndërhyrjet emergjente, me qëllim garantimin e sigurisë së infrastrukturës kulluese dhe ujitëse gjatë gjithë vitit

- 1- Nga monitorimi i vazhdueshëm në terren, verifikimet teknike dhe problematikat e evidentuara gjatë periudhave me reshje intensive, rezulton se në territorin e Bashkia Vlorë ekzistojnë disa zona me risk të lartë përmytjeje, kryesisht në njësitë administrative dhe zonat me infrastrukturë kulluese të amortizuar ose me kapacitete të pamjaftueshme shkarkimi, ku më problematike paraqitet NJ.A Novosele .

Zonat më problematike evidentohen kryesisht në:

- Njësitë administrative me sipërfaqe të mëdha bujqësore dhe prani të kanaleve kulluese të vjetra;
- Zonat e ulëta pranë lumenjve dhe përrenjve sezonalë;
- Segmentet urbane dhe periferike ku mungon sistemimi i plotë i ujërave të shiut;
- Hapësirat ku janë konstatuar ndërtime pranë ose mbi kanalet kulluese;
- Zona ku depozitimi i mbetjeve urbane dhe inerteve shkakton bllokime të vazhdueshme.

Në njësitë administrative janë konstatuar problematika të përsëritura të grumbullimit të ujërave, sidomos gjatë reshjeve intensive, duke sjellë përmytje të tokave bujqësore, rrugëve rurale, sipërfaqeve të banuara dhe dëmtime në infrastrukturë.

Gjendja teknike e rrjetit kullues dhe ujitës paraqitet pjesërisht e amortizuar për shkak të:

- Degradimit të kanaleve nga erozioni dhe sedimentet;
- Dëmtimeve në veprat e artit, tombino dhe shkarkues;
- Ngushtimit të seksioneve të kanaleve;
- Bllokimeve nga bimësia, mbetjet dhe dherat;

Në disa segmente, rrjeti kullues nuk garanton më kapacitetin e nevojshëm për përballimin e prurjeve gjatë reshjeve me intensitet të lartë, çka rrit ndjeshëm riskun e përmytjeve dhe cenon sigurinë e banorëve dhe aktivitetit bujqësor.

Për përmirësimin e situatës dhe reduktimin e riskut të përmytjeve, evidentohen si të domosdoshme këto ndërhyrje dhe investime:

- Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i kanaleve kryesore dhe dytësore kulluese;
- Thellimi dhe zgjerimi i seksioneve të amortizuara;
- Ndërtimi dhe rikonstruksioni i veprave të artit dhe tombinove;
- Përforcimi i argjinaturave në zonat me risk;
- Investime në sistemet e shkarkimit të ujërave të shiut në zonat urbane;

Sektori i shërbimit DDD

Sektori i shërbimit DDD realizon dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim në mjediset publike si: vendstrehime, lulishte, parqe, çerdhe, kopshte, shkolla, si edhe në rastet kur ka ankesa nga këto institucione publike në Bashkinë e Vlorës.

Në objektivat e këtij sektori kanë qënë trajtimet parandaluese dhe të kontrollit të transportuesve mekanikë (aktorë) dhe vektorëve të klasës së insekteve me rëndësi shëndetësore, duke qënë burim ndotje dhe kontaminimi për komunitetin.

Këto trajtime kanë përfshirë edhe katet e nëndheshme të pallateve. Vatrave të infeksionit, si bodrume të mcr, janë inspektuar fillimisht dhe më pas është kryer ndërhyrja me preparatet për dezinfektimin e tyre. Inspektimet dhe dezinfektimet kryhen çdo ditë të javës në vatrave të evidentuara më parë dhe në rast konstatimi të reja.

Së dyti është realizuar kufizimi i arthropodëve bezdisës që mund të jenë aktorë (transportues mekanik) dhe vektor (mbartës të patogjenëve). Faktorët favorizues si mjediset e kontaminuara me mbeturina organike krijojnë mjedis të përshtatshëm për proliferimin e patogjenëve dhe përhapjes së shpejtë të mikroorganizmave që shkaktojnë sëmundje (të tilla si bakteret, viruset, kërpudhat ose parazitët) brenda një organizmi strehues, insekte që veprojnë vektor apo aktor në mjedis. Ky proces është thelbësor për kufizimin e zhvillimit të sëmundjeve infektive. Në procesin e dezinfektimit janë përfshirë kontenerët e mbeturinave si edhe mjedisit pranë tyre. Specifikisht janë higjenuar, dezinfektuar koshat e mbeturinave dhe mjediset përreth tyre.

Frekuenca e ndërhyrjeve në këto mjediset të kontaminuara ka qënë 1 herë në javë, ku në secilën ditë të javës është planifikuar dhe është realizuar procesi i dezinfektimit në rrugët kryesore si më poshtë :

- Vendgrumbullime mbeturinash të tilla si: kontener me mbeturina, kosha si edhe mjediset përreth tyre në rrugën "Perlat Rexhepi" dhe "Ali Demi"
- Higjenuar konteneret të rrugës " Ismet Çakëri"
- Inspektim dhe dezinfektim në rrugën "Hysen Begasi" mbas Stadiumit "Flamurtari"
- Higjenuar të kontenerëve në lagjen "Isa Boletini"
- Higjenuar të kontenerëve në rrugën "Dush Strati"
- Higjenuar të kontenerëve në rrugën "Piro Sava"
- Inspektim dhe dezinfektim në bllokun e banimit të rrugës "Onufri" "Hajredin Haxhiraj"
- Inspektim dhe trajtim me larvicid të Këndi i lojrave si edhe mjedisit
- Inspektim bllokut të banimit të ish Kombinati dhe trajtim sipas rastit
- Kontenerët në rrugën "Hasan Kushta"
- Kontenerët në rrugën "Gjergj Araniti"
- Trajtim me insekticid në konteneret në rrugën "Enver Jaho"
- Trajtim me insekticid në rrugën "Zaho Koka"
- Inspektim e dezinfektim në katet e nëndheshme të Posta e Çoles dhe pranë shkollës "Marigo Posio"
- Dezinfektim me adulticid në rrugën "Demokracia"
- Dezinfektim me adulticid në rrugën "Janaq Kilica"
- Higjenuar rrugës "7 Nëntori".

Janë realizuar trajtime me efekt rezidual për adultët, si edhe trajtime dezinfektuese në mjediset e kontaminuara pranë koshave. Aplikimi realizohet me anë të pompave me presion, në pjesët ku pushojnë insektet në stadin adult në mënyrë periodike dhe duke alternuar preparatet dezinfektues. Gjatë periudhës janar-prill është kryer procesi i dezinfektimit në koshat e mbeturinave për kufizimin e vektoreve transmetues të sëmundjeve. Janë dezinfektuar katet e nëndheshme të pallateve, të cilat kanë qënë të kontaminuar me ujë të ndotur.

Së treti janë bërë inspektime dhe trajtim me larvicid në katet e nëndheshme, mcr si edhe kunetat e ngarkuara me ujë të kontaminuar si më poshtë :

Në Rajonin 3

- Zona përreth Shkollës "Musa Çakëri" mcr të kontaminuara me ujë të ndotur
- Zona te Konadi, dezinfektim në vendgrumbullim mbeturinash pranë koshave
- Vendstrehim (mcr) e lokalizuar pranë P.L.M
- Kat i nëndheshëm pallati në rrugën "Hajredin Haxhiraj"
- Inspektim dhe trajtim me larvicid pranë Qendrës Kulturoret ë Fëmijve në gropën septike si dhe trajtim me adulticid vegjetacionit te Këndi i Lojrave

Në Rajonin 4

Pranë Shkollës "15 Tetori,, pallat me numër 1310 në Rr "Osmën Haxhiu". Në këtë pallat ka prezence të ujra të ndotura në bodrum, por edhe prezence të orendive të shumta duke krijuar nje mjedis të përshtatshëm për brejtësit

- Pallate pranë Postës së Çoles nr.1281, nr.1267, nr.1300
- zona mbrapa Shkollës "Jani Minga pallat nr.1286 me ujë të ndotur në bodrum në Rr "Hajredin Danushi"
- Pallat me nr.1365 mbas Shkollës 9 vjeçare "Marigo Posio"
- Pallat nr.1385 në Rr. "Sali Bedini"

Në Rajonin 5

- Pallate në zonën përballë Komisarariatit të Policisë në Rr.Janaq Kilica i cili ka ujëra të ndotura në bodrumet e tyre,
- Pallat në Rrugën Demokracia nr.1982, i cili gjithashtu ka prezencë uji të ndotur potencial vatre infeksioni.
- Në pallatin e ashtuquajtur "6 katëshi,, është kryer trajtim me lavicide pasi kemi prezence uji të ndotur në katin e nëndheshëm.
- Vendstrehim (Mcr) pranë Kopshtit Nr.3, e cila nuk është vetëm vatër infeksioni por edhe vend akumulimi për mbeturinat fekale
- Trajtim me larvicide dhe insekticid në Manastitin e Zvërnecit

Në rastet e konstatimeve te problemeve dhe rastet e ankesesave nga drejtuesi i institucionit është proceduar në zhdukjen ose kufizimin e problematikës përkatëse.

Së katërti është realizuar procesi i dezinfektimit në banesat e personave që janë gjetur të pajetë, pas komunikimit nga NJVKSSH dhe organeve policore.

Çdo ditë të javës kryhet monitorim i zonave problematike, identifikimi i vatrave të rrezikut si edhe trajtimi i problematikës përkatëse me anë të procesit të dezinfektimit, dezinspektimit dhe deratizimit.

Deratizimi

Institucione e deratizuara 44 shkolla, 3 çerdhe dhe 43 kopshte. Procesi i Deratizimit përfshin territorin jashte godines së institucionit me anë të preparateve kundër brejtësve.

- Gjimnazi "Shaban Demiraj"

- Gjinnazi “Halim Xhelo”
- Gjinnazi “Ali Demi”
- Gjinnazi “Jani Minga”
- Gjinnazi “Mustafa Qemal Ataturk”
- Shkolla Industriali “Pavarsia”
- Shkolla Profesionale “Tregtare”
- Gjinnazi “Naim Frashëri”
- Gjinnazi “Faslli Danaj” Llakatund
- Gjinnazi “Pilo Prifti” Novoselë
- Gjinnazi “Hasan Mëhilli” Dukat i Ri
- Gjinnazi “Hasan Pulo” Orikum
- Shkolla “Lef Sallata”
- Shkolla “Musa Çakëri”
- Shkolla “4 Heronjtë”
- Shkolla “Zigur Lelo”
- Shkolla “Zenel Murra”
- Shkolla “Ibrahim Kushta”
- Shkolla “Rilindja”
- Shkolla “Muço Delo”
- Shkolla “Avni Rustemi” “
- Shkolla “15 Tetori”
- Shkolla “Marigo Posio”
- Shkolla “Teli Ndini”
- P.L.M
- Shkolla “Jani Minga”
- Shkolla “Ismail Qemali”
- Shkolla “Pilo Prifti” –Novoselë
- Shkolla “Loni Mone”-Poro
- Shkolla “Kafil Malaj” Bishan
- Shkolla “Reshat Hoxha” Akerni
- Shkolla “Taulla Xhafaj” Hoshtime
- Shkolla “Xhemil Bregu” -Panaja
- Shkolla “Perlat Rexhepi”- Cerkovine
- Shkolla “Avni Rustemi” Trevllazër
- Shkolla “Hajredin Haxhiraj” Kerkove
- Shkolla “Ismail Qemali” Fitore
- Shkolla “Faslli Danaj” Llakatund
- Shkolla “Festim Hoxha” Sherishtë
- Shkolla “Lili Gori” Xhuherinë
- Shkolla “Idris Rustemi” Risili
- Shkolla “Faslli Danaj” Llakatund
- Shkolla “Hamit Lumi” Babicë e Vogël
- Shkolla “Selam Musai” Babicë e Madhe
- Kopshti Nr.1
- Kopshti Nr.2
- Kopshti Nr.3
- Kopshti Nr.5
- Kopshti N: 7

- Kopshti Nr:8
- Kopshti Nr:9
- Kopshti Nr:10
- Kopshti Nr:11
- Kopshti Nr: 13
- Kopshti Nr:14
- Kopshti Nr:15
- Kopshti “1 Maj”
- Kopshti “Lef Sallata”
- Kopshti “Musa Çakërri”
- Kopshti “4 Heronjtë”
- Kopshti “Zigur Lelo”
- Kopshti “Zenel Murra”
- Kopshti “Zenel Murra 7 pallatet”
- Kopshti “Loni Mone”
- Kopshti “Ismail Qemali” – Fitore
- Kopshti “Festim Hoxha” Sherishtë
- Kopshti “Hamit Lumi” Babicë e vogël
- Kopshti “Selam Musai” Babicë e madhe
- Kopshti “Lili Gori” Xhuherinë
- Kopshti “Idris Rustemi” Risili
- Kopshti “Nikolla Xhuvëli” Nartë
- Kopshti “Grabian”
- Kopshti “Faslli Danaj” Llakatund
- Kopshti “Reshat Hoxha” Akërne
- Kopshti “Pilo Prifti”- Novoselë
- Kopshti “Skrofotinë”
- Kopshti “Perlat Rexhepi” –Cerkovinë
- Kopshti “Avni Rustemi” –Trevllazër
- Kopshti “Taulla Xhafaj” Hoshtime
- Kopshti “Xhemil Bregu” -Panaja
- Kopshti “Hajredin Haxhiraj” Kerkovë
- Kopshti “Mustafa Qemal Atatürk” Orikum
- Kopshti “Hasan Mëhilli” Dukat i Ri
- Kopshti “Xhevdet Lagji” Radhimë
- Çerdhja Nr:2
- Çerdhja Nr:4
- Çerdhja Nr:15

Spektori Rrugë –Trotuare

Qëllimi kryesor i punës së sektorit gjatë kësaj periudhe ka qenë garantimi i mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore, rritja e sigurisë publike dhe reagimi në kohë ndaj problematikave të evidentuara në territorin administrativ të bashkisë.

1. Ndërhyrjet e realizuara në rrugë

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar ndërhyrje në disa segmente rrugore të qytetit, kryesisht për:

Riparime të shtresave asfaltike

- Mbushje dhe sistemim gropash të krijuara nga amortizimi dhe reshjet;
- Riparime të dëmtimeve në nyje rrugore dhe kryqëzime;
- Sistemim i rrugëve me stabilizant (rrugë të paasfaltuara).
 1. Rruga “Hasan Mëhilli”
 2. Rruga “Ahmet Lepenica”
 3. Rruga “Istref Hoxha”
 4. Rruga “Haki Bylyshi”
 5. Rruga “Babaçe Faiku”
- Sistemim i pjesëve të dëmtuara në rrugët;
 1. Rruga “Sazani” 30 m2
 2. Rruga “Xhemil Bej Vlora” 40 m2
 3. Rruga “Rami Gjebrea” 100 m2
 4. Rruga “Aleksandër Moisiu” 60 m2

Riparime dhe rehabilitime të trotuareve

- Zëvendësim pllakash të dëmtuara;
- Sistemim dhe nivelim sipërfaqesh të amortizuara;
- Riparim bordurash të dëmtuara;
- Sistemim i trotuareve.
 1. Rruga “Veledin Kollozi” 520 m2
 2. Rruga “Pelivan Leskaj” 750 m2
 3. Rruga “Zenel Murra” 750 m2 (në proces)
 4. Rruga “Reshat Osmani” 750 m2

Sinjalistika horizontale dhe vertikale

Rifreskim i vijëzimeve rrugore

- Rifreskim i vijave të bardha anësore dhe qendrore;
- Rilyerje e kalimeve të këmbësorëve;
- Sistemim i vijëzimeve ndarëse të korsive;
- Rifreskim i sinjalistikës në kryqëzime dhe rrethrotullime.
- Vendosje dhe rifreskim i shigjetave orientuese;

1. Rruga “Vasil Puka”
2. Rruga “Çamëria”
3. Rruga “Murat Tërbaci”
4. Bulevardi “Ismail Qemali”

Spektori Mirëmbajtjes së Varrezave.

Spektori i mirëmbajtjes së varrezave BashkiaVlorë në veprimtarinë e tij ka mbuluar kryerjen e punimeve që konsiston në pastrimin e ambjenteve të varrezave të qytetit, pastrimin e kanaleve kulluese, mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme (mbushje,skarifikim të tyre) heqjen e mbeturinave, korrijen dhe heqjen e barërave, mbetjeve inerte si dhe transportimin e tyre në vënd grumbullimin e përcaktuar.

Gjithashtu ky sektor mirëmban dhe Varrezat e Dëshmorëve, duke kryer punime për pastrim të mbeturinave, fshirjen e ambienteve, mirëmbajtjen e luleve (mbjellje dhe ujitje), korrje bari, krasitje ligustrash, pastrime barishtesh.

Kjo është një punë e përditshme në territoret e varrezave të qytetit dhe të Varrezave të Dëshmorëve që kryhet sipas planit të punës. Gjithashtu sektori i mirëmbajtjes së varrezave kryen dhe procesin e shërbimeve funerale, ku përfshihet hapja e gropave, vendosja e të ndjerit, mbulimi dhe betonizimi sipërfaqësor si dhe zhvarrimet me kërkesë të familjarëve.

- 1- Përgjegjësia e sektorit që menaxhon gjithë punët, me hartimin e planit të punës, ndarjen e detyrave që kryen cdo punonjës, vlerësimet për cdo punonjës, hartimin e përgjigjeve të kërkesave, dhënien së zgjidhjes së problematikave, prerjen e tarifave për pagesë për subjektet funerale.
- 2- Brigadieri i sektorit, që kontrollon punën në terren dhe sinjalizon për cdo problem apo nevojë që mund të dali.
- 3- Roja, që monitoron dhe kontrollon gjithë territorin e varrezave të qytetit (ora 13:30-20:00).
- 4- Punëtorët , që merren me pastrim , mirëmbajtje të terrenit në varrezat e qytetit si dhe në kryerjen e shërbimeve funerale që janë të ndarë sipas grupeve për llojin e punës që duhet të kryejnë , konkretisht:

Qëllimi kryesor i punëve si në varrezat e qytetit dhe në Varrezat e Dëshmorëve është dhe mbetet pasja e një ambienti sa më të pastër për të krijuar një akses sa më të mirë të njerëve gjatë vizitave të tyre tek të afërmit. Realizimi i punëve nuk ka qenë i lehtë, kjo dhe për mungesë të burimeve njerëzore dhe të kushteve që vetë territori i varrezave ka, siç është mbulimi i një pjese të madhe të këtij territori me kangjella.

Kryerja e punëve për mirëmbajtje të varrezave të qytetit kryhet në një sipërfaqe prej 20 ha.

Kjo sipërfaqe ka në përbërje të saj aktualisht 79 parcela të ezauruara si dhe 2 parcela të lira për shfrytëzim me një kapacitet prej rreth 170-200 vend prehje.

Gjatë periudhës 4 mujore Janar-Prill 2026 janë kryer 233 shërbime funerale, janë hequr (prerë) 15 pemë të thara apo që kanë qenë në rrezik rrëzimi.

Të gjitha letër kërkesat e ardhura pranë sektorit të mirëmbajtjes së varrezave ju është dhënë përgjigje dhe zgjidhje në kohë brenda afateve kohore që përcakton ligji për informim.

Sektori i Nriçimit Publik

Gjatë periudhës Shkurt – Prill 2026, Sektori i Ndrëçimit Publik ka zhvilluar një aktivitet të vazhdueshëm në drejtim të mirëmbajtjes dhe garantimit të funksionimit normal të rrjetit të ndrëçimit publik në të gjithë territorin e qytetit.

TË DHËNA TABELARE, NDRIÇIMI PUBLIK

Përshkrimi i shërbimit	i	Njësia matëse	Sasia e realizuar	Zona
------------------------	---	---------------	-------------------	------

Rrjet ndriçimi i mirëmbajtur (urban)			Zona 77
Rrjet ndriçimi i mirëmbajtur (rural)			Zona 3
Pika ndriçimi funksional	nr	197	Zona të ndryshme
Pika ndriçimi të riparuar	nr	80	Zona të ndryshme
Pika të reja ndriçimi të instaluar	nr	2	1) Ish Fabrika e Tullave (Lirim) 2) Xhyherinë

Në këtë periudhë janë trajtuar gjithsej 217 problematika/raste, të ndara si më poshtë:

- 24 ankesa me shkrim;
- 4 ankesa nga portali;
- 162 ankesa me telefon;
- 27 konstatime në terren.

Të gjitha rastet janë verifikuar në terren dhe janë marrë masat përkatëse për zgjidhjen e tyre brenda afateve të përcaktuara.

Në kuadër të ndërhyrjeve teknike janë realizuar:

- 431 ndriçues të riparuar;
- 201 ndriçues LED të zëvendësuar;
- 53 ndriçues të rinj të vendosur në zona pa ndriçim (42 LED dhe 11 me llamba).

Janë evidentuar dhe sistemuar 119 defekte në linjat e furnizimit, kryesisht si pasojë e punimeve në rrugë, amortizimit të rrjetit dhe rasteve të vjedhjes së kabllit elektrik.

Sa i përket shtyllave të ndriçimit:

- 10 shtylla të dëmtuara nga aksidente;
- 9 shtylla të drejtuar;
- 6 shtylla të reja të vendosura.

Janë kontrolluar gjithsej 259 panele ndriçimi, ku janë konstatuar dhe sistemuar problematika të ndryshme si djegie të automatëve, lëshuesve, fotoelementëve dhe defekte në linjat e brendshme. Gjithashtu:

- janë kryer 19 ndërhyrje në shkolla dhe kopshte;
- është realizuar heqja dhe sistemimi i ndriçimit dekorativ sezonal;
- janë hequr elementë dekorativë (shandanë) dhe janë sistemuar në magazinë;
- është realizuar pastrimi i shtyllave në akset kryesore;
- janë vendosur kapakë mbrojtës në shtylla të dëmtuara ose të vjedhura.

Në përfundim, sektori ka përmbushur detyrat funksionale me efikasitet, duke garantuar një nivel të qëndrueshëm shërbimi dhe reagim në kohë ndaj problematikave në terren.

POLICIA BASHKIAKE

Gjatë periudhës 01.01.2026-30.04.2026 Policia Bashkiake Vlorë ka ushtruar aktivitetin e saj në zbatim të detyrave funksionale dhe kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për Policinë

Bashkiake, vendimet e Këshillit Bashkiak, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit të Bashkisë Vlorë. Veprimtaria është përqendruar kontrollin dhe disiplinimin e hapësirave publike, mbikëqyrjen e zbatimit të akteve administrative të Bashkisë, si dhe në ofrimin e shërbimit ndaj komunitetit në mënyrë korrekte dhe profesionale

.Gjatë kësaj periudhe është punuar në përputhje me planifikimin mujor dhe plan-vendosjen e miratuar, duke iu përgjigjur njëkohësisht edhe problematikave dhe situatave të ndryshme që janë paraqitur në territorin e Bashkisë Vlorë.

Në fushën e mjedisit

Vëmendje e vecantë nga ana e Policisë Bashkiake i është kushtuar subjekteve dhe individëve që hedhim mbetje jashtë kontenerëve të mbetjeve urbane , duke u bërë një shqetësim i vazhdueshëm për komunitetin dhe shërbimet e pastrimit .Në raste flagrante apo denoncime përmes video dhe foto,Policia Bashkiake ka aplikuar masë administrative me gjobë.Per periudhën janar-prill 2026 janë vendosur **20 masa administrative me gjobë.**

Policia Bashkiake Vlorë,në bashkëpunim me sektorin e mjedisit dhe shërbimin veterinar ka vendosur **41 masa administrative** ndaj poseduesve të bagëtive

Gjatë periudhës janar-prill 2026 Policia Bashkiake ka evidentuar disa raste të ndotjes së infrastrukturës rrugore nga kamionë të subjekteve të ndryshme që ushtrojnë aktivitet transporti dhe ndërtimi. Për këto shkelje janë marrë **17 masa administrative me gjobë**, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të Bashkisë.

Njëkohësisht, i është kushtuar rëndësi e veçantë ndërgjegjësimit dhe kontrollit të vazhdueshëm të subjekteve, me qëllim respektimin e kushteve për ruajtjen e mjedisit, mirëmbajtjen e infrastrukturës publike dhe shmangien e ndotjes në hapësirat e përbashkëta. Kontrollat do të vijojnë edhe në vazhdimësi për të garantuar zbatimin korrekt të detyrimeve ligjore nga ana e subjekteve.

• Hapësirat Publike

Prioritet i punës tonë ka qenë dhe kontrolli i vazhdueshëm që lidhet me shfrytëzimin i hapësirave publike në territorin e Bashkisë Vlorë. Masa administrative të marra në periudhën janar-prill 2026 për zënie të hapësirës publike janë **60 masa administrative gjobë**

Lirimi i hapësirave publike të zëna nga tregtarët ambulantë, nga subjektet që tregëtojnë mallra jashtë ambjenteve të biznesit.Janë mbajtur 120 akte konstatimi për lirim të hapësirës publike.

• Qarkullimi

Në periudhën 01.01.2026-30.04.2026, prioritet i Sektorit të Qarkullimit Rrugor, ka qenë rehabilitimi dhe disiplinimi i qarkullimit në zonën e stacionit të ri të përkohshëm të autobusëve interurbanë, me qëllim garantimin e një qarkullimi sa më të rregullt dhe shmangien e problematikave që lidhen me trafikun dhe parkimet e parregullta.

Gjithashtu, janë marrë masa të vazhdueshme për evidentimin dhe ndëshkimin e parkimeve dyshe, trotuare dhe mbi vijat e bardha, me qëllim lirimin e hapësirave për këmbësorët dhe përmirësimin e qarkullimit rrugor. Për periudhën janar-prill 2026 janë marrë **6290 masa administrative gjobë**.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar kontrollit të mjeteve taksi të licencuara nga Bashkia, të cilat në disa raste kanë ushtruar aktivitet në mënyrë abuzive, në kundërshtim me kërkesat e **Udhëzimit Nr. 15, datë 24.07.2007**. Në këto raste janë marrë **10 masa administrative** dhe janë dhënë paralajmërimet përkatëse për zbatimin korrekt të detyrimeve ligjore.

- **Të ndryshme**

Një risi për Drejtorinë është riorganizimi dhe strukturimii ri i shërbimeve të Policisë Bashkiake me synim forcimin e kapaciteteve operacionale, rritjen e efektivitetit në terren dhe përmbushjen sa më të mirë të detyrave funksionale.

Janë zgjidhur në kohë të gjitha ankesat e ardhura nga qytetarët, Platforma e Bashkëqeverisjes në rreth 82 raste.

Eshtë mbuluar me shërbim Tregu në Novoselë cdo ditë të enjte.

Eshtë bërë siguria e aktiviteteve sportive që Klubi Sportiv “FLAMURTARI” dhe “ORIKU” kanë zhvilluar sipas kalendarit sportiv të tyre.

Policia Bashkiake ka garantuar mbarëvajtjen e aktiviteteve kulturore të organizuara në kuadër të festimeve të **Ditës së Verës**, nëpërmjet marrjes së masave për menaxhimin e qarkullimit rrugor, orientimin e qytetarëve dhe monitorimin e hapësirave publike. Gjithashtu, është siguruar koordinimi institucional me strukturat përgjegjëse për zhvillimin normal të aktiviteteve dhe shmangien e problematikave që mund të ndikonin në ecurinë e tyre.

Policia Bashkiake është angazhuar në krijimin e kushteve optimale për punën që kryejnë firmat zbatuese të projekteve të shumta që kryhen në qytet. Gjithashtu, kemi bashkëpunuar cdo ditë me drejtoritë e Bashkisë UK, NSHP, DIP, sipas kërkesës së tyre duke ndërhyrë në largime mjeteshe që behen pengesë për punime dhe bllokime segmentesh rrugore në vartësi të proceseve të punimeve.

DREJTORIA E INFRASTRUKTURES DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

SEKTORI STREHIMIT

Gjatë 4 mujorit të parë janar-prill 2026 nga specialistja e strehimit për sektorin e strehimit janë kryer të gjitha funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë që i takojnë këtij sektori të përcaktuara me aktet ligjore e nënligjore dhe të pasqyruara në rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Vlorë”.

1. Gjatë muajve janar-shkurt-mars kanë vazhduar procedurat për përfundimin e aplikimit për familjet/individët që do të përfitonin nga projekti i kredive me kushte lehtësuese nga shteti. Për këtë janë bërë shpalljet publike për njoftim të qytetarëve, me qëllim plotësimin dhe depozitimin e dokumentacionit shtesë. Këto janë administruar dhe përcjellë për shqyrtim dhe vendimmarrje në Komisionin e Strehimit të Bashkisë, ku janë marrë vendimet;

-Vendim Nr.1, datë 15.01.2026.

-Vendim Nr.2, datë 18.02.2026

-Vendim Nr.3, datë 13.03.2026

2. U përgatit dhe paraqit në Këshillin e Bashkisë për miratim në mbledhjen e datës 31.03.2026 projektvendimi “Për miratimin e listës emërore të familjeve dhe individëve që përfitojnë banesë me kosto të ulët nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga buxheti i shtetit”

3. Janë kryer procedurat për trajtimin me subvencionin e qirasë në treg të lirë të familjeve dhe individëve që kanë aplikuar pranë Bashkisë Vlorë për të përfituar nga ky program. Janë asistuar për plotësimin e dokumentacionit, janë bërë verifikimet e duhura në terren në bashkëpunim me rajonet, janë përcjellë dosjet në Komisionin e Strehimit dhe është hartuar i gjithë dokumentacioni shkresor në funksion të projektvendimit “Për miratimin e familjeve/individëve në nevojë që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe nuk mund të përballojnë me të ardhurat e tyre pagesat e qirasë”.

4. Në funksion të zbatimit të programit social “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” është bërë;

-shpallje publike për informimin e familjeve/individëve që përfitojnë nga ky program

-komunikim i vazhdueshëm me personat në sportelet e zyrës me një ndalesë për informim më të detajuar dhe problematikat e hasura gjatë përgatitjes së dokumentacionit. Për këtë janë asistuar së bashku me zyrën për dhënie të ndihmës juridike falas.

-kemi vajtur në terren në të gjitha banesat e përzgjedhura në bashkëpunim me njësitë administrative ku ndodhen banesat dhe grupet e hartimit të projekteve të drejtorisë së urbanistikës.

-janë administruar të gjitha dosjet e aplikantëve dhe janë përcjellë në Komisionin e Strehimit të Bashkisë për shqyrtim dhe vendimmarrje.

-është përgatitur projektvendimi dhe përcjellë për të miratuar në Këshillin e Bashkisë për

-“Miratimin e listës emërore të familjeve/individëve që përfitojnë nga programi ”Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”

-“Miratimi i deklaratës për bashkëfinancim drejtuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për programin e përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

-Është përgatitur gjithë dokumentacioni shkresor për aplikimin pranë Minsitrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për efekt të përfitimit të bashkëfinancimit nga buxheti i shtetit në programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

-është përgatitur dhe paraqitur në Këshillin e Bashkisë për të miratuar projektvendimi për “Miratimin e zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave, në lagjen “Kushtrimi”.

-Kanë vazhduar aplikimet për të përfituar subvencionin e qirasë në treg të lirë nga familje dhe individë në nevojë për strehim. Komunikimi i vazhdueshëm me ta për informim lidhur me këtë program, për plotësim të dokumentacionit, për verifikim në terren të banesave sipas kontratës së qirasë.

-Për aplikimet e kryera lidhur me privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara janë shqyrtuar dokumentacioni dhe banesat në terren, për përputhshmëri me përcaktimet në aktet ligjore e nënligjore. Për praktikat e plotësuara janë përgatitur dosjet e privatizimit, formularët përkatës dhe vazhdimi në zyrat noteriale për nënshkrimin e kontratave të privatizimit.

-Për trajtimin e çështjeve të përbashkëta ka vazhduar komunikimi verbal dhe shkresor me drejtori të caktuara brenda Bashkisë Vlorë dhe me drejtori e institucione në nivel vendor dhe qëndror.

-Janë trajtuar kërkesat dhe ankesat e qytetarëve për probleme të ndryshme të strehimit dhe në të gjitha rastet e duhura u kemi kthyer përgjigje me shkrim.

-Kontakte të përditshme, të përhershme me qytetarët për çështje që lidhen me strehimin social në zyrën me një ndalesë pranë bashkisë, kryhen çdo ditë dhe në çdo orar.

SEKTORI I TRANSPORTIT

Sektori i transportit zbaton me përpikmeri të gjitha dispozitat për nxjerrjen e liçencave dhe çertifikatave për transport mallrash për vete dhe të tretë, transport udhëtarësh rrethqytetes , qytetës, taksi, agjensi transporti brenda vendit me taksi dhe transport ndërkombëtar, licencë tregtim karburanti.

Licensimi i subjekteve bëhet në bazë të Ligjit 8308 datë 18.08.1998 "Për transportet rrugore" , i ndryshuar, VKM, udhëzimeve të MIE dhe VKB.

Gjatë 4- mujorit të parë të vitit 2026 është bërë licensimi i të gjithë atyre subjekteve të cilët kanë paraqitur kërkesat për licensim dhe çertifikim.

1-Taksi 4+1 janë licensuar gjithsej 17 subjekte, me afat 5-vjeçar.

2-Taksi 8+1 janë licensuar 5 subjekte me afat 5 vjeçar.

3-Çertifikata për transport mallrash për llogari të vet certifikuar 29 subjekte

4- Licencë transport mallrash për të tretë 2 subjekte dhe për këto subjekte certifikuar 30 mjete.

5-Çertifikata mjetesesh rrethqytetase 37 copë.

6-Çertifikatë udhëtarësh për llogari të vet janë 1 copë

Drejtorja DIIP pajis me licence tregtim karburanti subjektet të cilat tregtojnë karburant. Në Bashkinë Vlorë ushtrojnë aktivitetin tregtim karburanti 40 subjekte, nga të cilat 19 subjekte janë të pajisura me licencë, ndërsa 21 subjekte nuk kam bërë rinovimin e licencës. Për subjektet të cilat u ka mbaruar afati i licensimit DIIP ka bërë njoftime përkatëse të gjithë subjekteve, që të paraqiten për të paguar taksën e licensës për tregti karburanti. Po ashtu DIIP ka bërë njoftim dhe për subjektet të cilat janë debitorë dhe ka lënë KLSH detyrimin për ta paguar.

Taksa e parkimit është vjelë nga të gjithë subjektet në momentin që subjekti pajiset me lic+certif, dhe vlefta e taksës parkimit është në bazë të VKB .

Për të bërë të mundur rritjen e të ardhurave nga transporti, Drejtorja e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike ka bashkëpunuar me Drejtorine Vendore të Taksave, në bazë të korespondencës për shlyerjen e detyrimeve të tatim taksave, po megjithatë këtu ka vend për përmiresime.

Sektori i transportit ka një koorespondentë të mirë me institucionet përkatëse si me DRSHTRR Vlorë, MIE dhe institucione të tjera.

Në lidhje me kërkesat e qytetarëve sektori i transportit është përpjekur në zgjidhjen e problematikave të ndryshme të paraqitura prej tyre, si në sqarime verbalisht të tyre dhe në përgatitjen e dokumentave përkatëse sipas kërkesave të paraqitura.

SEKTORI I INFRASTRUKTURËS.

Gjatë periudhës Janar-Prill 2026, janë kryer këto detyra nga ana e specialistit të infrastrukturës të Drejtorisë së Investimeve dhe Infrastrukturës Publike,

A. Bashkëpunim me Shoqërinë Rajonale të Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a. Vlorë dhe Njësinë Vendore të OSSH për kryerjen e punimeve në infrastrukturë publike, rrugë, sheshe, trotuare, etj, asete të Bashkisë Vlorë.

Janë dhënë autorizime për kryerje punimesh operatorëve ekonomik, për pikë lidhje uji dhe pikë e shkarkimit, sipas objekteve të lejeve të ndërtimit, është në proces autorizimi për lejen e ndërtimit nr.865/2prot., datë 08.07.2025, për objektin “VLORA LANDMARK RESORT,,

U janë dhënë autorizime për kryerje punimesh qytetarëve, për pikë të furnizimit me ujë , znj.Ofeli Sejdiraj dhe pikë lidhje me energji elektrike, Agim Xhyheri, etj.

Pra, gjatë kësaj periudhe, në zbatim të VKB, janë dhënë autorizime për kryerje punimesh në infrastrukture publike OSSH dhe Ujësjiellës kanalizimeve sipas problematikave të ardhura në Bashkinë Vlorë, duke kërkuar rigorozisht preventiv të kthimit në gjendjen fillestare.

B. Është mbajtur korrespondenca me institucionet, Avokatin e Popullit, Prefektin e Qarkut, etj.

C. Bashkëpunim me drejtoritë e tjera, me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Urbanistikës, me Drejtorinë e Aseteve dhe Pronave publike.

Janë bërë përlllogaritje fondesh mbikqyrje Janar 2026-Prill 2026:

- 1- "Furnizim vendosje pajisje për ndricim publik"
- 2- "Rivitalizim i Tregjeve Tradicionale dhe Agroushqimore, Bashkia Vlorë ”
- 3- Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të fshatit Panaja & Hapësira sportive brenda territorit të hkollës « Xhemil Bregu », Panaja » Nj.Ad.Qendër, Bashkia Vlorë
- 4- “Rehabilitimi i interseksionit rrugor të aksit kryesor “Dhimitër Konomi”
- 5- Rikonstruksion I shkollës 9-vjeçare “Marigo Posio
- 6- Rehabilitim i Hidrovorit të qytetit të Vlorës
- 7- “Pastrimi i kolektorit nga rruga “Demokrcia” deri te rruga “Vasil Puka”
- 8- “Riveshje me asfalt për vitin 2026, Loti I”,
- 9- “Riveshje me asfalt për vitin 2026, Loti II”,
- 10- “Instalimi i impjanteve semaforike”

11- Mbikqyrja “F.V. NDRIÇUES FOTOVOLTAIK për nevoja të Bashkisë Vlorë-Marrveshje kuadër me një operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”,

12- “Rikonstruksion i palestrës multisportive të ekipir “Flamurtari”-Bashkia Vlorë”

13- “Rehabilitimi i stacioneve të autobuzeve urban”

Janë llogaritur **fondet për koaludim punimesh:**

1-Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare „Lef Sallata, palestër dhe shtesë 3-katëshe“

2-Rikonstruksion i rrugës së fshatit Radhimë

3-Barrierat matalike përgjatë rrugës Transballkanike dhe Ali Demi

4-Kolaudim “Rikonstruksion i rrugës pas Bashkisë Vlorë, “Donika Kastrioti”, “Meno Gjoleka”, “Malo Beqari”, “Shtjefn Gjeçovi” dhe “Haxhi Xhyheri”, rruga përballë shkollës “Naim Frashëri” dhe segmenti rrugor “janaq Kilica, Rakip Malile

5-Rehabilitim i Kanalit Kallafet dhe Babcicë Vlorë (Skema ujitëse VLU-9 Babcicë-Dega majtas dhe Djathtas”

6-“Rikonstruksion i rrugës “Zenel Gjoleka (te Ujësjiellësi)”

D. Është mbajtur korrespondenca lidhur me investimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, kryesisht për ankesa të banorëve të blloqeve të pallateve të rigjenerimit urban, rrugës “Halim Xhelo”, Tregun e qytetit, etj.

E.Është verifikuar në vend çdo problematikë e objekteve të arsimit parauniversitar dhe janë hartuar raporte mbi gjendjen infrastrukturore, shkolla 9-vjeçare “28 Nëntori”, po ashtu si pjesë e grupit të punës për “Lyerje godinash”, janë inpektuar objektet,

Çerdhja nr.4,

Çerdhja nr.2,

Çerdhja nr 14,

shkolla artistike “Naim Frashëri”,

shkolla 9-vjeçare “Musa Çakëri”,

shkolla e mesme “Mustafa Qemal Atatürk”

shkolla 9-vjeçare “Jani Minga,,

shkolla e mesme “Jani Minga,,

shkolla 9-vjeçare “Zigur Lelo,,

shkolla 9-vjeçare “Zenel Murro,,

Kopshti “Sulo Didi ,,

Është bërë përllogaritja për lyerje të jashtme me akrilik të këtyre godinave.

F.Evidentime në terren, në investimet korrente;

- 1-Hapësirat Orikum
- 2-Blloku te Sigurimet
- 3-Lyerje godinash
- 4-Kopshti nr.10
- 5-“Rikonstruksion i rrugës pas Bashkisë Vlorë, “Donika Kastrioti”, “Meno Gjoleka”, “Malo Beqari”, “Shtjefn Gjeçovi” dhe “Haxhi Xhyheri”, rruga përballë shkollës “Naim Frashëri” dhe segmenti rrugor “janaq Kilica, Rakip Malile”- trajtim ankese

Sipas ankesave të qytetarëve:

- Ankese z.Filip Kacaj
- 2-Kerkese Agim Xhyheri
- 3-Kerkese Meri Group
- 4-Ofeli Sejdiraj
- 5- Elisabeta Aliko
- 6-Shkolla“L.Sallata”per lab.smart
- 7- Z.Alesio Hoxhaj per rrugen Bajram Tushe
- 8- Z.Ismail Boraj
- 9- Z.Jani Llanaj
- 10- Znj.Eliona Bari
- 11-DJ
- 12-NSHP per rruget “Sazani”, “Aleksandër Moisiu”, “Ramize Gjebrea
- 13- Shkolla 9-vjeçare “28 Nëntori
- 14- znj.Borana Koçiaj

SEKTORI I INVESTIMEVE PUBLIKE

Sektori i Investimeve Publike Gjatë periudhës 4 Mujore Janar - Prill 2026 janë zbatuar projektet.

A. Janë kontrolluar dhe është mbajtur korrespondenca me kontraktorët dhe supervizorët për objektet që janë në faze punimesh.

Konkretisht janë hartuar dokumentacionet për objektet si më poshtë:

1. Rikonstrukion i rrugës Ded Gjon Luli.(pezulluar)
2. Rikonstrukion i banesave të shtresave në nevojë.
3. Rikonstruksion i Kopshtit Nr.10.
4. Rikonstruksion i rrugës “Ish Fabrika e Çimentos”.
5. Barriera metalike mbrojtëse për këmbësorët përgjatë rrugës “ Transbalkanike dhe Ali Demi”.(ka përfunduar, s’ka dalë kolaudatori)
6. Shtesë për pallatin 1300.
7. Hapesira sportive në shkollën Balil Pelar
8. Rikonstruksioni i rrugës së varrezave në fshatin Risili
9. Rikonstruksioni i rrugëve fshatrat Kallafet dhe Liçaj
10. Kanalet e ujërave të larta
11. Rikonstruksioni i Shkollës Marigo Posio
12. Rruga në Panaja me ndriçim & Këndi sportive
13. Furnizim vendosje pajisje për ndriçim public.
14. Rehabilitimi I Hidrovorit të qytetit të Vlorës
15. Pastrimi I kolektorit nga rruga “Demokracia” – rruga “Vasil Puka”

B. Është mbajtur korrespondenca me institucionet dhe qytetarët për problematika të ndryshme në lidhje me infrastrukturën dhe investimet.

C. Sektori i Investimeve ka ushtruar funksionet e veta dhe në zbatim të kontratave të lidhura ka dorëzuar sheshet e ndërtimit kontraktoreve si dhe po kontrollon në mënyrë periodike punimet në të gjitha objektet.

DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social pranë Bashkisë Vlorë ka në fokus zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, me synim adresimin e nevojave sociale në rritje të grupeve në vështirësi ekonomike dhe sociale, si dhe garantimin e mbulimit të tyre me shërbime ekzistuese dhe shërbime të reja sociale për të gjithë komunitetin. Nëpërmjet këtyre shërbimeve synohet ofrimi i mbështetjes sa më pranë qytetarëve, në përputhje me modelet dhe praktikën më të mira bashkëkohore.

Shërbimet sociale ofrohen në përputhje me standardet dhe kuadrin ligjor në fuqi, duke u mbështetur në qasjen me individin në qendër të çdo ndërhyrjeje. Në këtë kuadër, synohet ngritja dhe konsolidimi i një sistemi të balancuar të shërbimeve sociale, i cili do të ketë në fokus grupet në nevojë, duke garantuar mbulim më të mirë të nevojave të tyre dhe akses më të plotë në shërbimet e kujdesit shoqëror, përmes fuqizimit të shërbimeve ekzistuese dhe zhvillimit të shërbimeve të reja.

Gjatë periudhës Janar – Prill 2026, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social ka vijuar zbatimin e projektit për Qendrën Ditore të të Moshuarve. Aktualisht, qendra funksionon çdo ditë, duke ofruar vakt ushqimor dhe mbështetje të vazhdueshme sociale për të moshuarit nga stafi i specializuar.

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social ka trajtuar me përgjegjshmëri dhe përpikmëri çdo kërkesë dhe ankesë të qytetarëve, me qëllim ofrimin e shërbimeve sa më efikase dhe në kohë.

Si më poshtë vijon, secili nga sektorët që funksionojnë në brendësi të DNSHS, paraqet punën e kryer në këtë periudhë 4-mujore :

SEKTORI FINANCË-STATISTIKË

Numri i familjeve përfituesve në vështirësi ekonomike nga të ardhurat e bashkisë ka qënë afërsisht rreth 29 familje në muaj me një fond 12-mujor prej 1.815.000 lekë.

Emërtimi	Përfitues të ndihmës ekonomike - 2026	
	Numër	Lekë
Bashkia	26	408.500

Njesia Shushicë	4	100.000
Njesia Qendër	1	84.000
Njesia Novosele	4	48.000
Njesia Orikum	3	12.000
TOTALI	38	652.500

Ndërsa për numrin e përfituesve të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike nga *fondi i kushtëzuar 6%* për periudhën Janar-Prill 2026 janë trajtuar 17 familje me një fond 189.346.

Emërtimi	Përfitues te ndihmes ekonomike	
	2026	
	Numër	Lekë
Bashkia	17	189.346
TOTAL	17	189.346

Pagesat për të gjitha këto kategori e personave me aftësi të kufizuar kanë vazhduar pa ndërprerje edhe për personat që kanë mbaruar afatin e komisionimit për të mos krijuar probleme sociale dhe konkretisht:

Emërtimi	P.A.K + kujdestarë		Tetraplegjik+ kujdestarë		Verbëri kujdestari		Invalid		Total	
	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek
P.A.K 26	2009	98.288	586	61.038	659	44.342	0	0		203.668

NJËSIA PËR ÇËSHTJET KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Gjatë periudhës Janar – Prill 2026, puna në cilësinë e Koordinatorës Vendore Kundër Dhunës në Familje është fokusuar në trajtimin, koordinimin dhe ndjekjen e rasteve të dhunës në familje dhe rasteve që kanë kërkuar mbështetje institucionale ndërdisiplinore, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe mekanizmit të referimit.

1. Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar gjithsej 15 raste me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje (UMM) dhe 17 raste me Urdhër Mbrojtjeje (UM).

2. Janë zhvilluar takime koordinuese me institucionet përkatëse, kontakte telefonike dhe komunikime zyrtare me palët, si dhe është realizuar shoqërimi i disa rasteve pranë Komisarariatit të Policisë.
3. Është kryer monitorimi i zbatimit të urdhrave të mbrojtjes dhe ndjekja e vazhdueshme e situatës së familjeve dhe personave të përfshirë në raste.
4. Gjatë kësaj periudhe janë hartuar relacione dhe raporte për gjykatë, procesverbale, shkresa përcjellëse, kthim përgjigjesh ndaj institucioneve, si dhe janë mbajtur evidencat statistikore dhe administrative të rasteve të trajtuara.
5. Puna është orientuar drejt ofrimit të mbështetjes profesionale dhe koordinimit institucional për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje, si dhe orientimit të tyre drejt shërbimeve ligjore dhe psikologjike pranë qendrës Psiko-Sociale “Vatra”.
6. Për secilin rast është realizuar pritja dhe intervistimi i palëve, vlerësimi paraprak i nevojave dhe nivelit të riskut, koordinimi me institucionet përgjegjëse, ndjekja e procedurave për referim dhe mbështetje, si dhe dokumentimi administrativ i rasteve.

NJËSIA E MBROJTJES DHE TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, e përbërë nga një Punonjëse për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF), gjatë periudhës Janar – Prill 2026 ka trajtuar 22 raste të reja, ndërkohë që në total janë administruar dhe vazhdojnë të ndiqen 131 raste të mbartura. Rastet e trajtuara gjatë kësaj periudhe kanë përfshirë problematika të ndryshme, si braktisja shkollore, referime nga Shërbimi i Provës, raste të referuara nga ALO 116, si dhe raste të fëmijëve me nevojë për mbështetje psiko-sociale dhe trajtim pranë psikologut.

Në kuadër të vlerësimit dhe ndjekjes së rasteve, janë realizuar rreth 70 vizita në familje dhe dalje në terren, me qëllim verifikimin e kushteve ekonomiko-sociale dhe mënyrës së jetesës së fëmijëve, si dhe identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të tyre gjatë kësaj periudhe 4-mujore.

Punonjësja e Mbrojtjes së Fëmijës ka vijuar punën në terren me fokus mbrojtjen, identifikimin dhe adresimin në kohë të problematikave që prekin fëmijët. Në kuadër të forcimit të mekanizmave mbrojtës, gjatë sezonit veror do të ngrihen dhe funksionojnë edhe skuadrat e terrenit, të cilat do të bashkëpunojnë ngushtësisht me strukturat përkatëse për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve në nevojë. Gjithashtu, Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijëve ka marrë pjesë në seanca gjyqësore në funksion të rasteve të trajtuara, duke përfaqësuar dhe mbështetur interesin më të lartë të fëmijës në proceset përkatëse.

Nga muaji Prill kanë nisur dhe po vijojnë aktivitetet dhe sesionet informuese në shkolla, në bashkëpunim me anëtarët e Mekanizmit Koordinues të Referimit (MKR), me qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin e fëmijëve mbi çështje që lidhen me mbrojtjen, sigurinë dhe mirëqenien e tyre. Aktivitetet po zhvillohen përgjatë një periudhe rreth trejavore në të gjitha shkollat e qytetit të Vlorës, si dhe në njësitë administrative Orikum, Llakatund etj.

PMF- ka marrë pjesë gjithashtu në trajnime dhe aktivitete të ndryshme profesionale, me fokus forcimin e kapaciteteve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, menaxhimit të rasteve dhe kujdesit alternativ. Në veçanti, trajnimet kanë vënë theksin tek rëndësia e rritjes së fëmijës në një mjedis familjar, promovimi i kujdesit alternativ familjar dhe forcimi i rolit të familjes si elementi kryesor për zhvillimin, mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijës.

NËPUNËSI PËR ÇËSHJTJET E BARAZISË GJINORE

Për periudhën Janar-Prill 2026, nëpunësi i barazisë gjinore ka asistuar në mbështetje me shërbim sociale si dhe asistim në vlerësimin e nevojave të rasteve sociale si dhe referim pranë institucioneve ofruese shërbimesh falas. Ka qenë pjesëmarrës në të gjitha mbledhjet e këshillit bashkiak. Nëpunësi gjinor ka qenë pjesëmarrës edhe në tryezat konsultative mbi çështjet e barazisë gjinore, si dhe pjesëmarrës në trajtime të ndryshme nga OJF-të me fokus barazinë dhe drejtësinë gjinore. Ka asistuar në 30 seanca gjyqësore në bashkëpunim me Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijëve, për çështjet e fëmijëve me problematika socio-ekonomike si dhe ka asistuar në vlerësimet e nevojave të rasteve të dhunës në familje në bashkëpunim me Koordinatorën Vendore të Dhunës dhe ka qenë pjesëmarrës aktiv si në ETN ashtu dhe në GTN e realizuara mbi çështjet e ndryshme dhe problematikat sociale të paraqitura pranë DNSHS-së. Është punuar për nënshkrimin e Kartës europiane për barazinë gjinore.

NJËSIA E VLERËSIMIT DHE REFERIMIT TË NEVOJAVE TË RASTIT

Ky raport paraqet përmbledhjen e punës së zhvilluar gjatë periudhës Janar-Prill 2026, nga Njësia e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave, në funksion të identifikimit, vlerësimit dhe referimit të rasteve në nevojë, me qëllim garantimin e mbështetjes sociale të nevojshme për individë dhe familje në kushte të vështira ekonomike dhe sociale.

I. AKTIVITETET KRYESORE

1. Vlerësimi i rasteve sociale

Numri total i rasteve të vlerësuara 31.

Kategoritë e vlerësuara: persona me aftësi të kufizuara, të moshuar, persona me probleme të shëndetit mendor, etj.

2. Verifikime në terren

Janë realizuar 27 verifikime në terren për raste të ndihmës ekonomike, pensioneve sociale dhe shërbimeve sociale.

3. Referimi i rasteve

Janë referuar për ndihmë dhe mbështetje 3 raste në bashkëpunim me institucione si shëndetësia, policia, mirëmbajtja etj.

4. Ndjekja e rasteve problematike

Është bërë monitorimi periodik i rasteve të vështira sociale dhe bashkëpunim për ndërhyrje institucionale të shpejta.

5. Bashkëpunim me institucionet përkatëse për mbështetjen social-ekonomike dhe ofrimin e shërbimeve të punësimit për të dënuarit që janë në proces rehabilitimi dhe integrimi.

II. SFIDAT E HASURA

1. Raste komplekse që kërkojnë ndërhyrje ndërinstitucionale
2. Mungesë e strukturave të strehimit për raste urgjente.
3. Burime të kufizuara për trajtim afatgjatë të rasteve.

Qendra e të Moshuarëve:

Gjatë periudhës Janar 2026 – Prill 2026, qendra ditore për të moshuarit ka vijuar ofrimin e shërbimeve sociale dhe mbështetëse me fokus përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies së personave të moshës së tretë. Aktiviteti i qendrës është zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme, duke garantuar mbështetje ushqimore, sociale dhe rekreative për përfituesit e saj.

Aktualisht, 25 të moshuar përfitojnë nga shërbimi ushqimor i qendrës, të përzgjedhur mbi bazën e kriterëve të përcaktuara dhe vlerësimit social të rasteve. Prioritet u është dhënë individëve që jetojnë të vetmuar, personave që përfitojnë pension minimal ose pension social, si dhe të moshuarve të identifikuar me nevoja të theksuara sociale nga punonjësja sociale e qendrës.

Në kuadër të kujdesit të vazhdueshëm dhe mbështetjes për rastet më në nevojë, 4 persona përfitojnë çdo ditë shpërndarjen e ushqimit në banesë, për shkak të pamundësisë fizike apo kushteve shëndetësore që ua vështirësojnë paraqitjen pranë qendrës. Ky shërbim ka kontribuar në sigurimin e kujdesit bazë dhe në reduktimin e izolimit social të tyre.

Paralelisht me shërbimin ushqimor, qendra ka organizuar aktivitete të ndryshme ditore me karakter rekreativ dhe social, ku marrin pjesë rregullisht 10 të moshuar. Këto aktivitete kanë synuar nxitjen e socializimit, përfshirjes aktive në komunitet, mbështetjes emocionale dhe krijimin e një ambienti të ngrohtë e gjithëpërfshirës për të moshuarit. Përmes aktiviteteve sociale, bisedave në grup, lojërave rekreative dhe aktiviteteve festive, është synuar ruajtja e mirëqenies psikologjike dhe promovimi i një jetese sa më aktive për përfituesit e qendrës.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar gjithashtu biseda dhe seanca mbështetëse me psikologun e qendrës, të fokusuara në mirëqenien emocionale, menaxhimin e vetmisë, komunikimin social dhe përforsimin e marrëdhënieve ndërpersonale mes të moshuarve. Këto takime kanë ndihmuar në krijimin e një ambient më pozitive dhe mbështetëse për përfituesit. Në kuadër të aktiviteteve sociale dhe kulturore, qendra ka organizuar edhe festa si Pashkët dhe Bajramin, duke krijuar ambjente festive. Këto aktivitete kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e ndjenjës së përfshirjes sociale, solidaritetit dhe gëzimit mes pjesëmarrësve.

Qendra e zhvillimit P.A.K

Qendra e Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuar Vlorë si një institucion rezidencial i cili funksionon në përputhje me standardet dhe legjislacionin në fuqi për këtë target grup, edhe këtë vit ka organizuar aktivitetin e saj në përputhje me misionin dhe objektivat e vendosura.

Për 4-mujorin e parë për vitin 2026 periudhën Janar-Prill pranë Qendrës së Zhvillimit PAK kanë marrë shërbim 29 rezidentë, 7 prej të cilëve janë në interesim nga familjari dhe pjesa tjetër, prej 22 rezidentësh janë të braktisur me vendim gjykatë. Në organikën e saj Qendra ka një staf prej 44 punonjësish të ndarë në 2 sektorë: Sektori i Administratës dhe Sektori i Shërbimeve. Krahas Qendres

Rezidenciale funksionon dhe Qendra Ditore qe prej Maj te 2025 projekt i krijuar nga UNICEF dhe aktualisht kaluar nën drejtimin e Bashkise Vlore. Në qendrën ditore marrin shërbim ditor 15-fëmijë.

Misioni i kësaj qendre është zbatimi i politikave sociale me synim : Ofrimin e Shërbimeve cilësore, të qëndrueshme dhe në përputhje me standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat me Aftësi të Kufizuara duke qënë gjithnjë në koherencë me legjislacionin në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë së jetës, nxitjen e pavarësisë, përfshirjes dhe respektimit të dinjitetit të rezidentëve, si dhe integrimin e tyre në komunitet në mënyrë sa më të natyrshme, nëse kjo e fundit është e mundur.

Qendra e Zhvillimit për Persona me Aftësi të Kufizuara ka për Objektiv të:

- Rrisë cilësinë e shërbimit që ju ofrohet rezidentëve në drejtim të riaftësimit fizik dhe mendor të këtyre të fundit.
- Nxitjen dhe zbatimin e programeve aktive me qëllim krijimin e një procesi sa më natyral të integrimit të rezidentëve në komunitet.
- Krijimim i netëork-ve efektive me Institucione, Organizata Jofitimprurëse, Subjekte Juridike dhe Private të cilat promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e këtij target-grupi.
- Realizimin e Programeve edukativo-pedagogjike dhe riaftëtimit e personave me aftësi të kufizuara.

Detyrat :

- Ofrimi dhe krijimi i kushteve të favorshme dhe cilësisë për të jetuar dhe mësuar në bazë të programeve të riaftësimit.
- Përpilimi i programeve të edukimit dhe të integrimit në saj të bashkëpunimit të edukatoreve, specialistëve, monitorimi i të cilave bëhet nga Drejtoria.
- Zbatimi i legjislacionit dhe Standarteve.
- Hartimi i programeve për trajnimin dhe formimin e stafit.
- Administron dhe menaxhon buxhetin e caktuar.
- Raporton dhe informon Sh.S.SH dhe Bashkinë Vlorë mbi: statistikat dhe evidencat mujore, të ardhurat, transferimet e klientëve, raporte të realizimit të planeve mujore.
- Mban lidhje korrekte për çdo problem me Bashkinë Vlorë dhe SH.S.SH.

Si Institucion Shtetëror, social dhe rehabilitues pjesë e institucioneve të përkujdesit shoqëror në këtë Qendër ofrohen këto shërbime :

- Në nivel specialisti, të përfaqësuar nga punonjësi social, infermier, specialist logoped dhe fizioterapeut, edukatorët të cilat mbulojnë edhe nivelin edukativ-pedagogjik.
- Në nivel shërbimi, të përfaqësuar nga kuzhinieret, kujdestaret, sanitaret, mirëmbajtësi, magazinieri etj.

Qendra Ditore ka për objektiv:

Qendra Ditore do të qëndrojë e hapur dhe funksionale në orarin 7:30 – 16:30 dhe do të ofrojë të plotë shërbimesh për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara, të cilat përfshijnë: Kujdes për ditën e plotë ose gjysmë dite (pas përfundimit të procesit mësimor); shërbim psikologjik; shërbim

shëndetësor; logopedi; terapi zhvillimi; fizioterapi; aktivitete okupacionale dhe terapi arti. Për të rinj madhor deri në 21 vjeç, do të ofrohen shërbime të specializuara me orë, të përshtatura sipas nevojave të tyre. Shërbime do të ofrohen edhe për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të tilla si: mbështetje psikologjike; sesione informimi për prindërimin pozitiv dhe psikoterapi në grup.

Nisur nga sa më sipër, kategoritë që mbulon ky shërbim janë:

1. Fëmijë me aftësi të kufizuara, në moshë shkollore (6-17 vjeç), të cilët do të marrin shërbime me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme në Qendrën e Kujdesit Ditor. Prindërit do të kenë mundësinë t'i sjellin fëmijët e tyre në Qendër në orën 07:30 të mëngjesit ose pas shkollës, ku ata mund të qëndrojnë deri në orën 16:30.
2. Të rinj me aftësi të kufizuara, të moshës 18-21 vjeç, të cilët do të marrin shërbime të specializuara me orë, të përshtatura sipas nevojave të tyre.
3. Prindërit e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara do të përfitojnë nga shërbime të ofruara në Qendër, si: këshillimi për përmirësimin e kujdesit ndaj fëmijëve, sesione informuese mbi prindërimin pozitiv dhe psikoterapi në grup. Gjatë periudhës së zbatimit të projektit, shërbimet në Qendrën Ditore do të ofrohen për 60 fëmijë dhe të rinj, përkatësisht: 30 fëmijë të moshës 6-17 vjeç do të përfitojnë shërbim për ditën e plotë ose gjysmë dite dhe 30 të rinj të grupmoshës 18-21 vjeç do të përfitojnë shërbime të specializuara sipas nevojës.

Deinstitutionalizimi dhe kthimi në familje i rezidentëve.

Aktualisht në Qendrën tonë marrin shërbim 29 rezidentë, prej të cilëve 21 përfitues janë mbi moshën 21 vjeçare, 15 janë të braktisur me vendim gjykate dhe 7 janë në interesim familjar. Shërbimi Social Shtetëror udhëzon që Qendrat Rezidenciale të ofrojnë kujdes dhe shërbim për rezidentët deri në moshën 21 vjeç, si dhe të kryhen të gjitha procedurat për kthimin në familje të personave me interesim. Konkretisht janë kryer të gjitha kërkesat dhe procedurat ndaj Shërbimit Social Shtetëror dhe Rajonal për sistemimin e këtyre rezidentëve, por situacionet social-ekonomike të familjeve të tyre nuk i plotësojnë kushtet për deinstitutionalizimin e këtyre përfituesve.

Realizimet e objektivave

1. Realizimet në sektorin social dhe pedagogjik

Përsa i përket **Qendres Ditore** këto muaj ka përfunduar me sukses partneriteti mes Qendrës për Drejtësi Gjimore në Shqipëri dhe Bashkisë Vlorë duke kaluar në funksionalitet të plotë të kësaj të

fundit. Pjesë e programit të qendres ditore janë dhe trajnimet e vazhdueshme të stafit. Një prej të cilëve ishte trajnimi me temë “Mbi shërbimet e specializuara dhe kuadrin ligjor në mbështetje të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.” Këto trajnime organizohen me mbështetjen e në bashkëpunim me UNICEF Albania dhe Eorld Vision Albania, në kuadër të projektit EU for Social Care, të financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Qendra Rezidenciale PAK

Në drejtim të këtyre sektorëve qëllimet, objektivat dhe aktivitetet përgjate këtij 4- mujori 2026 kanë qenë të orientuara në lidhje me moshën në rritje të rezidentëve, të vështirësive që ata paraqesin nevojave dhe kërkesave të tyre në lidhje me trajtimin e aftësisë së kufizuar dhe të zhvillimit të tyre në përputhje me kërkesat dhe plotësimin e standarteve të vendosura, pa harruar dorëzimin e evidencave drejt Bashkisë Vlore dhe SHSSH.

Në nivel pedagogjik për këtë vit janë vlerësuar fillimisht nevojat, kërkesat dhe vetë rezidentët brenda institucionit është hartuar një projekt pilot duke organizuar aktivitete okupacioni në bazë të trajnimeve speciale të edukatoreve të orientuara në aktivitete specifike. Që do të thotë se tashmë janë shtuar aktivitete paraprofesionale në mini atelie pune si: *punime me letër dhe plastikë, punime leshi, pikturë, aplikacione-prodhim pikturë të ndryshme.*

Aktivitet në Qendër janë zhvilluar normalisht, madje këtë vit mund të përmendim se ka patur një rritje në nivelin e organizimit të aktiviteteve në bashkëpunim dhe me fëmijët e Qendres Ditore.

Rezidentët përfshihen në këto aktivitete në mënyrën që mundën . Këto aktivitete zhvillohen paralelisht me programet individuale të zhvillimit për gjithë secilin nga rezidentët.

Theksojmë se të gjitha aktivitetet janë realizuar në mbështetje të plote të edukatoreve specialiste të cilët organizojnë punën në baze të prirjeve të secilit rezident.

Realizimi i objektivave pedagogjike

- Plotësimi i fishave të vlerësimit të AK, për të përcaktuar nevojat dhe prioritetet e ndërhyrjes.
- Hartimi, plotësimi i planeve individuale të zhvillimit.
- Rishikimi dhe rivlerësimi i nevojave të rezidentëve përsa i përket moshës dhe tipologjisë së vështirësisë që ata paraqesin, duke i orientuar aktivitetet në ato paraprofesionale.
- Hapja e 2 mini- atelieve të punës, e hekurosjes dhe e krijimtarisë me materiale të ndryshme sipas specifikave të rezidentëve.

2. Ecuria shëndetësore e përfituesve.

Përsa i përket gjendjes shëndetësore të rasteve, aktualisht janë 19 përfitues me mjekim ditor për shkak të çrregullimeve psikiatrike apo neurologjike. Mjekimi është i udhëzuar dhe dokumentuar nga mjeku specialist dhe menaxhohet nga infermieri i institucionit. Janë realizuar të gjitha ekzaminimet e udhëzuara nga mjeku. Ndryshim këtë 4-mujor, Janar-Maj 2026 ka qenë rritja e dozës së medikamenteve për një pjesë të rezidentëve në bazë të analizave të normës së depamkinemisë.

Ushqimi është korrekt në lidhje me kuotën ushqimore të përcaktuar për secilin rezident dhe mund të vlerësohet një menu brenda parametrave normal përsa i përket kalorive duke përfshirë aty edhe moshën dhe dietën e rezidentëve.

Gjendja shëndetësore e rezidentëve ka qenë relativisht e mirë, duke patur parasysh këtu kategorinë e personave, problemet dhe vështirësitë që ata kanë. Në periudha të ndryshme të vitit janë shfaqur viroza të cilat janë trajtuar si në individ, po ashtu edhe kur rastet kanë qenë kolektive. Gatishmëria dhe dispozicioni i mjekëve ka qenë shumë i kënaqshëm dhe korrekt.

Është bërë në mënyrë korrekte vaksinimi i rezidentëve sipas kalendarit të vaksinimit, si dhe kontrollet rutine përsa i përket planifikimit nga ana e infermieres në lidhje me kontaktimin me mjekët përkatës.

KLUBI SHUMËSPORTËSH FLAMURTARI

Përgjatë kësaj periudhe kanë vazhduar aktivitetet zyrtare në Pallatin e Sportit Flamurtari dhe puna për përfaqsimin sa më të denjë të Klubit dhe Bashkisë Vlorë dhe për arritjen e objektivit të përbashkët të masivizimit të sporteve dhe përfshirjen e sa më shumë të rinjve në to.

- Ekipi Femrave në Basketboll të rritura ka fituar, Kupën e Republikës në Shkurt 2026, u rendit në vend të katërt në Kampionatin e Ligës Unike dhe pretendet për të fituar Kampionatin Kombëtar Shqiptar.
- Ekipi i Basketbollit meshkuj të rritur në sezonin 2025-2026 përfaqëson klubin në Superligë ku sipas klasifikimit renditen në vendin e pestë.
- Ekipet zinxhir të basketbollit U18, U16 për femra dhe U18, U16 për meshkuj janë pjesë e Kampionatit Kombëtar për moshën, dhe kanë furnizuar ekipet e të rriturve me lojtarë.
- Ekipi Volejbollit Femra në kampionatin e sezonit 2025-2026 ka marrë vendin e tretë në Kampionatin Kombëtar dhe vendin e pestë në Kupën e Shqipërisë për Kategorinë e parë. Në sezonin 2025-2026, kanë një paraqitje të mirë dhe falë aktivizimit të lojtarëve të huaja në skuadër.
- Ekipi i Volejbollit femra U18 vazhdon stërvitjen.
 - Ekipi i Minifutbollit (Futsal) është në periudhë kampionati.
 - Ekipi i Kickbox vazhdon stërvitjen.
 - Ekipi i Mundjes vazhdon stërvitjen.
 - Sportistët e ekipit të Boksit vazhdon stërvitjen.

- Në disiplinën e atletikës vazhdon stërvitjen.
- Ekipi i Ciklizimit vazhdon stërvitjen.
- Ekipi i Karatesë vazhdon stërvitjen.
- Ekipi i Ping Pongut vazhdon stërvitjen.
- Ekipi i Peshëngritjes nëpërmjet sportistes Enkileda Carja mori vendin e parë në Kampionin Kombëtar.
- Ekipi i Qitjes nëpërmjet sportistes Doela Cela mori vendin e tretë në Kupën e Pavarësisë së Kosovës.
- Ekipi i Taekwondo mori vendin e parë në Kampionatin Kombëtar.
- Ekipi i Bilardos vazhdon stërvitjen.
- Ekipi i Shahut vazhdon stërvitjen.
- Ekipi i Futbollit për femra vazhdon stërvitjen.
- Ekipi i Notit vazhdon stërvitjen.
- Ekipi i Tenisit vazhdon stërvitjen.

Projekti	Plani vjetor	Fakt 01.01.2026-30.04.2026
Ekipi basketbollit meshkuj te rritur	5,000,000	1,734,000
Ekipi basketboll meshkuj te rinje	500,000	145,000
Ekipi basketbollit femra te rritura	9,500,000	4,696,000
Ekipi basketbollit femra te reja	800,000	368,125
Ekipi I volejbollit femra te rritura	3,000,000	1,983,000
Ekipi I volejbollit femra te reja	800,000	280,125
Ekipi I volejbollit meshkuj te rinje	300,000	0
Ekipi I boksit	5,000,000	1,600,000
Ekipi I ciklizmit	1,200,000	406,000
Ekipi I mundjes	1,800,000	385,500
Ekipi I Ping Pong	500,000	236,000
Ekipi I peshengritjes	800,000	365,250
Ekipi I karatese	500,000	155,250
Ekipi I minifutbollit	4,000,000	2,058,000
Ekipi I qitjes	1,300,000	275,500
Ekipi I taekwondo	500,000	189,000
Ekipi I bilardos	800,000	229,000
Ekipi I atletikes	600,000	110,625
Ekipi I shahut	500,000	112,500
Ekipi I kickbox	2,000,000	268,000
Ekipi I Muaythai	2,000,000	700,000
Ekipi futboll femra	300,000	75,000

Ekipi I notit	800,000	73,125
Ekipi I tenisit	300,000	75,000
Energji elektrike	500,000	131,821
Ujë	250,000	36,551
Telefoni+ Sherbim interneti	80,000	8,800
Shpenzime per materiale promocionale	200,000	0
Shpenzime per publicitet ne media	100,000	0
Shpenzime per aktivitete sportive	100,000	0
Shpenzime per mirembajtjen e koshave te basketbollit	100,000	0
Shperblime per ekipe dhe individ kampion	1,500,000	619,000
Grumbullim te ekipeve per trofe	1,000,000	0
Federime+ Gjyqtari sportive	5,500,000	4,743,500
Shpenzime te paparashikuara	200,000	0
Shpenzime per uniforma sportive	1,000,000	0
Udhetime dhe dieta personeli	200,000	9,000
Shpenzime per materiale kancelarike	100,000	0
Shpenzime per materiale pastrimi	100,000	0
Shpenzime per bojera printeri	100,000	0
Shpenzime per materiale hidraulike	100,000	0
Shpenzime per materiale elektrike	100,000	0
Shpenzime per bojera dhe lyerje ambientesh	100,000	0
Shpenzime per perde	100,000	0
Materiale per mirembajtje dhe riparime	100,000	0
Shpenzime per dezinfektim ambientesh	100,000	0
Shpenzime per mirembajtje rrjeti dhe kompjuterash, fotokopje	100,000	0
Shpenzime per materiale funksionim paisje zyre	100,000	0
Blerje topa per ekipet	120,000	0
Blerje materiale sportive per ekipin e boksit	100,000	0
Blerje materiale sportive per ekipin e peshengritje	100,000	0
Blerje materiale sportive per ekipin e qitjes	100,000	0
Sigurimi I lojtareve	600,000	0
Shpenzime bileta udhetimi per transferimin e lojtareve te huaj	1,000,000	109,270

DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Përmbledhje Ekzekutive

Njësia e Auditimit të Brendshëm, ushtron veprimtarinë e saj bazuar në Ligjin Nr.114 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm ne sektorin publik”, i ndryshuar, Urdhërin e Ministrit të Financave nr.

100, dt. 25.10.2016 “Per miratimin e manualit te auditimit te brendshem ne sektorin publik”, i ndryshuar, Kodin e Etikës dhe Kartës së Auditimit të Brendshëm Publik, Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar. Njësia e Auditimit të Brendshëm është organizuar në nivel sektori me strukturë 1 përgjegjës dhe 2 inspektorë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm për vitin 2025 ka planifikuar 8 auditime për evadim.

Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Vlorë është të japë siguri objektive dhe të pavarur si dhe shërbime konsulence, i krijuar që të shtojë vlerën dhe të përmirësojë funksionimin e Institucionit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ndihmon Institucionin të përmbushë objektivat e veta duke ofruar një trajtim sistematik dhe të disiplinuar, për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të proceseve të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes në drejtoritë dhe njësitë e varësisë.

Analiza e misioneve të auditimit për periudhën 01.01.2026 deri në 30.04.2026

Veprimtaria audituese është bazuar në vlerësimin e përshtatshmerisë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit duke u fokusuar kryesisht në:

- Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike
- Përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin regullator
- Besueshmerinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional
- Kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet
- Dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

Duke u bazuar në programin vjetor të auditimit të ndryshuar dhe planin strategjik për këtë periudhë janë audituar:

1. Zbatimin e rekomandimeve të lëna
2. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike(perfundimi i eraportit dhe evadimi i dosjes)
3. Ndermarrja e pastrimit
4. Ndermarrja e gjelberimit (në procese evadimi)

Në ushtrimin e funksionit të tyre, strukturat e auditimit, kanë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, dhe ka punuar për përmirësimin e tyre. Rekomandimet janë pranuar nga titullaret e insitucioneve dhe janë percaktuar dhe afatet e realizimit të tyre.

Për 3 auditimet e kryera për këtë periudhë janë lënë gjithësej 19 rekomandime

Gjetjet e konstatuara nga strukturat e auditimit të me baze sistemi paraqiten si më poshtë:

- | | |
|---|---|
| • Sistemi i kontabilitetit dhe rap.financiar | 8 |
| • Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit | 2 |
| • Sistemi i pagave dhe oreve jashte orarit | 3 |
| • Sipas qëllimit të institucionit | 1 |
| • Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve | 5 |

Auditimi ne Ndermarrjen e gjelberimi (në proces evadimi)


IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

➤ *Përmbledhje e gjetjeve kryesore sipas fushave/proceseve të audituara*

Nga auditimet e kryera janë lënë gjithësej **36** rekomadime të cilat janë pranuar nga subjektet e audituara.

Gjetjet e konstatuara nga strukturat e auditimit të me baze sistemi paraqiten si më poshtë:

- Sistemi i kontabilitetit dhe rap.financiar 6
- Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit 6
- Sistemi i planifikimit dhe buxhetimit 2
- Sipas qëllimit të institucionit 4
- Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve 14
- Sistemi i të ardhurave dhe shpenzimeve 1
- Sitemi I pagave 3



➤ **Rekomandimet e dhëna**

Përmbledhja e gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna për çdo subjekt të audituar si më poshtë:

Qendra e Zhvillimit të Personave me Aftësi të Kufizuar (janë lënë gjithësej 5 rekomandime)

1.Titulli i gjetjes: Mosdeklarimi i konfliktit të interesit nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël

Rekomandimi: Antarët e komisionit me vlerë të vogël të deklarojnë mbi gjendjen e konfliktit të interesit gjatë procedurave të prokurimeve duke nënshkruar deklaratat përkatëse.

2.Titulli i gjetjes: Mungesa e dokumentimit të mënyrës së përlllogaritjes së fondit limit

Rekomandimi: Autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhërit të prokurimit duhet të argumentojë dhe dokumentojë mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit bazuar në specifikimet teknike /termat e references të objektit që prokurohet.

3.Titulli i gjetjes: Parashikimi i copëzuar i fondeve në buxhet për të shmugur procedurat e blerjeve të vogla në Sistemin e Prokurimit Elektronik

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të parashikojë dhe grupojë në buxhetin e vetë fondet e zërave të investimeve duke u nisur nga ngjashmëria dhe funksionaliteti i tyre.

4.Titulli i gjetjes: Moszbatimi i bazës ligjore për protokollimin e dokumentave që hyjnë në Institucion.

Rekomandimi: Autoriteti kontraktor të protokollojë dokumentat e dorëzuara nga operatorët fitues në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në ftesat për ofertë.

5.Titulli i gjetjes: Moszbatimi i bazës ligjore lidhur me procesin e refuzimit të ofertave

Rekomandimi: Komisioni i blerje të vogla të sigurohet se janë refuzuar ofertat e opertoreve ekonomik, të cilët nuk janë paraqitur pranë Autoirtetit Kontraktor brenda afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë në procedurat e mëparshme

Drejtoria e Projekteve te Huaja , Integritit Evropian dhe Diaspores (janë lënë gjithësej 3 rekomandime)

1.Titulli i gjetjes: Rregullore e paazhornuar me strukturën e re të drejtorisë

Rekomandimi: Të rishikohen propozimet për hartimin e draft rregullores së Drejtorisë së Projekteve te Huaja, Integritit Evropian dhe Diasporës në përshtatje me ndryshimet strukturore të drejtorisë duke përfshirë edhe diasporën si pjesë integrale të saj

2.Titulli i gjetjes: Mos përfshirja në buxhetet shtesë apo edhe në buxhetin e vitit 2025 të fondeve të projektit “Qendra shumëfunktionale për femijët dhe të rinjtë e Minoritetit Rom dhe Egjiptian”.

Rekomandimi: Nëpërmjet një shkrese ti kërkohet Drejtorisë së Finance Buxhetit dhe Kontabilitetit që të përfshihen në Buxhetin e Bashkisë fondet nga projektet e huaja.

3.Titulli i gjetjes: Mungesa e një plani vendor për integrimin evropian

Rekomandimi: Drejtoria e Projekteve te Huaja, Integritit Evropian dhe Diasporës në bashkëpunim me struktura të tjera të Bashkisë të hartojë një draft plan për integrimin evropian në nivel vendor të

harmonizuar me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian dhe me pas ta miratojë në Këshillin Bashkiak.

Klubi Shumësportesh Flamurtari (janë lënë gjithësej 13 rekomandime)

1.Titulli i gjetjes: Nuk është realizuar plani i të ardhurave të planifikuara për qera salle dhe ambienteve për vitin 2024.

Rekomandimi: Duke u nisur nga niveli i ulët i të ardhurave të merren masa nga ana e drejtuesit të Klubit Shumësportësh “Flamurtari” për një menaxhim sa më të mirë të ambienteve salla, palestra dhe ambiente të tjera të brendshme.

2.Titulli i gjetjes: Mungesa e argumentimit dhe e dokumentimit të kriterëve të veçanta për kualifikim.

Rekomandimi: Komisioni i blerjeve të vogla të argumentojë kriteret e veçanta të kualifikimit për mallra/sherbime, objekt prokurimi si dhe ta dokumentojë këtë proces në një procesverbal të posaçëm.

3.Titulli i gjetjes: Mungesa e dokumentimit të mënyrës së përlogaritjes së fondit limit

Rekomandimi: Drejtori përpara se të nxjerr urdhrin e prokurimit duhet të sigurohet se është dokumentuar mënyra e përlogaritjes së fondit limit bazuar në specifikimet teknike/termat e referencës të objektit që prokurohet nga komisioni i blerjeve të vogla.

4.Titulli i gjetjes: Copëzimi i fondeve të buxhetit për të shmangur procedurat e blerjeve të vogla në Sistemin e Prokurimit Elektronik

Rekomandim: Autoriteti kontraktor të sigurohet se vlerat e parshikuara në buxhet për procedurat e blerjeve të vogla të mos ndahen apo copëzohen për të shmangur procedurat në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

5.Titulli i gjetjes: Mosrespektimi i kërkesave ligjore për ndryshimin e regjistrimit të parashikimit të prokurimeve

Rekomandim: Autoriteti Kontraktor të reflektojë ndryshimet në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik sa herë që ka ndryshim të destinacionit të fondeve buxhetore që lidhen me prokurimet publike.

6.Titulli i gjetjes: Moszbatimi i bazës ligjore për protokollimin e dokumentave që hyjnë në Institucion.

Rekomandim: Të rishikohet dhe të përditesohet struktura organizative e Klubit Shumësportesh “Flamurtari” në mënyrë që të reflektojë realitetin sipas nivelit arsimor të punonjësve.

7.Titulli i gjetjes: Mosperputhje në strukturë pagës së grupit të dy punonjësve me nivelin arsimor të pasqyruar në dokumentacionin e tyre.

Rekomandim: Të rishikohet dhe të përditesohet struktura organizative e Klubit Shumësportësh në mënyrë që të reflektojë realitetin sipas nivelit arsimor të punonjësve.

Rekomandim Financieri të sigurohet dhe të zbatojë saktë strukturën e miratuar për pozicionin (Roje+Mirembajtes).

9.Titulli i gjetjes: Nuk ishte ngritur komisioni për marrjen në dorezim të aktiveve të furnizuara

Rekomandim: Nga nëpunësi Autorizues të ngrihet komisioni për marrjen në dorezim të aktiveve të furnizuara.

10.Titulli i gjetjes:Mungesa e regjistrit kontabël të aktiveve.

Rekomandim: Përgjegjësi i financës me cilësinë e nëpunësit zbatues të krijojë dhe të përditësojë regjistrin kontabël të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Klubi Shumesportesh “Flamurtari”.

11.Titulli i gjetjes: Mosrespektimi i kërkesave ligjore lidhur me procesin e inventarizimit

Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të sigurohen se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të Institucionit është realizuar.

12.Titulli i gjetjes: Mosrespektimi i kërkesave ligjore lidhur me mbajtjen e kontabilitetit

Rekomandim: Nëpunësi zbatues të sigurohet që procedurat e mbajtjes së kontabilitetit të jenë të sakta, të plota dhe efektive.

13. Titulli i gjetjes: Evidentimi i detyrimeve të prapambetura dhe marrja e masave për shlyerjen e tyre sipas parimit FIFO.

Rekomandim:Nëpunësi zbatues të evidentojë në një regjister të veçantë detyrimet e prapambetura dhe të hartojë një plan të posaçëm për shlyerjen e tyre duke parashikuar në buxhet një fond të dedikuar.

Qendra Kulturore e Fëmijëve (janë lënë gjithësej 7 rekomandime)

1.Titulli i gjetjes: Mungesa e një rregulloreje të brendshme lidhur me funksionimin, organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të Qendrës Kulturore të Fëmijëve.

Rekomandim: Drejtori i Qendrës Kulturore të Fëmijëve të sigurohet se është hartuar draft rregullorja e brendshme në përputhje me bazën ligjore, strukturën dhe objektivat e Institucionit dhe ta miratojë të Kryetari i Bashkisë.

2.Titulli i gjetjes: Mungesa e një rregulloreje të brendshme lidhur me zbatimin e projekteve dhe aktivitetëve kulturore në Bashkinë Vlorë

Rekomandim: Të hartohet një rregullore e brendshme ku të përcaktohen saktë dhe mbi baza ligjore të gjitha hapat që duhet të ndiqen për të realizuar një projekt apo aktivitet kulturor në Bashkinë Vlorë, në mënyrë efikente dhe transparente.

3.Titulli i gjetjes: Mungesa e strukturës organizative të QKF-së.

Rekomandim: Të përgatitet dhe të miratohet struktura e QKF-së ku të përcaktohen qartë pozicionet dhe detyrat e secilit punonjës, në përputhje me bazën ligjore.

4.Titulli i gjetjes: Kontratat e punonjësve të QKF-së nuk përmbajnë të gjithë elementët ligjore.

Rekomandim: Kontratat e Qendrës Kulturore të Fëmijëve të lidhen me të gjitha elementet e detyrueshme në përputhje me Kodin e punës dhe VKM-në nr.425d atë 26.06.2024 “Per trajtimin me page dhe shtesa mbi page të punonjësve mësimorë dhe të punonjesve të tjerë jomësimorë”

5. Titulli i gjetjes: Mosperputhje e grupit të diplomës së punonjesit me kërkesat e VKM-së Nr.425 date 26.06.2024 “Per trajtimin me page dhe shtesa mbi page të punonjesve mësimorë dhe te punonjesve të tjerë jomesimorë.

Rekomandim: Të rishikohen klasifikimet e punonjesve për të siguruar perputhjen e grupit të diplomës me pozicionin sipas VKM-së.

6. Titulli i gjetjes: Mosregjistrimi i godinës dhe truallit (toka) të Qendrës Kulturore të Femijëve ne regjistrin e asetve të Bashkisë Vlorë.

Rekomandim: Të vlerësohen dhe të rregjistrohen në regjistrin e asetëve të Bashkisë godina dhe trualli (toka) i Qendrës Kulturore të Fëmijëve.

7. Titulli i gjetjes: Mospasqyimi në inventare i pajisjeve të dhuruara për Qendrën Kulturore të Fëmijëve.

Rekomandim: Pasqyrimi i pajisjeve të dhuruara (çertifikatë dhurimi datë 26.01.2018 nga World Vision Albania) për Qendrën Kulturore të Fëmijëve në inventarët e këtij Institucioni.

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (8 rekomandime)

1. Titulli i gjetjes: Mungesa e dokumentimit te procesit të marrjes së ofertave (çmimeve) të përdorura në përlllogaritjen e fondit limit

Rekomandim: Te dokumentohen me nje procesverbal treguesit e çmimeve ne rastet e perlllogaritjes se fondit limit me metoden e testimit te tregut.

2. Titulli i gjetjes: Dosjet e prokurimeve me vlerë të vogël të vitit 2024 të paarkivuara

Rekomandim: Të arkivohen dosjet e procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël pranë zyrës së arkivës së Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

3. Titulli i gjetjes: Mosrespektimi i kerkesave ligjore lidhur me hartimin e regjistrit te parashikimeve te procedurave te prokurimit me vlere te vogel

Rekomandim: Autoriteti kontraktor te sigurohet se regjistri i parashikimeve te procedurave te prokurimit publik per blerjet e vogla te jete hartuar sipas formatit standard.

4. Titulli i gjetjes: Mosrespektimi i kerkesave ligjore lidhur me hartimin e regjistrit te parashikimeve te procedurave te prokurimit me vlere te vogel

Rekomandim: Te rishikohet dhe te perditesohet struktura organizative e Ndermarrjes se Sherbimeve Publike ne menyre qe te reflektoje realitetin sipas nivelit arsimor te punonjesve.

5. Titulli i gjetjes: Ne Ndermarrjen e Sherbimeve Publike nuk ka te hartuar nje Rregullore

Rekomandim: Te hartohet rregullorja e brendshme e Ndermarrjes se Sherbimeve Publike dhe te miratohet te Kryetari i Bashkise.

6.Titulli i gjetjes: Mungesa e urdhrave te punes per oret jashte orarit normal

Rekomandim: Ne Ndermarrjen e Sherbimeve Publike punonjesit e sherbimevekane punuar me ore jashte orarit por kane munguar urdhrat ditore te formalizuar.

7.Titulli i gjetjes: Mospagese e shteses 25% per oret shtese.

Rekomandim: Specialisti i pagave dhe pergjegjesja e finances te sigurohen qe shtesat e pages per oret jashte kohes normale te punes te jene perlllogaritur sakte.

8.Titulli i gjetjes: Moskompesim i oreve jashte orarit me dite pushimi

Rekomandim: Punet jashte orarit te kompesohen me dite pushimi zevendesuese ose pagese sipas ligjit per te balancuar koston dhe mireqenien e punonjesve si dhe te krijohet nje grafik ku te percaktohen oret e punes dhe te behet alternimi i punonjesve

➤ **Prioritet i rekomandimeve (i lartë, i mesëm, i ulët)**

Nga auditimet e kryera janë lënë gjithësej **28** rekomadime të cilat janë pranuar nga subjektet e audituara. Tabela me poshtë tregon numrin e rekoamdimeve të lëna për çdo subjekt te audituar dhe prioriteti i rekomandimit;

Subjekti i audituar	Nr.rek të lëna	Prioritet i lartë	Prioritet mesëm	Prioritet i ulët
Klubi Shumësportësh “Flamurtari”	13	6	6	1
Qendra e Zhvillimit “PAK”	5	3	2	
Drejtoria Integrimit European , Investimeve të Huaja dhe Diasporës.	3	2	1	
Qendra e Kulturore e Fëmijeve	7	6	1	
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	8		7	1
Zbatimi i rekomanimeve të lëna				

(Teatri “Petro Marko”)

1. Kerkesat per leje te zakonshme te behen me shkrim nga ana e punonjesve dhe te konfirmohen nga drejtori i institucionit.

Drejtori i Teatrit”Petro Marko” ,menjehere

2.Drejtori dhe financierja te sigurohen per planifikimin ne buxhet te oreve shtese ne fondin

e pagave dhe me pas te trajtohen financiarisht me ore shtese punonjesit e Institucionit.

Drejtori dhe financierja e Teatrit “Petro Marko”,ne vazhdimesi

3.Te rishikohen oret shtese duke u siguruar qe eshte respektuar Kodi i Punes Nr.7961 date 12.07.1995 i ndryshuar me Ligjin Nr.136/2015 ,neni 35 pika 2.

Drejtori dhe financierja e Teatrit “Petro Marko”,menjehere

4.Financierja te ndermarr veprimet e nevojshme korrigjuese per llogarine 327 ,te cilat te reflektohen ne bilancin e vitit 2019.

(Teatri “Petro Marko”)

1. Kerkesat per leje te zakonshme te behen me shkrim nga ana e punonjesve dhe te konfirmohen nga drejtori i institucionit.

Drejtori i Teatrit”Petro Marko” ,menjehere

2.Drejtori dhe financierja te sigurohen per planifikimin ne buxhet te oreve shtese ne fondin e pagave dhe me pas te trajtohen financiarisht me ore shtese punonjesit e Institucionit.

Drejtori dhe financierja e Teatrit “Petro Marko”,ne vazhdimesi

3.Te rishikohen oret shtese duke u siguruar qe eshte respektuar Kodi i Punes Nr.7961 date 12.07.1995 i ndryshuar me Ligjin Nr.136/2015 ,neni 35 pika 2.

Drejtori dhe financierja e Teatrit “Petro Marko”,menjehere

4.Financierja te ndermarr veprimet e nevojshme korrigjuese per llogarine 327 ,te cilat te reflektohen ne bilancin e vitit 2019.

➤ Ecuria e ndjekjes se rekomandimeve

Subjekti i audituar	Nr.rek të lëna	Të pranuar	Të papranuar	Pjesërisht pranuar
Klubi Shumësportësh “Flamurtari”	13	13	0	0
Qendra e Zhvillimit “PAK”	5	5	0	0
Drejtoria Integritimit European , Investimeve të Huaja dhe Diasporës.	3	3	0	0
Qendra e Kulturore e Fëmijeve	7	7	0	0
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	8	8	0	0

Zbatimi i rekomanimeve të lëna				
--------------------------------	--	--	--	--

(Teatri “Petro Marko”)

1. Kerkesat per leje te zakonshme te behen me shkrim nga ana e punonjesve dhe te konfirmohen nga drejtori i institucionit.

Drejtori i Teatrit”Petro Marko” ,menjehere

2.Drejtori dhe financierja te sigurohen per planifikimin ne buxhet te oreve shtese ne fondin e pagave dhe me pas te trajtohen financiarisht me ore shtese punonjesit e Institucionit.

Drejtori dhe financierja e Teatrit “Petro Marko”,ne vazhdimesi

3.Te rishikohen oret shtese duke u siguruar qe eshte respektuar Kodi i Punes Nr.7961 date 12.07.1995 i ndryshuar me Ligjin Nr.136/2015 ,neni 35 pika 2.

Drejtori dhe financierja e Teatrit “Petro Marko”,menjehere

4.Financierja te ndermarr veprimet e nevojshme korrigjuese per llogarine 327 ,te cilat te reflektohen ne bilancin e vitit 2019.

(Teatri “Petro Marko”)

1. Kerkesat per leje te zakonshme te behen me shkrim nga ana e punonjesve dhe te konfirmohen nga drejtori i institucionit.

Drejtori i Teatrit”Petro Marko” ,menjehere

2.Drejtori dhe financierja te sigurohen per planifikimin ne buxhet te oreve shtese ne fondin e pagave dhe me pas te trajtohen financiarisht me ore shtese punonjesit e Institucionit.

Drejtori dhe financierja e Teatrit “Petro Marko”,ne vazhdimesi

3.Te rishikohen oret shtese duke u siguruar qe eshte respektuar Kodi i Punes Nr.7961 date 12.07.1995 i ndryshuar me Ligjin Nr.136/2015 ,neni 35 pika 2.

Drejtori dhe financierja e Teatrit “Petro Marko”,menjehere

4.Financierja te ndermarr veprimet e nevojshme korrigjuese per llogarine 327 ,te cilat te reflektohen ne bilancin e vitit 2019.

VLERËSIMI I SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMIT TË RISKUT

Bazuar në auditimet e realizuara gjatë periudhës raportuese, si dhe në analizën e dokumentacionit dhe proceseve të zbatuara nga strukturat e Bashkisë dhe njësitë e saj vartëse, vlerësohet se sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon në mënyrë mesatare, duke ofruar një nivel të pranueshëm sigurie për arritjen e objektivave të institucionit, por paraqet ende mangësi që kërkojnë përmirësim.

Kontrollet e brendshme janë të vendosura formalisht, por në disa raste ato nuk zbatohen në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive. Janë evidentuar dobësi kryesisht në drejtim të mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut dhe monitorimit të vazhdueshëm të aktiviteteve, çka ndikon në rritjen e rrezikut për mosrespektim të kuadrit ligjor dhe përdorim joeficient të burimeve publike.

Megjithatë, drejtuesit e njërive kanë treguar gatishmëri për adresimin e problematikave të konstatuara dhe janë ndërmarrë masa për përmirësimin e proceseve të kontrollit të brendshëm. Zbatimi i plotë dhe në kohë i rekomandimeve të lëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm vlerësohet si element kyç për forcimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashki.

Në përfundim, sistemi i kontrollit të brendshëm në Bashki kërkon përmirësime të mëtejshme për të garantuar një administrim më efektiv, transparent dhe në përputhje me parimet e ligjshmërisë, eficiencës dhe përgjegjshmërisë.

- *Mjedisi i kontrollit*

Mjedisi i kontrollit është i ndërtuar mbi kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe mbështetet nga struktura organizative e miratuar. Megjithatë, kërkohet forcim i mëtejshëm i përgjegjshmërisë menaxheriale, rritje e ndërgjegjësimit për rolin e kontrollit të brendshëm dhe përmirësim i ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi në disa struktura.

- *Menaxhimi i riskut*

Procesi i menaxhimit të riskut është i vendosur në mënyrë formale, por nuk zbatohet në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme nga të gjitha strukturat. Nevojitet përmirësim në identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e risqeve, si dhe integrimi i tyre në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes.

- *Aktivitetet e kontrollit*

Aktivitetet e kontrollit janë të përcaktuara përmes procedurave të brendshme dhe, në përgjithësi, zbatohen. Megjithatë, janë konstatuar raste ku kontrollet nuk janë të dokumentuara mjaftueshëm ose nuk zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme, çka kërkon forcim të disiplinës procedurale.

- *Informacioni dhe komunikimi*

Sistemi i informacionit dhe komunikimit funksionon dhe siguron raportimin bazë për nevojat menaxheriale, por ka nevojë për përmirësim në drejtim të cilësisë, saktësisë dhe afateve të raportimit, në mënyrë që informacioni të shërbejë më efektivisht për monitorim dhe vendimmarrje.

- *Monitorimi*

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm realizohet, por jo gjithmonë në mënyrë të plotë dhe të dokumentuar. Nevojitet forcim i mekanizmave të vetëvlerësimit dhe ndjekjes së zbatimit të masave korrigjuese dhe rekomandimeve të auditimit.

Në përfundim, sistemi i kontrollit të brendshëm në Bashki vlerësohet si i kënaqshëm, por kërkon përmirësime të vazhdueshme për të garantuar funksionim më efektiv, rritje të transparencës dhe përdorim më të mirë të burimeve publike.

Dhënie opinionit mbi vlerësimin e kontrollit të brendshëm

Njësia e Auditimit, për dhënien e një opinionit të përgjithshëm mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të marrë në konsideratë strategjitë, objektivat dhe risqet e njësisë publike, si dhe pritshmëritë e menaxhimit të lartë.

Sistemi i kontrollit të brendshëm në Bashki vlerësohet si i kënaqshëm, por kërkon përmirësime të vazhdueshme për të garantuar funksionim më efektiv, rritje të transparencës dhe përdorim më të mirë të burimeve publike.

TEATRI “PETRO MARKO”

Duke u nisur nga qëllimi kryesor i punës për Teatrin “Petro Marko”, pasurimin e jetës artistike e kulturore në qytetin e Vlorës, ju paraqesim aktivitetin e këtij Institucioni për periudhën Janar – Prill 2026 si më poshtë:

JANAR 2026

1. Koncert nga Global Dance Art Academy “Dance show 2026”. Koncert i cili pati pjesëmarrje masive sidomos të të rinjve, i mbajtur në 06 Janar 2026 .
2. Reprizë komedia e zezë “Metoda Gronholm”, një shfaqje nga një kast aktorësh të mirënjohur si Luli Bitri, Dritan Borici, Viktor Zhusti dhe Artan Islami i mbajtur në datat 16-17 Janar 2026, ora 19:00 .Një bashkëproduksion i mundësuar nga Bashkia Vlorë, Tiranë dhe Fier me një kast aktorësh të zgjedhur nga Teatri “Petro Marko”,Teatri Bylis dhe Teatri Kombëtar.
3. Reprizë “Halli,Halli nuk i ngjan”. U zhvillua në datat 23, 24, 25 Janar 2026 ,ora 19:00. Aktorët, këngëtarët e trupës së varietesë, me pjesëmarrjen e parodistëve të njohur vlonjatë Afrim Agalliu dhe Agron Hamo. Humori, ritmet muzikore të këngëtarëve dhe kërcimit modern, si dhe magjia e prestigjatorit të njohur vlonjat Edmond Murraj si dhe aktorë dhe këngëtarë të rinj dhanë shfaqjen 3 netë në skenën e Teatrit “Petro Marko”.
4. Artistët e T.K.O.B “Valsi i Luleve” në bashkëpunim me Teatri “Petro Marko”nga cikli i spektakleve “Fundjava Vlonjate” solli tek publiku vlonjat, fragmente koreografike që paraqesin udhëtimin estetik të baletit klasik drejt gjuhës bashkëkohore të lëvizjes. Artistët e T.K.O.B u ngjiten në skenën e Teatrit “Petro Marko” për të dhuruar një mbrëmje të shkëlqyer, ku baleti komunikoi me elegancë, me gjuhë skenike që do të mbetet gjatë në kujtesë - 29 Janar 2026.
5. Forumi i dialogut “Edhe disa hapa drejt BE”, organizuar në Vlorë nga ambasadori i Shqipërisë në Austri, z. Fate Velaj me pjesëmarrjen e reporterit për Shqipërinë në Parlamentin

European, z. Andreas Schieder, Ambasadorin e Francës në Shqipëri znj. Catherine Suard dhe Ambasadorin e Spanjës në vendin tonë, z. Gabriel Ventura. Pati pjesëmarrje nga personalitete dhe u mbajt në një ditë në 31 janar 2026, ora 11:00-15:00.

- Për muajin Janar 8 shfaqje.

SHKURT 2026

6. "O sa mire me qenë shqiptar" nga Edi Oga me një humor, batutë duartrokitje të qeshura pati nga salla e teatrit "Petro Marko", i mbajtur më 13 Shkurt, ora 19:00.
7. Premirerë "Bidermani dhe Zjarrvënësit" me regji të Eliona Thomaraj, e luajtur nga trupa e aktorëve Astit Mamaj, Margent Caushi, Ermir Hoxhaj, Igli Fusha, Roland Minga, Loris Sinanaj, Matilda Avduli, Ludmilla Baballeku, Alba Shtembari dhe Ilirian Ali. Shfaqja u shfaq me shumë sukses në data 21/22/23 Shkurt 2026, ora 19:00.
8. Shfaqja "Lu Santo Jullare Francesco" "Shenjti Gaztor Franësku" nga Mario Pirovano në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë dhe Konsullatën e Përgjithshme Italiane në Vlorë, mbajtur në 26 shkurt 2026, ora 19:00.
9. Reprizë "Bidermani dhe Zjarrevensit" sjellën 2 netë në dt. 28 Shkurt dhe 1 Mars në skenën e Teatrit "Petro Marko".

- Për muajin Shkurt 7 shfaqje.

MARS 2026

10. Koncert Shkolla e Muzikës "Naim Frashëri" "Gëzuar 7-8 Marsin" në bashkëpunim me Teatrin "Petro Marko". Pati pjesëmarrje të lartë dhe u shoqërua me duartrokitje të shumta, i mbajtur në 05 Mars 2026 ora 19:00.
11. 7 Marsi - Ceremonia e Vlerësimit të mësuesëve nga Bashkia Vlorë.
12. Shfaqja "L'Elisir d'amore" nga artistët e T.K.O.B në bashkëpunim me Teatrin "Petro Marko" nga cikli i spektakleve "Fundjava Vlonjate" pati shumë emoncione dhe duartrokitje, mbajtur në datë 10 Mars 2026.
13. Koncert "Academy Star Dance", shfaqur me shumë suksesë në teatrin "Petro Marko", në datën 12 Mars 2026.
14. Ceremoni Mbrëmje artistike për inagurimin e sheshit "Adem Jasharit", më 10 Mars ora 18:00.
15. Koncert në ditën e festës së Pranverës sheshi para Teatrit "Petro Marko".
16. Koncert "Canzone Italiana" organizuar në bashkëpunim me Konsullatën e Përgjithshme Italiane në Vlorë dhe Insitutin Italian të Kulturës Tiranë, mbajtur 22 Mars 2026.
17. Komedi "Sonde do darkojmë në shtrat" me regji të Kiço Londo, e sollën në skenë aktorët Cubi Metkaj, Erdit Asllanaj, Suela Prendi, Eno Basha, Greta Cani dhe Anxhelo Shkreli. Shfaqja u shfaq me shumë sukses për dy netë 27-28 Mars 2026 në Teatrin "Petro Marko".

- Për muajin Mars 9 shfaqje.

PRILL 2026

18. Komedia “Familja Astarti” në Teatrin “Petro Marko”, një sukses i jashtëzakonshëm për tre ditë në datat 10 , 11 dhe 12 Prill 2026. Për të treja netët salla e Teatrit pati një spektator të madh dhe për artistet pati shumë të qeshura dhe duartrokitje.
19. Zorba “The Greek” Tingujt e kompozitorit të mirënjohur grek Mikis Theodorakis në një mbrëmje ku muzika dhe kujtesa bashkohen në një përjetim të rrallë artistik. Në një atmosferë që mbart nostalgjinë dhe shpirtin e gjallë mesdhetar. Koncert i realizuar nga cikli “Fundjavat Vlonjate” 16 Prill 2026.
20. “Arushi Pooh ” Shfaqja për fëmijë “Arushi Pooh (në kërkim të bishtit të humbur)”, e realizuar nga Teatri “Petro Marko”. U prezantua për herë të parë dhe rezultoi një sukses i dukshëm artistik dhe publik. Pjesëmarrja ishte shumë e lartë, duke përfshirë jo vetëm fëmijë, por edhe të rritur, çka tregon interesin e gjerë dhe rëndësinë e kësaj shfaqjeje në jetën kulturore të qytetit. Personazhet e dashura si Arushi Pooh, Tigri dhe gomari krijuan një atmosferë të ngrohtë, argëtuese dhe edukative për publikun e vogël. Reagimi i publikut ishte jashtëzakonisht pozitiv. Shfaqja u duartrokit gjatë dhe në përfundim, fëmijët patën mundësinë të realizonin foto me personazhet, duke e kthyer eksperiencën në një kujtim të veçantë për ta. Ky aktivitet shënon një hap të rëndësishëm për teatrin për fëmijë, duke dëshmuar se prodhimet artistike të dedikuara për këtë grupmoshë kanë ndikim të madh dhe janë të mirëpritura nga komuniteti. I mbajtur për dy ditë në datat 18–19 prill 2026.
21. Koncerti “1 Emocion, 2 Kryevepra, 3 Virtuozë”, i zhvilluar në Teatrin “Petro Marko” përfaqëson një ndërthurje të bukur të muzikës klasike me interpretimin e tre artistëve virtuozë.: pianistin Kostandin Tashko, violonçelistin Enea Nushi dhe violinistin Dejon Bendaj sollën në skenë një performancë të nivelit të lartë artistik, duke përcjellë emocione të forta dhe një interpretim të rafinuar për publikun. Programi, i ndërtuar mbi kryevepra të repertorit klasik, krijoi një atmosferë elegante dhe të përqendruar, ku çdo interpretim u prit me vëmendje dhe vlerësim nga publiku. Ky koncert dëshmoi edhe një herë rëndësinë e promovimit të muzikës cilësore dhe mbështetjes së artistëve të rinj virtuozë ,i mbajtur më 21 prill 2026, nga cikli “Fundjavat Vlonjate”
22. Fest –Art 2026 Edicioni i këtij viti ishte edicioni i katërt i Fest Art. Startoi në datën 25 Mars me audicionet përzgjedhëse me pjesëmarrje të madhe nga të rinjtë e shkollave të mesme si dhe student të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, konkurentë në kategoritë e këngës dhe kërcimit modern dhe popullor. Mbas përzgjedhjes nga ana e komisionit të ngritur me këtë rast të fituesve të kësaj faze për afro një muaj nisi puna me trajnerët e këngës dhe kërcimit për përgatitjen e dy finaleve të mëdha te cilat u realizuan në datat 24 dhe 25 Prill në Teatrin “Petro Marko” . Në këto dy finale salla e Teatrit “Petro Marko” u kthye në një skenë ku artistët performues dhe spektatori i shumtë në numër nga të rinjtë e shkollave të qytetit dhe familjarë mbështesnin përfaqësuesit e tyre. Në natën finale përveç artistëve konkurrentëve nga të dyja kategoritë, pati artistë të ftuar si dhe performanca të përbashkëta nga këta artistë me këngëtarët konkures. Ky edicion i katërt i Fest Art i kthyer tashmë në një traditë të sukseshme për Teatrin “Petro Marko” vlerësoi me çmime të gjithë performuesit dhe tregoi dhe njëherë se projekte të tilla janë shumë të nevojshme dhe duhen mbështetur. Artistët përfaqësues të këtij edicioni u bënë pjesë e aperturës së koncertit të madh në datën 10 maj organizuar në ditët e Çeljes së Sezoni Turistik 2026.

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TURIZMIT

Ky raport përmban:

- Pasqyrë të detajuar të veprimtarive dhe aktiviteteve të zhvilluara gjatë periudhës 06.01.2026 – 30.04.2026;
- Informacion statistikor dhe rezultatet kryesore;
- Analizë të ecurisë së punës së Drejtorisë, duke reflektuar arritjet e identifikuar gjatë kësaj periudhe.

Ky raport pasqyron veprimtarinë e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit për periudhën 05.01.2026 - 30.04.2026. Ai ofron një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve dhe projekteve të realizuara, treguesve kryesorë të arritur, ndikimeve, efekteve pozitive si dhe sfidave të identifikuar gjatë 4-mujorit .

1. Aktivitetet dhe projektet e realizuara

1.1 Aktivitetet kryesore kulturore, artistike dhe turistike

- Përgatitja e materialeve promovuese për pjesëmarrjen e Bashkisë Vlorë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit FITUR Madrid 2026, në funksion të përfaqësimit dhe promovimit zyrtar të territorit administrativ të Bashkisë Vlorë si destinacion turistik.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi institucional me subjektet që ushtrojnë veprimtari në sektorin e turizmit në qytetin e Vlorës, përmes organizimit të një sesi informues mbi Programin PREMA nga organizata “Qendra Balance” , me qëllim garantimin e informimit të plotë, transparent dhe të barabartë për bizneset turistike lidhur me objektivat, fushat e mbështetjes, kriteret e përfitimit dhe procedurat e aplikimit të këtij programi.
- Orientues, lehtësues dhe monitorues në ecurinë dhe mbarëvajtjen në aktivitetin “ Dita e Mësuesit 7- Marsi”.
- Orientues, bashkëpunues dhe monitorues në ecurinë dhe mbarëvajtjen e aktivitetit “ 14 Marsi – Dita e Verës”
- Me synim garantimin e standardeve të punës, sigurohet angazhim maksimal gjatë realizimit të gjitha aktiviteteve të planifikuara, si edhe mbarëvajtjen e tyre në çdo fazë të procesit, me qëllim rritjen e vazhdueshme të performancës dhe cilësisë së punës nga struktura.
- Orientues, bashkëpunues dhe monitorues në ecurinë dhe mbarëvajtjen e aktivitetit “ 7 Marsi – Festa e Mësuesit”
- Identifikimi i pikave të vendosjes së dekorit floral, si dhe përzgjedhja e llojeve dhe përmasave të luleve, në përputhje me specifikimet e përcaktuara në preventivin për organizimin e aktiviteteve në kuadër të festave të 7–8 Marsit.
- Evidentimi i ambientit të eventit dhe përgatitja e kartolinave për festën e 7-8 Marsit.

- Përzgjedhja e dhuratave për ceremoninë e festës së 7 Marsit në bashkëpunim me sektorin e Arsimit
- Rinisë dhe Sporteve .
- Përgatitja e materialeve promovuese digjitale për pjesëmarrjen e Bashkisë Vlorë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit ITB Berlin 2026, në funksion të përfaqësimit dhe promovimit zyrtar të territorit administrativ të Bashkisë Vlorë si destinacion turistik.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi efektiv me bizneset lokale për përfaqësimin dhe promovimin e produkteve të tyre në kuadër të pjesëmarrjes në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit ITB Berlin 2026.
- Pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit ITB Berlin 2026 me qëllim promovimin e qytetit të Vlorës dhe të produkteve karakteristike. Ky aktivitet ofroi një platformë ndërkombëtare për të prezantuar pasuritë natyrore, trashëgiminë kulturore dhe ofertën gastronomike të qytetit, si dhe krijoi kontakte dhe bashkëpunime strategjike me operatorë dhe partnerë të industrisë së turizmit nga e gjithë bota.
- Pjesëmarrje në Panairin e organizuar nga Bashkia Lezhë me rastin e Ditës së Besëlidhjes së Lezhës me datat 1 dhe 2 Mars 2026, pjesëmarrja në këtë panair u organizua nëpërmjet prezantimit të produkteve artizanale të zonës , elementeve të trashëgimis kulturore , veshjeve tradicionale si edhe materialeve promovuese.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me artizanët për pjesëmarrjen e tyre në panairin e organizuar në kuadër të Ditës së Besëlidhjes së Lezhës me datat 1 dhe 2 Mars 2026.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi efektiv me bizneset lokale për përfaqësimin dhe promovimin e produkteve të tyre në kuadër të pjesëmarrjes në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit ITB Berlin 2026.
- Pjesëmarrje aktive dhe koordinuese në aktivitetin e “14 Marsi -Ditës së Verës”, në bashkëpunim me Zyrën Arsimore, Qendrën Kulturore dhe Qendrën Kulturore të Fëmijëve. Ky angazhim garanoi realizimin e një eventi të suksesshëm, të organizuar me profesionalizëm dhe me atmosferë festive, duke reflektuar standarde të larta organizative dhe vlerat kulturore të komunitetit.
- Pjesëmarrje aktive në organizimin dhe koordinimin e ceremonisë së emërimit të Sheshit ‘Adem Jashari’, duke garantuar mbarëvajtjen dhe zhvillimin dinjitoz të këtij event.

1.2 Monitorimi i Thirrjeve dhe Dokumentacioni

- Drejtoria ka ndjekur thirrjet sipas buxhetit të miratuar, duke qenë monitorues i gjithë procesit që nga publikimi i thirrjeve në faqen zyrtare të Bashkisë, deri tek orientimi, lehtësimi si dhe monitorimi i ecurisë dhe mbarëvajtjes së aktivitetit.
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ka siguruar përgatitjen dhe administrimin e plotë të dokumentacionit mbështetës, përfshirë shkresat për panaire dhe materialet ndihmëse në shërbim të sektorit të turizmit.”.
- Përgatitja e materialeve promovuese të Bashkisë për Agjencinë Kombëtare të Turizmit.

1.3 Efektet Pozitive dhe Ndikimet

- Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit dhe turistëve në aktivitetet kulturore, sportive dhe artistike.
- Përmirësimi i imazhit urban dhe promovimi i identitetit kulturor dhe turistik të qytetit.
- Zhvillimi i partneriteteve ndër-institucionale dhe me sektorin privat.
- Gjallërimi i mjedisit urban dhe rritja e atraktivitetit vizual të qytetit.

1. Grumbullimi dhe Analiza e të Dhënave Statistikore

Të dhënat grumbullohen periodikisht përmes: Agjencia e Zonave të Mbrojtura, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Muzeu Etnografik dhe Historik, Porti i Vlorës dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore.

Analiza e të dhënave ka lehtësuar hartimin e raporteve vjetore dhe planifikimin e aktiviteteve me impakt maksimal në zhvillimin turistik dhe ekonomik të qytetit.

2. Administrimi dhe Menaxhimi i Korrespondencës

- Përgjigje brenda afateve ligjore për të gjitha korrespondencat.
- Mbajtja dhe arkivimi i dokumentacionit të drejtorisë.
- Hartimi i materialeve dhe analizave.
- Përgatitja e materialeve për mbledhjet periodike të Këshillit Bashkiak.

4. Pjesëmarrja në Trajnime dhe Grupi i Punës

1-Trajnim me studentet e Universitetit "Ismail Qemali" me temë "Zhvillimi i Turizmit të Qëndrueshëm"

2-Trajnim me temë "Fuqizimi Përmes Edukimit Sipërmarrës dhe Inovacionit në Agroturizëm"

5. Urdhëra të brendshëm-Grupe Pune

Pjesë e grupit të punës Nr. 603 prot. Datë.21.04.2026 "Për Ngritjen e Grupit të punës për kordinimin e projektit " SACREDTRAVEL 4 GROWTH"

Pjesë e grupit të punës Nr.130 prot. Datë.05.02.2026 " Për Hartimin e Rregullores për Organizimin ,Funksionimin,Detyrat dhe Përgjegjësitë e Strukturave të Institucionit të Bashkisë Vlorë"

Pjesë e grupit të punës Nr.683 prot. Datë.07.05.2026 " Për Ngritjen E Grupit Të Punës Për Hartimin E Tremave Të Referencës Për Shërbim Organizimi Eventi Në Kuadër Të Projektit Uniting Routes Për Prokurimin E Kontratës Së Shërbimit Me Objekt Sherbim dhe Organizimi Eventi Me Referencë Uniting Routes-101192899 " Netëorking For Environmental Sustainability And Share Responsibility" Të Programit Crev Të Financuar Nga Bashkimi Evropian

Pjesë e grupit të punës Nr.710 prot. Datë.12.05.2026 Për Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Tremave të Referencës për Proceduren për Aktivitetin " Festimet E Ditës Së Fëmijëve"

Pjesë e grupit të punës Nr.698 prot. Datë.11.05.2026 “ Për Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike dhe për Llogaritjen e Fondit Limit Të Tenderit “ Blerje Dron Për Emergjencat Civile”

Pjesë e grupit të punës Nr.682 prot. Datë.07.05.2026 Për Kordinimin e Aktivitetit “Be Promotor I Mbrojtjes Së Mjedisit “ Në Kuadër të Projektit UNITING ROUTES”

Pjesë e grupit të punës Nr.511 prot. Datë.01.04.2026 “ Për Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Planit të Masave për Sezonin Turistik 2026”

Pjesë e grupit të punës Nr.442 prot. Datë.17.03.2026 Per Ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) në Bashkinë Vlorë.

7.Ndikimi dhe Vlerësimi:

- Trajnimet dhe pjesëmarrja në grupe pune kanë përmirësuar rritjen e kapacitetet profesionale dhe koordinimin ndër-institucional.
- Aktivitetet kanë kontribuar në forcimin e standardeve dhe promovimin e Vlorës si destinacion turistik gjithëvjetor.

RAJONI NR.1

Në kuadër të mirëqeverisjes vendore, ofrimit të shërbimeve, zhvillimit social, ekonomik, të komunitetit të Rajonit Nr.1. jemi impenjuar që të trajtojmë ankesat/kërkesat e komunitetit duke verifikuar në terren, përcjellë institucioneve përkatëse, jashtë juridiksionit të Bashkisë dhe në bashkëpunim me drejtoritë qe Bashkia ka në varësi zgjidhjen e problemeve dhe shqetësimeve të qytetarëve. Në total deri tani kanë qënë 128 ankesa/kërkesa, 96 prej tyre kanë qënë verbale, 22 ankesa me shkrim, 6 ankesa jashtë kopetencave tona. Janë zgjidhur 113 ankesa dhe 9 prej tyre janë në trajtim nga sektorët përkatës. Ankesat/kërkesat kryesisht kanë qënë në fushën e pronës dhe kufijve të saj , urbanistikës, infrastrukturës, konfliktet mes banorëve për shkarkime ujrash, kanalizimesh , puseta, tubacione depozita uji ulluqe etj. Përcjellë kërkesat e tyre tek ndërrmarjet përkatëse apo mes banorësh dhe ndjekja e problematikave deri në zgjidhjen e tyre. Nga ana jonë janë lëshuar 158 copë dokumenta me vlerë ligjore vërtetime, leje banimi, struktura komunitare, karakteristika sjellje, etj. Të cilat i ka në kompetencë rajoni, mbështetur mbi bazën e dokumentave të pakundërshtueshëm autentike të sjella prej qytetarëve dhe verifikimin në vënd brenda afateve kohore. Koordinimin e punës me zyrën e Gjëndjes Civile për verifikimin e banorëve, lëshimin e vërtetimeve të banimit për dokument të kërkuara nga qytetarët. Në bashkëpunim me strukturat e tjera të Bashkisë, drejtoritë, sektorët kemi asistuar gjatë projekteve për zhvillimin urban, social, strehimin dhe infrastrukturën dhe zbatimin e tyre. Emergjencat Civile gjithashtu në situatat kur ka qënë e nevojshme kanë bashkërenduar punën me ne si rajon në shume raste. Gjithashtu janë bërë edhe dëgjesa publike nën kujdesin e Kryetares së Bashkisë mbi të gjitha spektret e lartëpërmendura.

Nga ana jonë është cdo ditë është bërë monitorimi i pastrimit në terren i mbetjeve urbane, organike apo të ngurta e inerte në pikat e grumbullimit, duke e shoqëruar me fotot përkatëse dhe raportim javor/mujor dhe në rastet kur është dashur ndërhyrje emergjente është bërë në saj të bashkrendimit të punës. Fshirja, larja, dhe mirëmbajtja e rrugëve ka qënë tjetër prioritet i joni dhe Bashkisë, shërbim i

cili është kryer rregullisht por ka dhe nevojë për përmirësim. Mirëmbajtja e gjelbërimit dhe lulishteve është ndjekur nga ana jonë me vëmendje dhe në menyrë periodike është kryer nga sektorët përkatës. Në institucionet arsimore të Rajonit nga komunikimi me drejtoritë e kopshteve dhe shkollave dhe evidentimi në terren është përcjellë nevoja e tyre për ndërhyrje në rikonstruksion klasash, dyer , tualete, tarraca dhe palestrat përkatëse, gjithashtu bashkërenduar puna me S.P.Z e zonave përkatëse në lidhje me rendin dhe sigurinë e shkollave brenda ambjentëve ku nxënësit studiojnë. Kemi ndjekur gjithashtu investimet që janë bërë në rajonin tone duke filluar që nga punimet për rehabilitimin e rrugëve dhe trotuareve përgjatë territorit të rajonit, si ato kryesore dhe dytësore po ashtu rehabilitimi zonës së ish Fabrika e Cimentos, në lagjen Hajro Cakërri, lagjes Partizani, lagjes 4 Heronjtë, lagjes 15 Tetori, shkallëve të Kuzumbabasë etj. Koordinimi i punës me Policinë Bashkiake ka qënë i bashkërenduar në lidhje me rehabilitimin e trafikut, lirimin e hapsirave publike në të gjithë rajonin sidomos në Qendrën Historike, largimin dhe masat administrative përkatëse për shitësit e pa autorizuar përgjatë trotuareve, kthimin funksional të korsisë së emergjencës nga Bashkia deri tek Spitali Rajonal, duke liruar parkimet abuzive dhe marrjen e masave administrative për cdo shkelje të evidentuar. Koordinimi i punës me IMT ka qënë i bashkërenduar në lidhje me verifikimin e disa ankesave dhe konstatimeve tona në disa subjekteve mbi lejet për tenda të montuara në tokë, ndërtime të pajisura me leje ose jo etj. Koordinimi i punës në zbatimin e projekteve të ndryshme si ai i pastrimit të kanalit të ujrave të larta. Ku është dashur prishja e disa objekteve që pengonin zbatimin e projektit. Koordinimin e punës me shërbimin e Veterinarisë, ku pas interesimit tonë në mënyrë konstante u arrit edhe zgjidhja e situatës për qentë endacak. Kontakti i vazhdueshëm me 3 specialistat e policisë të zonës në lidhje me mbarëvajtjen e rendit dhe sigurisë dhe zgjidhjen e konflikteve në komunitetin e të gjithë rajonit. Nga ku rezulton se skemi asnjë rast të pa zgjidhur dhe mbështetja e përbashkët ka qënë në 23 raste. Pjesë e punës tonë kanë qënë dhe kontakti me qytetarët për të ditur nevojat e tyre emergjente në zonën ku banojnë dhe jetojnë , mjedisin apo banesat e tyre për të dëgjuar shqetësimet dhe problematikat, kujdes të vecantë për fëmijët, moshatarët, studentët, personat me nevoja të vecanta dhe trajtim me ndihmë ekonomike dhe përkrahje sociale. Tërheqja dhe dërgimi i korrespondencës në zyrën e protokoll/arkivës në Bashki, nga ku është bërë dhe shpallja e vendimeve, njoftimeve dhe kthimi i përgjigjeve sipas afateve. Me synimin e përmbushjes së qëllimit për mirëqeverisjen e qëndrueshme dhe rritjen e besimit të qytetarëve tek administrata nga ana jonë kryhet me prioritet intensifikimi i punës dhe ndërveprimit midis drejtorive, për të qënë sa më pranë komuniteti dhe realizimit të objektivave të Bashkisë Vlorë.

K R Y E T A R

Brunilda Mersini

ME URDHËR DELEGIMI

NËNKRYETAR

Joljana Elanaj

